Viti XXIII | Nr.228 | Maj 2010 | Jumada 1 / Jumada 2 1431 | Çmimi 50 den

# Hëna e Re

*Revistë kulturore informative islame*

## *1400 vjetori i shpalljes së fjalës së përsosur të Allahut fuqiplotë*



# Dalëngadalë kohës po i japim emër...!



12 PASURI ISLAME: OBJEKTET FETARE TË BFIM



16 KUJDES NDAJ NORMAVE DHE LIGJEVE FETARE



26 PSE DUHET TA MBROJMË TRADITËN TONË ISLAMO-SHQIPTARE?!



43 DISA DALLIME NDËRMJET BIBLËS DHE KUR'ANIT

www.bim.org.mk | www.henaere.bim.org.mk



# DENACIONALIZIMI *dhe* TRASHËGIMIA

Kohë më parë mediat maqedonase, të afërta me pushtetin aktual, në opinion lansuan idenë se gjoja Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë nuk është trashëgimtare e objekteve të kohës osmane, qofshin ato objekte fetare ose profane. Për këtë qëllim angazhohen edhe punëtorë të arkivit, që të "zbulohet" e vërteta rreth asaj si është formuar institucioni i Bashkësisë Islame në periudha të ndryshme, që nga tërheqja e osmanlinjve nga këto troje. Madje, në këtë drejtim u botua një aktvendim, ku kjo bashkësi në trojet e ish-Jugosllavisë, në një kohë të caktuar, krahas atributit fetar paska pasur edhe atribut politik, gjë e cila, sipas tyre, e vika në pikëpyetje trashëgiminë e objekteve të kohës osmane.

Denacionalizimi dhe trashëgimia fare nuk kanë të bëjnë me njëra-tjetrën, por ja që edhe pas dymbëdhjetë viteve të ekzisitimit të Ligjit për denacionalizim, në vend që çështja e denacionalizimit të vakëfit të marrë fund, duke iu kthyer pronarit të saj legjitim, i cili posedon dokumentacionin nga i cili është marrë, respektivisht është nacionalizuar kjo pronë, fundja duke pasur trajtim të njëjjtë me bashkësitë tjera fetare në vend, po nxirret në shesh trashëgimia, për të manovruar me opinionin, për shitur atij sapun në vend të djathit. Për fat të keq, në grackat e këtilla po bien disa analistë tanë të lëmit juridik, të cilët me vetëdije apo pa të japin mendimet e tyre duke mos e kuptuar qëllimin e pamfleteve të politikës ditore antiislame.

S`ka dyshim se shpifjet e këtilla nuk janë gjë tjetër përpos se një kundërpërgjigje ndaj kërkesave këmbëngulëse të Bashkësisë Fetare Islame për të kthyer pronën e vet, së cilës, për ironi, deri më tani i është kthyer vetëm dhjetë për qind. Kërkesat e saj janë shumë të qarta: Vakëfit t`i kthehet funksioni i vërtetë, kërkesat e këtij institucioni të kenë trajtim të barabartë me të tjerët, të lihet e lirë në rimëkëmbjen e objekteve fetare siç janë Xhamia Burmali dhe Xhamia Arasta në Shkup, Çarshi-Xhamia në Prilep, ndërtimi i xhamisë në f. Llazhec, në Manastir etj.

Bashkësinë Fetare Islame askush nuk mund ta frikësojë, por edhe ta pengojë, që ajo të kërkojë të drejtën e saj në zhvillimin dhe organizimin e jetës fetare islame në vend, sepse muslimanët e këtij nënqielli, si popullatë autoktone, nuk mund të jetojnë si qiraxhinj në pronën e tyre. Në krah të këtyre kërkesave të drejta, pa dyshim, duhet të jenë edhe subjektet politike shqiptare, të cilat kanë një përgjegjësi të madhe ndaj elektoratit për çështje serioze, siç është (edhe) denacionalizimi i pronës së tyre. Lidhur me këtë, BFI ka ngritur zërin e saj, duke u apeluar publikisht deputetëve që të japin kontributin e tyre në këtë drejtim, sepse shihet qartë se politika është ajo që po e pengon dhe po e zvarrit denacionalizimin e pronës së vakëfit. Pra, e njëjta politikë i hudh pluhur në sy opinionit me manovra të ndryshme, duke tërhequr vëmendjen në gjëra të kota, vetëm e vetëm që të pengohet kthimi i pronës.

Hëna e re

REVISTË MUJORE
INFORMATIVE
KULTURORE ISLAME

Botues:
Rijaseti i BFI në RM

*Kryeredaktor:*
Abaz Islami

*Redaktor përgjegjës:*
Shaban Aziri

*Redaksia:*
Skender Buzaku
Abas Jahja
Ibrahim Idrizi
Qufli Osmani
Shaban Sulejmani
Ismet Osmani
Driton Dikena
Agron Vojnika

*Bashkëpunëtorë:*
Valbona Zunçe
Rejhan Neziri

*Redaktimi gjuhësor:*
Nazif Zejnullahu

*Redaktor teknik:*
Halil Berisha

Telefonat e Redaksisë:
02 3117 410; 02 3117 412

www.bim.org.mk
e-mail:bim@bim.org.mk
www.henaere.bim.org.mk
e-mail: hena@bim.org.mk

Dorëshkrimet dhe
fotografitë nuk kthehen

# Përmbajtja



SHEMBULLI MË I PËRKRYER PËR TË GJITHA VETITË E MIRA 23



JETA BASHKËSHORTORE E MBRON DINJITETIN E FEMRËS 37



MUZIKA E TEQESË DHE FORMAT E SAJ 31



KONCEPTI I KUR'ANIT PËR DA'VEN GJATË PERIUDHËS PARAKUR'ANORE (2) 40



ALKOOLI DHE FAMILJA 56

6 MOS DËMTONI PROCESET E RINDËRTIMIT TË XHAMISË BURMALI

6 EDHE NË MAQEDONI FILLOI TË APLIKOHET SISTEMI HALLALL

7 MOTO E TË GJITHËVE: PAQJA DHE TOLERANCE

8 NË FRYMË TË DIALOGUT DHE MIRËKUPTIMIT

9 DIALOGU MUNDËSI E VETME PËR BASHKËJETESË

10 XHAMITË I NDËRTOJNË VETËM ATA QË KANË BESIM TË PALUHATSHËM NË ALLAHUN

11 XHAMITË KULTIVOJNË VLERA SHPIRTËRORE, MORALE E KULTURORE

14 E TASHMJA E MEDRESESË ËSHTË TËRËSI E SË KALUARËS SË SAJ

19 DOMETHËNIA BESIMORE E FRIKËS NDAJ ALLAHUT XH.SH.

29 PERSONALITETI I JETIMIT NË ISLAM

33 RESPEKTIMI I LIDERIT

36 UNIONI I STUDENTËVE TË FSHI ME KRYESI TË RE

48 PËRPJEKJET PËR PËRMIRËSIMIN E GJENDJES SHOQËRORE, SYNIM I KAHMOTSHËM

50 THIRRJA ISLAME (DA'VEJA) KËRKON ANGAZHIM DHE SACRIFICE

53 NJË JETË KUSHTUAR FESË

58 PEACE AND TOLERANCE – THE MOTTO OF ALL ISLAMIC LEADERS

59 PUBLIC INFORMATION

59 IN THE SPIRIT OF DIALOGUE AND UNDERSTANDING

60 GREEK AMBASSADOR VISITED THE IRC

60 OPENING CEREMONY OF THE THIRD MOSQUE IN SARAJ

60 KONDOVO LAID CORNERSTONE OF A NEW MOSQUE






# Mos dëmtoni proceset e rindërtimit të xhamisë Burmali



Bashkësia Fetare Islame e R.M. me këmbëngulje është e përqendruar në rindërtimin e Xhamisë Burmali në sheshin 'Maqedonia' në Shkup, në lokacionin e saj shekullor. Kemi përshtypje se kërkesa jonë së shpejti do të jetë në rend dite në Komunën Qendër, me çka do të mundësohet marrja e vendimit për futjen e Xhamisë Burmali në planin e detajuar urbanistik.

Thirrja e të ashtuquajturit trup koordinativ për organizimin e tubimit publik nga ana e pjesëtarëve të Islamit me karakter fetar është në kundërshtim me interesin për rindërtimin e Xhamisë Burmali. Edhe pse çdo tubim është e drejtë demokratike, tubimi i tillë vetëm seriozisht mund të dëmtojë procedurat në vijim, të cilat i udhëheq Bashkësia Fetare Islame e R.M. për rindërtimin e saj.

Thirrje të Ezanit, falje të namazit dhe përmbajtjeve të tjera fetare në vende të hapura dhe publike mund të realizojnë vetëm personat që kanë autorizim nga bashkësia fetare e regjistruar dhe se autorizim për ngjarjen e nesërme BFI deri më tani nuk i ka dhënë asnjë personi fetar.

U bëjmë thirrje muslimanëve të Shkupit dhe më gjerë që të mos jenë peng i trupave të ashtuquajtur, të cilët kanë për qëllim të përmbushin (kënaqin) interesat e tyre personale, duke mos mbajtur llogari se me të vërtetë me një akt të tillë seriozisht do të jetë e rrënuar mundësia për rindërtimin e Xhamisë Burmali.

Kemi bindje se imamët dhe personat tjerë të emëruar fetar nga ana e BFI, këtë akt do ta dënojnë dhe do të marrin masa dhe aktivitete që i njëjti të mos jetë i përkrahur nga ana e muslimanëve të qytetit të Shkupit, nga arsyeja se ai tubim nuk e ka bekimin e BFI dhe se i njëjti nuk është i koordinuar me të.

BFI e R.M. aktin e mundur për bekim të lokacionit të Xhamisë Burmali dhe në të njëjtin vend të kryejë faljen e namazit e ka në agjendën e saj si një nga hapat e fundit demokratik dhe i cili do të kishte qenë i organizuar në mënyrë serioze, duke përcjellë mesazh të qartë dhe decid.

Për atë arsye, edhe një herë iu bëjmë thirrje muslimanëve të qytetit të Shkupit dhe të R.M. që të përcjellin agjendën e BFI e jo të trupave të cilët nuk kanë kompetenca të ndërtojnë dhe të rindërtojnë xhami.

*12.05.2010, Shkup*
*Shërbimi për Informim pranë BFI-së*

# Edhe në Maqedoni filloi të aplikohet sistemi Hallall

Më 29 05 2010 në lokalet e Fakultetit të Shkencave Islame dhe në organizim të BFI-së u mbajt takim me mbi tridhjetë të punësuar nëpër firma të ndryshme e të cilat kanë pëlqim nga BFI dhe Drejtoria për hallall çertifikata ku për qëllim ishte trajnimi i tyre me njohuri se si të aplikohen hallall standardet edhe në Maqedoni, respektivisht për paopullatën e vendit tonë. Përgatitja e ushqimeve, lëngjet për pije, prodhimet kozmetike për të gjithja këto BFI mbrenda disa ditëve do të ndajë çertifikata speciale për disa firma ku do të aplikohet sistemi hallall i ushqimit.

Firmat të cilat aplikojnë këtë sistem do ta kenë shumë më lehtë plasmanin e prodhimeve të tyre në mjediset dhe vendet muslimane. Hallall sistemi nënkupton plotësimin e HASAP-it, por duke




pasur parasysh respektimin e disa normave fetare të fesë islame. P.sh., që të therret një bagëti, kasapi obligohet që fillimisht të lexoj lutjen e caktuar duke shprehur fjalën Bismil-lah. Gjithashtu, prodhimet nu guxojnë të posedojnë aditive të caktuara, mish derri apo alkohol.

Të gjitha ato ndërmarrje që merren me transport do t'u shtohen mundësitë që ta shtojnë transportin në të gjitha shtetet perëndimore nga shkaku se këto standarde me shumicë i aplikojnë qytetqarët në pjesën dërmuese të shteteteve perëndimore.

Për qyetetarët e Maqedonisë sistemi Hallall nuk është i panjohur. Në të shumtën e rasteve merret parasyshë mënyra e përgatitjes së ushqimit dhe respektimi i standardeve. Si shembull mund të përmendim, duhet të kihet kujdes se nga cila thertore merret mishi dhe se a i plotëson kushtet për prodhimin e mishit, etj.

Pra, ky takim shërbeu si trajnim për njerëzit që janë të ngarkuar që të aplikojnë sistemin hallall në firmat e tyre. Mbrenda disa ditëve do të bëhet kontrollë mbikqyrjeje nga ana e BFI për gjendjen reale në terren ku dhjetëra firma do të pajisen me çertifikata speciale.

## KREU I BFI-SË NË TAKIMIN E LIDERËVE FETARË ISLAM TË RAJONIT



# Moto e të gjithëve: paqja dhe toleranca

**Temat për të cilat biseduan liderët fetarë islam gjatë qëndrimit në Kosovë ishin: Bashkëpunimi në mes bashkësive fetare, roli i fesë në rrethanat aktuale në rajon, bashkëpunimi me bashkësitë tjera fetare, roli i fesë në edukimin dhe fisnikërimin e popullatës, si dhe roli i bashkësive fetare në shoqëritë postkonfliktuoze, etj.**

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame, Reis-ul-Ulema, H.Sulejman ef. Rexhepi, i shoqëruar nga sekretari i përgjithshëm, h. Afrim ef. Tahiri, ka udhëtuar për në Republikën e Kosovës, ku merr pjesë në takimin e liderëve fetarë islam të rajonit, nikoqire e të cilit është Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës.

Në prag të takimit me liderët fetarë, kryetari i BFI-së, H. Sulejman ef. Rexhepi, ka zhvilluar edhe një takim me presidentin e Kosovës, Fatmir Sejdiu, i cili ka shtruar darkë për pjesëmarrësit e Konferencës së Bashkësive Islame të vendeve të Ballkanit.

Presidenti Sejdiu i falënderoi ata për bashkëpunimin e ndërsjellë dhe për përkrahjen e vazhdueshme. "Motoja e gjithë juve është moto e paqes dhe tolerancës, moto e njerëzisë, moto e ndihmës dhe e solidaritetit. Është për t'u vlerësuar në mënyrën më të mirë të mundshme fakti se ka një bashkëpunim shumë të mirë dhe të shkëlqyeshëm me të gjithë ju dhe me vendet nga ju vini, me njerëz edhe të besimit islam, por, natyrisht, edhe të besimeve të tjera", tha me këtë rast Presidenti Sejdiu.

Temat për të cilat biseduan liderët fetarë islam gjatë qëndrimit në Kosovë ishin: Bashkëpunimi në mes bashkësive fetareve, roli i fesë në rrethanat aktuale në rajon, bashkëpunimi me bashkësitë tjera fetare, roli i fesë në edukimin dhe fisnikërimin e popullatës, si dhe roli i bashkësive fetare në shoqëritë postkonfliktuoze etj.

Para takimit me Sejdiun liderët fetarë vizituan tyrben e Sulltan Muratit në Mazgit.

Të mërkurën pasdite të gjithë liderët fetarë vizituan Kompleksin Memorial në Prekaz e më pas qëndruan në qytetin e Prizrenit, ku bashkë me Këshillin e Bashkësisë Islame nikoqire, vizituan edhe monumentet e trashëgimisë kulturore e fetare, ndërsa në mbrëmje morën pjesë në një program me karakter fetar.

Të enjten (sot) liderët fetarë islam do të vizitojnë Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Liderët fetarë që morën pjesë në takimin e Prishtinës, të ftuar nga kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, myftiu mr. Naim Tërnava, janë: Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë, Reis-ul-Ulema H.Sulejman ef. Rexhepi, prof. dr. Ali Bardakoglu – kryetar i DIJANET-it (Bashkësia Islame e Turqisë) me bashkëpunëtorë, ing. H. Selim Muça – kryetar i Komunitetit Musliman të Shqipërisë, myftiu Shefko ef. Omerbashiq – kryetar i Bashkësisë Islame të Kroacisë, nga Bosnja dhe Hercegovina ishte myftiu i Mostarit, Seid ef. Smajkiq, pastaj Rifat ef. Fejziq – Reis i Bashkësisë Islame të Mali të Zi, myftiu dr. Nexhat Grabus – kryetar i Bashkësisë Islame të Sllovenisë, myftiu Mustafa Haxhi Alish - kryetar i Bashkësisë Islame të Bullgarisë, Ibrahim Sherif – myfti nga Greqia, po ashtu edhe Ahmet Mete nga Greqia dhe Murat ef. Jusuf - kryetar i Bashkësisë Islame të Rumanisë. Të gjithë kryesuesit e delegacioneve shoqërohen nga bashkëpunëtorët e tyre.

**11-13 maj 2010, Prishtinë**

## TAKIM: REIS-UL-ULEMA I BFI ME ULRIKE MARIA KNOC

# Në frymë të dialogut dhe mirëkuptimit



Më 20.05.2010 në Bashkësinë Fetare Islame Reis-ul-Ulema, H. Sulejman ef. Rexhepi, zhvilloi takim me ambasadoren e R. së Gjermanisë në Maqedoni, znj. Ulrike Maria Knoc. Në bisedën e tyre Reis-ul-Ulema i BFI-së falënderoi ambasadoren gjermane për vizitën që ia bëri institucionit fetar islam, BFI-së. Ai e njoftoi ambasadoren me veprimtarinë institucionale të BFI dhe për gjithë atë që ndodhi dhe po ndodh kohëve të fundit në vendin tonë.

"Ne jemi mirënjohës për atë që po bën shteti gjerman rreth organizimit të jetës fetare të muslimanëve në Gjermani nga vendi ynë në koordinim dhe bashkëpunim me BFI-në, duke përkujtuar se përvoja që marrim me institucionet e shtetit gjerman është e jashtëzakonshme dhe për një bashkëpunim të mirëfilltë kemi bindje se do të jetë në nivelin e duhur edhe në të ardhmen në mënyrë kontinuitive", tha mes tjerash Reis-ul -Ulema H.Sulejman ef. Rexhepi.

Në këtë takim kreu i BFI e njoftoi Ambasadoren për pjesëmarrjen e BFI-së në Konferencën e dytë botërore për dialog ndërfetar dhe ndërcivilizues, të mbajtur në Ohër. Ai mes tjerash theksoi: "Ne kemi bërë përpjekje që kjo konferencë të ketë rezultate të frytshme dhe në frymën e vërtetë të dialogut të rrezatojë në shoqërinë tonë dhe më gjerë, meqë edhe karakteri i Konferencës është i asaj natyre. BFI ka bërë që edhe gjuha shqipe të jetë një nga pesë gjuhët që kanë folur pjesëmarrësit në këtë konferencë botërore, e cila gjë nuk ishte e paraparë paraprakisht nga ana e organizatorit". "Ne e kemi kapërcyer problemin e Llazhecit, të xhamisë së Prilepit dhe çështjet tjera që na kanë tanguar që nga periudha e konferencës së parë", tha kreu i BFI, H. Sulejman ef. Rexhepi.

Ambasadorja gjermane me vëmendje përcolli gjithë atë që kishte deklaruar Reis-ul- Ulema i BFI, duke shprehur se "me të vërtetë BFI dhe ju si udhëheqës i këtij institucioni fetar islam keni pasur probleme dhe jeni ballafaquar me sfida të shumta". "Ju ia keni arritur qëllimit, duke preferuar dialogun dhe bashkëpunimin ndërinstitucional në takimet e realizuara me udhëheqësit e Qeverisë dhe korin diplomatik në Maqedoni. Suksesi i juaj ka qenë i lidhur ngushtë me punën që përmes dialogut dhe mirëkuptimit t'i kapërceni problemet me të cilat jeni ballafaquar një periudhë të gjatë. Ne edhe më tej ju inkurajojmë që të vazhdoni në këtë drejtim, që edhe më tej të kontribuoni për shoqërinë dhe shtetin përmes dialogut dhe gjuhës së mirëkuptimit" - shtoi Ulrike M. Knoc.

## AMBASADORJA GREKE VIZITOI BFI-NË

# Dialogu mundësi e vetme për bashkëjetesë

Të martën, më datë 25.05.2010, në ambientet e Rijasetit të Bashkësisë Fetare Islame të RM, Reis-ul-Ulema, H. Sulejman ef. Rexhepi, priti Ambasadoren e Republikës së Greqisë në Maqedoni, znj. Aleksandra Papadopoulou. Në fillim Reis-ul-Ulema, H. Sulejman ef. Rexhepi, falënderoi ambasadoren greke për vizitën që ia bëri BFI-së dhe më pas gjerësisht e njoftoi me aktivitetet e realizuara të BFI-së gjatë kësaj periudhe, si dhe me zhvillimet që po ndodhin kohëve të fundit në vendin tonë. Në këtë takim kreu i BFI e njoftoi Ambasadoren për pjesëmarrjen e BFI në Konferencën e dytë botërore për dialog ndërfetar dhe ndërcivilizues, të mbajtur në Ohër. Ai mes tjerash theksoi: “Ne kemi bërë përpjekje si në të kaluarën, por edhe tani, që kjo konferencë, e këtij karakteri, të ketë rezultate të frytshme në zhvillimin real të dialogut në shoqërinë tonë, por edhe më gjerë. Bashkësia Fetare Islame bëri që edhe gjuha shqipe të inkorporohet në mesin e pesë gjuhëve të punës së Konferencës, ku pjesëmarrësit shqipfolës patën mundësi që pjesëmarrësve t'u drejtoheshin në gjuhën shqipe, gjë e cila në fillim nuk ishte paraparë në punën e kësaj konference”.

“Ne me sukses kapërcyem problemin e Llazhecit, të xhamisë së Prilepit dhe shumë çështje të tjera që na kanë preokupuar me kohë”, theksoi ndër të tjera kreu i BFI, H. Sulejman ef. Rexhepi.

Ambasadorja greke me kureshtje përcolli gjithë atë që kishte thënë Reis-ul-Ulema i BFI, duke theksuar se “BFI dhe ju si udhëheqës i këtij institucioni fetar islam, keni ditur që me tolerancë dhe mençuri t'i kapërceni problemet dhe sfidat me të cilat jeni ballafaquar, duke preferuar dialogun dhe bashkëpunimin ndërinstitucional si me udhëheqësit qeveritarë, po ashtu edhe me korin diplomatik të akredituar në Shkup. Gjithashtu, e dimë se nuk e keni lehtë me sfidat që ju po përballeni, mirëpo ajo që Ju personalisht bëni si prijës i këtij institucioni, është për çdo lëvdatë”. “Unë po vëzhgoj nga afër nëpërmjet shtypit gjithë atë që po ndodh rreth dhe ndaj Bashkësisë Fetare Islame. Ne jemi të mendimit se Bashkësitë fetare duhet të trajtohen njësoj dhe me respekt. Nuk mund t'i gjykoj mënyrat, por asnjë shtet nuk mund të diskriminojë askënd, aq më pak nëse ai shtet ekziston me siglën shtet multietnik apo multireligjioz”.

Ne edhe më tej ju inkurajojmë që të vazhdoni në këtë drejtim, që edhe më tej të kontribuoni për shoqërinë dhe shtetin përmes dialogut dhe mirëkuptimit, shtoi Ambasadorja Papadopoulou.

Në frymën e këtij dialogu, edhe Reis-ul-Ulema, H. Sulejman ef. Rexhepi, i uroi të gjitha të mirat Ambasadores Papadopoulou, me dëshirën e madhe që së shpejti të kapërcehen të gjitha divergjencat rreth problemit të emrit mes dy shteteve, si dhe pranimin sa më të shpejtë të pavarësisë së Kosovës nga ana e Greqisë.



HAPJE SOLEMNE E XHAMISË SË TRETË NË SARAJ

# Xhamitë i ndërtojnë vetëm ata që kanë besim të paluhatshëm në Allahun

Më 26.05.2010 (e mërkurë) në f. Saraj të Shkupit u bë inaugurimi i xhamisë së tretë. Pas një pune dhe angazhimi të madh nga Myftinia e BFI - Shkup dhe qytetarët e Sarajit, u lëshua në përdorim xhamia e re, e cila qytetarëve do t'u mundësojë që të realizojnë obligimet dhe nevojat e tyre fetare. Në këtë eveniment mori pjesë Reis-ul-Ulema i BFI, H. Sulejman ef. Rexhepi, Sekretari i përgjithshëm i BFI-së, H. Afrim ef. Tahiri, myftiu i Myftinisë së Shkupit, Ibrahim ef. Shabani, myftiu i Myftinisë së Kumanovës, Abedin ef. Imeri, myftiu i Myftinisë së Kërçovës, Murat ef. Huseini, myftiu i Myftinisë së Gostivarit, Shaqir ef. Fetahu, u.d. dekan i Fakultetit të Shkencave Islame në Shkup, mr. Fahrudin Ebibi, u.d. drejtor i SHMI Medreseja "Isa Beu"- Shkup, prof. Ibrahim Idrizi, profesorë, qytetarë akademikë dhe xhemat nga lagjja e Sarajit. Gjithashtu, i pranishëm në këtë inaugurim të xhamisë në fjalë ishte edhe Atasheu për çështje fetare në Ambasadën e R. Turqisë, z. Bahatin Bildik.

Fillimisht, programi u hap me leximin e asheres, të kënduar nga një nxënës i Medresesë Isa Beu, e më pas udhëheqësi i programit Ismet Bytyçi, referent në Myftininë e Shkupit, ftoi imamin e kësaj xhamie, Shaban ef. Tahiri, që të përshëndet dhe të falënderojë të pranishmit në këtë solemnitet. Më pas, fjalë përshëdetëse kishte myftiu i Shkupit, Ibrahim ef. Shabani, i cili e vlerësoi punën dhe kontributin e xhematit të kësaj xhamie që nga gurthmeli i saj e deri më tani.



Më pas, fjalë rasti kishte Reis-ul-Ulema, kryetari i Bashkësisë Fetare Islame, H. Sulejman ef. Rexhepi, i cili të pranishmit fillimisht i përshëndeti dhe i përgëzoi për hapjen solemne të këtij tempulli të shenjtë. Kreu i BFI-së foli rreth rëndësisë së xhamisë në vendin tonë dhe rolin e saj në ndërtimin e personalitetit të besimtarit, si dhe në ngritjen e vetëdijes së qytetarit. Ai më tej shtoi: "E vërtetë e madhe, e pamohueshme, të cilën e dëshmon Kur'ani Famëlartë, është ajo se xhamitë i ndërtojnë, xhamitë i meremetojnë dhe i riparojnë vetëm ata që kanë iman të paluhatshëm në Allahun Fuqiplotë, ata të cilët me dinjitet të plotë i kanë besuar dhe i besojnë Muhamedit a.s., ata të cilët fare nuk kanë pozicion dyshimi në shpirtin e tyre për çështjen e besimit në jetën e përhershme...Ne kemi ndërtuar shumë xhami në të kaluarën edhe përkundër faktit që kemi pasur presione për mosngritjen e tyre, siç ka qenë rasti i xhamisë suaj me dy minaret. Ishallah nesër do të hedhim gurthemelin në anën tjetër të autostradës, që kjo hyrje, përkatësisht kjo portë e Shkupit, të jetë edhe më e bukur me shtëpitë e Allahut xh.sh."- shtoi H. Sulejman ef. Rexhepi. Për Imam dhe Hatib në këtë xhami dekret mori teologuhoxha Shaban Tahiri, të cilit ia dha Reis-ul-Ulema, ndërsa çelësat e kësaj xhamie kryetari i BFI-së ia dha muteveliut të xhamisë, Ahmed Hasanit. Në fund të këtij programi ashere këndoi atasheu për çështje fetare në Ambasadën e R. Turqisë, z. Bahatin Bildik, ndërsa duanë e bëri myftiu i Myftinisë së Gostivarit, Shaqir ef. Fetahu.

### GURTHEMEL XHAMIE NË FSHATIN KONDOVË

# Xhamitë kultivojnë vlera shpirtërore, morale e kulturore

Më 27 maj 2010 në fshatin Kondovë të Shkupit u vu gurthemeli i xhamisë. Në këtë ceremoni mjaft me peshë si për Bashkësinë Fetare Islame në RM, ashtu dhe për Myftininë e Shkupit, përveç kreut më të lartë të BFI-së në krye me Reis-ul-Ulemanë H. Sulejman ef. Rexhepi, morën pjesë myftiu i Shkupit, Ibrahim ef. Shabani, myftiu i Gostivarit, Shaqir ef. Fetahu, myftiu i Kërçovës, Murat ef. Iseni, myftiu i Manastirit, Pëllumb Veliu, dekani i Fakultetit të Shkencave Islame, Faredin Ebibi, drejtori i Medresesë Isa Beu, Ibrahim Idrizi, atasheu për Çështje fetare në Ambasadën e Turqisë në vendin tone, z. Bahatin Bildik, profesorë të Medresesë dhe të Fakultetit të Shkencave Islame, si dhe shumë qytetarë të vendit dhe mysafirë të tjerë. Vlen të theksojmë kontributin e madh që ka dhënë Komisioni pronësor-juridik i Myftinisë së Shkupit, si dhe përgjegjësi i këtij komisioni, Skender Buzaku, i cili ndihmoi në realizimin e të gjitha procedurave që kishin të bënin me kthimin e tokës ku është hedhur gurthemeli.



Ceremonia e këtij akti solemn u hap me këndimin e pjesëve të Kur’anit Famëlartë, ku më pastaj fjalë përshëndetëse kishte imami i fshatit, Nevzat Ahmeti dhe Myftiu i Shkupit, Ibrahim ef. Shabani, i cili vlerësoi këtë vepër të madhe të këtyre qytetarëve. Më tej u shpreh se xhamitë në kontinuitet kanë luajtur rol të veçantë në edukimin e shoqërisë dhe në ndërtimin e personalitetit të besimtarit.

Në fjalën e tij të rastit kryetari i BFI-së, Reis-ul-Ulema H. Sulejman ef Rexhepi, pasi përshëndeti të pranishmit, theksoi se vënia e gurthemelit të këtij tempulli të shenjtë ishte nevojë imediate për banorët e fshatit Kondovë. Në vazhdim, Reis-ul-Ulema theksoi: “Kur’ani Famëlartë dëshmon se xhamitë i ndërtojnë, xhamitë i meremetojnë dhe i riparojnë vetëm ata që kanë bindje të paluhatur në Allahun Fuqiplotë, ata të cilët ndjekin veprën më të shquar të figurës më me ndikim të historisë njerëzore, Muhamedit a.s”. Ai më tej foli mbi rëndësinë e xhamisë në shoqëritë moderne, për rolin e saj si nga aspekti edukativ, ashtu edhe nga aspekti shpirtëror. Ajo do të shërbejë në kultivimin e vlerave shpirtërore, morale e kulturore, vlera për të cilat ka më së tepërmi nevojë bota, por edhe besimtarët e vendit tonë. Ky objekt do të shërbejë si një simbol me vlera shumëdimensionale për këtë grykë gjeografike, ku graviton popullata shqiptare muslimane. Vetë akti i gurthemelit të këtij objekti është një dëshmi e fuqishme për devotshmërinë dhe shpirtin e sakrificës së këtij xhemati kur është në pyetje fjala e Zotit dhe shtëpitë e Tij. Dhashtë Zoti që këto aktivitete të këtij lloji të vazhdojnë edhe në të ardhmen gjithandej ku e kërkon nevoja, ndërsa BFI si gjithmonë do të jetë në përkrahjen e këtyre iniciativave si nga aspekti moral, po ashtu edhe në atë administrativ – theksoi, ndër të tjera, Reis-ul-Ulema Sulejman ef. Rexhepi.











# Pasuri islame: Objektet fetare të BFIM

### SHKUP: HISTORI E SHKURTËR

Në burimet islame është nënvizuar se Shkupi është çliruar në vitin 1389/1390, d.t.th. se 10 ose 11 muaj pas luftës së Kosovës, në vitin 792 hixhri, nën komandën e Pasha Yigit Mehmet-it.

Disa historianë theksojnë se qyteti i Shkupit është çliruar në të njëjtën datë, por në kohën e Timurtash Pashës, ndërsa Pasha Yigit Beu është zgjedhur si udhëheqës i Shkupit. Në të dhënat perëndimore nënvizohet se Shkupi është çliruar më 6 janar të vitit 1392 ose më 19 janar 1392.

Pas Pasha Yigit-it vjen i biri i tij, Is'hak Beu, i cili do të jetë udhëheqës i Shkupit. Pas Is'hak Beut në krye të Shkupit do të vijë Isa Beu. Udhëpërshkruesi i mirënjohur Evlija Çelebija në veprën e tij "Sejatname" tregon për Shkupin se ka qenë një qytet i bukur, me rrugë të zbukuruara me kalldërm të bardhë. Evlija Çelebija në veprën e tij tregon se Shkupi ka pasur 70 mëhallë, 1060 shtëpi, më tepër se 120 mesxhide dhe xhami, prej të cilave 45 kanë qenë ku është falur namazi i xhumasë. Në Shkup ka pasur 70 mejtepe dhe medrese, 20 teqe, 110 çezma, 200 sebilhane, disa hamame, 7 karvan-saraje, hane dhe me një çarshi me 2150 dyqane, 1 bezisten dhe 1 urë.

Tani në Shkup ka një numër të madh xhamish, të cilat janë me vlerë të lartë artistike, si trashëgimi kulturore e arkitekturore, stili ndërtimor i të cilave bën për vete shumë vizitorë. "Hëna e Re" ia sjell lexuesit në disa numra.

### XHAMIA E ISA BEUT (880/1475)

Sipas mbishkrimit që gjendet në portalin e Xhamisë, kuptojmë se ndërtuesi i xhamisë është i biri i Is'hak Beut, Isa





Beu. Lindja dhe vdekja e Isa Beut nuk dihet saktësisht, mirëpo dihet se ka qenë i emëruar si vali në Vilajetin e Bosnjës dhe pas një kohe të shkurtër ka ndërruar jetë.

Xhamia gjendet në anën e majtë të Çarshisë së Vjetër të Shkupit, në afërsi të Xhamisë së Sulltan Muratit. Evlija Çelebija në veprën e tij të mirënjohur "Sejatname" thotë: "Vendi ku është ndërtuar xhamia e Isa Beut është një hapësirë me ajër të pastër e freskët. Është një xhami që dallon nga xhamitë tjera, për vetë faktin se ka dy kube dhe është e tipit të xhamisë së Bursës. Ajo, gjithashtu, na përkujton dhe Xhaminë e Muradijes në Stamboll".

Isa Beu në kompleksin e xhamisë ka ndërtuar medrese, han dhe imaret'hane, mirëpo për fat të keq sot këto nuk ekzistojnë. Glisha Elezoviç në veprën e tij " Turski spomenici u Skoplju" tregon se në oborrin e xhamisë ka pasur disa mbetje muresh dhe se këto mbetje muresh supozohet se kanë qenë mbetjet e Medresesë Isa Beu dhe të bibliotekës së Isa Beut, ndërsa nga imaretet gjurmë nuk kanë mbetur.

Karakteristikë është se madhësia e kubeve të xhamisë janë të njëjta. Kasnakët e dy kupolave janë me 8 skaje, të ndërtuara nga tulla dhe guri. Në hyrjen e kasnakut të kupolës, në të dyja anët, ka nga një dritare dhe këto dritare e ndriçojnë Xhaminë.

Xhamia në përgjithësi ndriçohet përmes 17 dritareve. Mihrabi dhe mimberi, për fat të keq, nuk e ka ruajtur origjinalitetin. Origjinalitetin nuk e ka ruajtur edhe mahfili (lozha). Ato janë të rikonstruktuara dhe kanë marrë një pamje pak më ndryshe.

Pjesa e përparme e Xhamisë është ndërtuar nga guri i prerë. Minarja e xhamisë zë pjesën e fundit të xhematit, mbi muret e xhamisë. Minarja po ashtu është e ndërtuar nga guri i prerë. Edhe pse në të kaluarën në oborrin e Xhamisë ka pasur shumë gurë varrezash, tani kanë mbetur shumë pak prej tyre. Po ashtu, thuhet se edhe varri i nënës së poetit të madh, Jahja Qemal, gjendet këtu.

Mbi portalin e xhamisë gjendet edhe mbishkrimi në gjuhën arabe, me dy rreshta, të madhësisë 135 x 50.

Në mbishkrim thuhet se Xhamia është ndërtuar në vitin 880/1475 nga ana e Isa Beut. Tërmeti i vitit 1963 e ka dëmtuar pjesërisht Xhaminë në disa vende. Këto dëmtime janë evituar, Xhamia është meremetuar në kohë të duhur dhe është ende në gjendje të mrekullueshme.











# E TASHMJA E MEDRESESË ËSHTË TËRËSI E SË KALUARËS SË SAJ

**Pikërisht në këtë qëndron fshehtësia e përhershme e Medresesë tonë-detyra ndaj Allahut Fuqiplotë dhe njeriut dhe respekti i jetës dhe kohës. Në këtë, pra, qëndron fshehtësia e kulturës tonë, si " trashëgimi ( miraz ) të cilën të gjithë në mënyrë individuale dhe të bashkuar e trashëgojmë nga paraardhësit tanë " , të cilët e kanë ditur se çka kanë për detyrë dhe çka për respekt**

**PROF.IBRAHIM IDRIZI**

Ideja islame ka arritur në këto hapësira të Ballkanit dhe i ka përcaktuar kufijtë të cilat nuk paraqesin fundin e diçkaje ,por vetëm fillimin e asaj që ka arsyetim të ekzistojë në kohë dhe hapësirë.

Feja islame këtu tek ne solli kulturën si "mënyrë gjithëpërfshirëse për jetën e popujve"; si trashëgiminë e dukshme të cilën individi e trashëgon prej grupit të vet" si " përmbledhje e orientimeve të standardizuara për zgjidhjen e problemeve "; si "mekanizëm për rregullimin normativ të sjelljes " ; si " parime të cilat çdo njeri duhet t`i njohë ose të besojë se si të vepron në mënyrë që të jetë i pranuar për bashkësinë e tij".

Kufiri i kësaj kulture ka qenë dhe mbetet Medreseja. Ky, ndoshta, është fakti që e ka nxitë dijetarin e njohur el-Makdisiun për idenë që të bëjë periodizimin historik të institucioneve edukativo-arsimore në Islam, pra në periudhën para medreseve dhe atë pas medreseve. Por sido që të jetë, është fakt i pakundërshtueshëm se medresetë kanë luajtur rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin dhe institucionalizimin e diturive islame dhe të kulturës së saj. Në veçanti medresetë marrin një rol shumë të rëndësishëm atëherë kur paraqitet nevoja e kodifikimit të mësimeve islame.

Në këtë rast nuk dëshiroj të flas për të kaluarën e medreseve dhe rolin që ato e kanë luajtur, por gjithashtu nuk mund të ikim nga e kaluara, ngase me atë ne aftësohemi për të tashmen. Nuk ka dëm më të madh për mendjet e reja nga ajo që të nënçmohet e tanishmja. E tashmja është tërësia e të kaluarës dhe së ardhmes. Pra koha e Gazi Isa Beut si themelues i medresesë sonë nuk është aspak e kaluar më e vogël se ajo nga koha e Nidhamul-Mulkit si themelues i medresesë "Nidhamijje", e as koha e tashme e



Medresesë Isa Beu të ripërtërirë nga Bashkësia Islame e Maqedonisë nga koha e Isa Beut kur e themeloi Medresenë ISA BEU.

Nëse ende nuk e kemi të qartë, se përse Gazi Isa Beu në Shkup e themeloi medresenë e vet, e pastaj u ripërtëri dhe u zgjerua nëpër qytete tjera nga Bashkësia Islame ,me premisat fetare të Islamit do të ishte mirë të dëgjojmë vështrimin e një dijetari jo mysliman i cili thotë : " Thelbi i edukatës është në atë se ajo është fetare. Ju lutem, çka është edukata fetare? Edukata fetare është - vazhdon më tej ky dijetar- edukata që në vete ngërthen detyrat dhe respektin. Detyrat fillojnë nga kontrollimi i mundur mbi rrjedhat e ngjarjeve. Ku dituria e fituar mund të ndryshojë çështjen, kurse padituria i ngatërron dhe paraqet mëkat . Ndërsa themeli i respektit është perceptim që e tashmja në vete të përmbajë shumën e tërësishme të ekzistencës, para dhe pas, atë tërësi voluminoze të kohës, ajo është përhershmëria."

Pikërisht në këtë qëndron fshehtësia e përhershme e Medresesë tonë-detyra ndaj Allahut Fuqiplotë dhe njeriut dhe respekti i jetës dhe kohës. Në këtë, pra, qëndron fshehtësia e kulturës tonë, si " trashëgimi ( miraz ) të cilën të gjithë në mënyrë individuale dhe të bashkuar e trashëgojmë nga paraardhësit tanë " , të cilët e kanë ditur se çka kanë për detyrë dhe çka për respekt.

Parashtrohet pyetja, se ku qëndrojmë ne në raport me këto dy vlera – detyra ndaj të tjerëve dhe respekti ndaj jetës sonë? A e kemi harruar detyrën tonë ndaj Allahut Fuqiplotë, e kështu edhe ndaj njeriut? A e kemi humbur respektin ndaj vetvetes e kështu edhe ndaj të tjerëve? Kush jemi ne sot? Të të cilit jemi ne? Ku e kemi urtësinë? Ku e kemi zemrën? Ku e kemi shpirtin?

Cilat janë ato "parime të cilat çdo njëri prej nesh duhet t`i dijë ose të beson se si të punojë në mënyrën që është e pranueshme për tërë bashkësinë"? Te kush të kërkojmë strehim? Te ata të cilët dëshirojnë të na shkatërrojnë – coptojnë apo te ata të cilët na ofrojn ndihmë dhe mbrojtje? Cila traditë është më me rëndësi për ne – ajo e cila me vite të tëra don të na tjetërsojë nga feja dhe kultura jonë apo ajo e cila me shekuj na ka edukuar që të jemi besnikë ndaj Allahut të Madhërishëm dhe traditës së mirë të popullit tonë? A i kemi humbur vlerat tona të ndritura? Ku e kemi shpirtin tonë të respektit ndërmjet nesh? A e kemi humbur apo na kanë shkëputur nga shpirti jonë fisnik? Nëse e kemi humbur,atëherë a kemi dëshirë që të fillojmë ta kërkojmë? Nëse neve na e kanë shkëputur, a kemi guxim që ta këthejmë? Këtë që e thamë më lart në formë të pyetjeve, mendoj se do të zgjatë deri sa ne nuk e kuptojmë dhe t`i pranojmë vlerat që na i kanë lënë Amanet themeluesit tonë të Medresesë në hapësirat e Ballkanit, Në këtë rast, shumë i çmuari Gazi Isa Beu,respektivisht Bashkësia Fetare Islame në vendin tone na obligon, që fëmijët tanë dhe pasardhësit t`i edukojmë dhe arsimojmë në frymën e besim Islam drejtë një ardhmërie më të lumtur.



# Kujdes ndaj normave dhe ligjeve fetare



**Dijetari i njohur egjiptian Muhammed Gazaliu (v. 1996) thekson: "Kërkohet që të vihen nën kontroll ata që mundohen ta përgojojnë burimin dhe kulturën islame. Ata, të shtunën janë hulumtues të shkencave, të dielën e mësojnë atë, të hënën punojnë dhe veprojnë si mësues të asaj diturie, kurse të martën fillojnë të polemizojnë me dijetarët e mëdhenj, duke i fajësuar ata dhe duke thënë se 'edhe ne jemi njerëz, edhe ata janë njerëz'".**

PROF. DR. ZEKERIYA GULER*

Vërehet se në ditët e sodit është duke marrë një hov të madh specializimi dhe, po ashtu, vërehet se ai ka fituar një vlerë dhe famë të lartë nën moton "***nderi është themeli kryesor për specializim***". Ashtu sikurse lëmenjtë dhe degët që kërkojnë një specializim të sinqertë dhe një strukturë kohore, si: mjekësia, stomatologjia, arkitektura, po ashtu edhe shkencat fetare kërkojnë një kohë të gjatë dhe të veçantë, por edhe një disiplinë të thuktë për t'u studiuar dhe mësuar. Sikurse na mëson thënia e Pejgamberit: "*Ai që i dorëzohet dikujt që nuk ka njohuri mjekësore për shërim, vetë është përgjegjës për vdekjen e tij*", ekziston edhe ajo që thotë populli se 'gjysmëdoktori ta merr shpirtin'. Kështu që "Allahu xh. sh. nuk e

* Ligjërues i Shkencës së Hadithit në Universitetin e Selxhukut-Fakulteti Teologjik, Konja.

merr diturinë dhe shkencën nga populli i tij në mënyrë direkte, por Ai i humb dijetarët nga ai mes dhe në këtë mënyrë e humb edhe diturinë. Kur të humbet dituria dhe të mos mbesin dijetarët, atëherë njerëzit do t'i zgjedhin si udhëheqës injorantët. I pyesin ata dhe ata përgjigjen pa pasur dituri. Në këtë mënyrë, ata edhe vetë humbin e edhe të tjerët i humbin nga rruga e drejtë". Ngjashëm me këtë është, përsëri, edhe një thënie tjetër popullore: "*gjysmëhoxha ta humb fenë dhe imanin*". Natyrisht se edhe gjykatësi i paditur të bën padrejtësi, saqë ta humb dhe lirinë. Kështu që, kjo mund të theksohet edhe në të gjithë lëmenjtë dhe degët e shkencave të tjera.

Me plot të drejtë mund të themi se nuk ekziston diç tjetër pos fesë dhe besimit që mund t'i ofrojë një kuptim dhe shije jetës së njeriut. Pa dyshim se krijimi i një botëkuptimi të shëndoshë për fenë është i lidhur ngushtë me sinqeritetin rreth studimit dhe mësimit të fesë. Përveç kësaj, feja në vetvete përmban gjuhën e veçantë të saj, terminologjinë, procedurën, historikun dhe literaturën e saj. Nga kjo konstatojmë se për të parandaluar mosmarrëveshjet që bëhen në emër të fesë, ose për të parakaluar shkrimet e shumta përsëri në emër të saj, nevojitet që si mësues dhe udhëheqës të popullit në mënyrë zyrtare të jenë nga Bashkësia Islame apo organizatat tjera fetare qeveritare.

As'habi i njohur i Pejgamberit, a. s. Abdullah ibni Med'udi, lidhur me këtë thotë: "*I mangët në kokë është ai i cili përgjigjet në çdo pyetje që e pyesin njerëzit*". Edhe një thënie tjetër në bisedën e tij me shokët e vet është me shumë rëndësi: "As'habët e Pejgamberit a. s. në aspektin e botës së tyre shpirtërore ishin njerëzit më të pastër të ummetit. Po ashtu, ata ishin edhe më të thelluarit në shkencat fetare në krahasim me njerëzit tjerë. Ju jeni duke jetuar në një kohë kur ka më shumë dijetarë se sa llafazanë. Mirëpo, do të vijë një kohë kur do të ketë më shumë llafazanë se sa dijetarë. I takon lavdërimi atij që ka dituri të madhe, por që flet pak. Por, ai që nuk ka dituri, mirëpo flet shumë, meriton nënçmimin".

Mënyra e theksimit të udhëheqësit të muslimanëve Omer ibni Abdulaziz (v. 101/719) thuajse çdo gjë e hesht dhe e nxjerr në pah sikurse një yll ndriçues. Kjo më shumë ka të bëjë me parandalimin e atyre që polemizojnë rreth çështjeve fetare pa pasur njohuri. Ai thekson: "Kur të shihni një bashkësi nga mesi i një populli të thjeshtë, të cilët bisedojnë dhe polemizojnë për çështjet fetare, dijeni se ata janë duke vrapuar pas një humbjeje të çartë". Lidhur me këtë çështje edhe thënia e Xha'fer Sadikut (v. 148/765) është shumë me vend: "Të jeni mendjemprehtë dhe të zellshëm në çështjet e fesë së Allahut. Mos u bëni si të pacivilizuarit (mos qëndroni larg shkencës dhe diturisë). Sepse, ata që nuk e kuptojnë fenë në mënyrë të duhur, në ditën e kiametit Allahu xh. sh. nuk do t'i shikojë me një shikim mëshire dhe as që do t'ua pastrojë veprat e tyre".

Në këtë kontekst, vlerë shumë të madhe ka edhe kjo thënie e Imam Xha'fer Sadikut (v. 148/765): "Bëhuni të ditur dhe të mprehtë në fenë e Allahut dhe në çështjet fetare, e mos u bëni sikurse bedevitë. Sepse, ata që nuk e njohin fenë e Allahut dhe nuk kanë informata rreth imtësive fetare, në ditën e Kiametit Allahu xh. sh. atë person nuk do ta shikojë me mëshirë dhe asnjë vepër nuk do ta lajë".

Shumë mirë dihet se në ç'gjendje bie kur dikush del e flet në këtë aspekt pa pasur njohuri profesionale dhe pa hulumtuar asgjë. Dhe, këtë Ibni Haxher el-Askalani (v. 852/1448) e përkufizon në këtë mënyrë: "*Kur një njëri flet diçka jashtë profesionit të tij, nga goja e tij dalin thënie të çuditshme dhe pa vlerë*".

Qe shumë vite me radhë, përkundër dijetarëve të mëdhenj, kanë filluar të flasin shumë njerëz rreth çështjeve fetare, e ndoshta edhe vetveten e tyre e kanë parë të obliguar për këtë çështje. Në atë mënyrë sa që, kush di shkrimin e vjetër arab, osman etj. filloi të sigurohet në atë se ky ka edhe njohuri fetare islame. Por, më e keqja është se edhe gjeneratat e reja filluan të binden në thëniet e tyre se vërtet ata i posedojnë këto njohuri. Mirëpo, përkrah këtyre, ka edhe nga ata që pak a shumë merren me probleme fetare, e edhe disa nga politikanët dhe njerëzit me famë akademike në sfera të tjera nuk mbeten mbrapa, ose më mirë të themi nuk mund ta frenojnë veten pa u përzier në këto çështje.

Dijetari i njohur egjiptian Muhammed Gazaliu (v. 1996) thekson: "Kërkohet që të vihen nën kontroll ata që mundohen ta përgojojnë burimin dhe kulturën islame. Ata, të shtunën janë hulumtues të shkencave, të dielën e mësojnë atë, të hënën punojnë dhe veprojnë si mësues të asaj diturie, kurse të martën fillojnë të polemizojnë me dijetarët e mëdhenj, duke i fajësuar ata dhe duke thënë se 'edhe ne jemi njerëz, edhe ata janë njerëz'".

Vlen të ceken edhe vargjet e poetit Mehmed Akif Ersoj, i cili kishte emigruar dhe në Egjipt:

*Le të dalin në pah personat adekuatë*
*E të dimë njëherë se çka ka e çka s'ka;*
*Në mëngjes filozof, e kah iqindia fakir.*

***

Duhet të dimë edhe këtë se njohja e vetvetes dhe e virtyteve personale llogaritet si një shenjë begatie dhe pjekurie. Është një thënie që i dedikohet Aliut r. a.: Ai që e njeh të vërtetën, e ka njohur edhe Zotin e vet.

Nëse në një vend dikush vepron ashtu si duhet, kjo do të thotë se ai e njeh kapacitetin e tij dhe se kjo është një sjellje psiko-teorike, por edhe morale- praktike. Mënyra e sjelljeve duke e fshehur vetveten, apo duke e maskuar, llogaritet si një veti e shëmtuar; krahas kësaj, edhe pohimi dhe pretendimi i gjërave që nuk posedohen, është një sjellje dhe veti e keqe, e shëmtuar. Përveç kësaj, pohimet se "unë i di të gjitha gjërat, i bëj më së miri të gjitha

punët etj. nuk janë asgjë përveç se një ide e dështuar apo siç cilësohet në Kur'an –ata të cilët dëshirat dhe pasionet e tyre i konsideruan si zota, iu nënshtruan atyre. Mirëpo, njeriu i cili e njeh kufirin dhe mundësinë e tij, distancohet nga mendjemadhësia dhe mundohet të bëhet sa më modest dhe natyrisht që modestia e tij nuk e pengon këtë të mos shkruajë dhe as që mund të ndodh një gjë e tillë.

Në ditët tona, p. sh., vërehet se në lidhje me mbulimin e femrës muslimane shumë persona, secili prej tyre ose më mirë të themi çdokush, mundohet që nga këndi dhe vendqëndrimi i tij të flasë diçka. Në realitet, këto polemika nuk janë të reja fare, mirëpo këto gjëra burimin e kanë qysh pas Tanzimatit. Dihet shumë mirë se çështja e mbulesës është e argumentuar si me Kur'an, po ashtu edhe me Sunnet dhe mu për këtë çështje dijetari i mirënjohur Ýzmirli Ismail Hakkiu për periudhën që ka jetuar thekson: "Përderisa nuk do të ndërpritet urdhëresa për të mira dhe ndalimi nga e keqja - ***el-emru bi'l-ma'rûf ve'n-nehju ani'l-munker*** dhe përderisa të ketë pjesëtarë të diturisë së Islamit, pra, derisa ata do të jenë në rrugën e drejtë, nuk mund që aq lehtë të bisedohet me femrat në mënyrë të ëmbël. Nga kjo vërejmë se i ndjeri këtë lloj përgjigje ua ka dhënë atyre të cilët sigurisht se kanë filluar të ndërhyjnë në çështjet fetare pa pasur aspak njohuri. Siç ka treguar ky, nuk është vetëm pjesë e traditës mbulesa e gruas, por kjo është nga pikat dhe obligimet e patjetërsueshme të fesë.

Nuk është temë të cilën mund ta shtjellojnë politikanët apo ideologët e ndryshëm. Mbulesa: ajo është pjesë e themeleve të fesë. Dijetarët e fesë islame në lidhje me argumentimin e kësaj, pasi që përmendin Kur'anin, sunnetin, ixhmanë, kijasin dhe praktikimin e saj gjatë gjithë historisë, nuk e lënë pa e theksuar edhe atë se mohimi i një gjëje të tillë bën që personi të përjashtohet nga rrethi i imanit-besimit islam. Por, ata që thonë se 'unë besoj dhe jam i bindur në këtë urdhër të Allahut, por në jetë nuk mund ta e praktikoj', atëherë këta nuk mund t'i fusim në listën e atyre që kanë humbur besimin, pos t'u tregojmë se janë mëkatarë për moskryerjen e këtij farzi.

Allahu xh. sh. thotë:

"**Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos zbulojnë stolitë e tyre**



**përveç atyre që janë të dukshme, le të vejnë shamitë mbi kraharorin e tyre dhe të mos ua tregojnë bukuritë e tyre askujt përveç burrave të vet, baballarëve të vet ose baballarëve të burrave të vet, djemve të vet ose djemve të burrave të vet, vëllezërve të vet ose djemve të vëllezërve të vet, apo djemve të motrave të veta, ose grave të tyre (që u përmenden) dhe robëreshave, të cilat i kanë në pronësinë e tyre, ose shërbëtorëve meshkuj që nuk ndiejnë nevojë për femra ose fëmijët nuk kanë arritur pjekurinë për gra. Le të mos kërcasin me këmbët e tyre për të zbuluar fshehtësinë nga stolitë e tyre. Pendohuni të gjithë tek Allahu, o besimtarë, në mënyrë që të gjeni shpëtimin**". (Nur, 31). Fraza që kalon në këtë ajet "**përveç atyre që janë të dukshme**" sipas pjesës dërrmuese të dijetarëve aludon në duart dhe fytyrën dhe është theksuar se duart dhe fytyra nuk bën pjesë në pjesën e ndaluar ose nuk konsiderohen avret.

Sipas asaj që kuptohet nga Kur'ani dhe Sunneti i Pejgamberit a. s., mbulesa është një mburojë e cila e mbron nderin e familjes dhe është shkak që personin pak më tepër mund ta drejtoje te mëshira e Allahut. E kundërta e kësaj që është lakuriqësia, personin e drejton kah e keqja.

Nëse çështjet fetare ua lëmë në dorë atyre që janë anëtarë të shkencave dhe diturive tjera, atëherë studenti - studentja në universitet, punëtori – punëtorja, deputeti – deputetja dhe të gjithë fshatarët apo qytetarët do të mbesin të etur rreth fesë islame. Në këtë rast do të lindin probleme të papritura dhe të papërmirësueshme brenda një kohe të shkurtër. Për të qëndruar larg këtyre polemikave dhe këtyre problemeve të mundshme, kërkohet që të veprojmë në atë mënyrë siç na urdhëron ajeti i Kur'anit Fisnik: "**Pyetini dijetarët (personat adekuatë) për ato gjëra që ju nuk i dini**" Nahl, 43.

**Përktheu: Mr. Zymer Ramadani**

# Domethënia besimore e frikës ndaj Allahut xh.sh.

## (Shpjegim akaidologjik i thënies së Imam A'dham Ebu Hanifes r.h.)

**Ebu Hanife r.h. ka thënë: *"Kur robi i bindet - nënshtrohet Allahut, për shkak të besimit të plotë që ka për Të, tek ai njeri lind shpresa për Allahun dhe frika prej Tij. Njeriu që i ka këto tri cilësi (bindjen - nënshtrimin, shpresën dhe frikën) konsiderohet se e adhuron Allahun. Në të kundërtën, njeriu që nuk shpreson për Allahun dhe nuk i frikësohet Atij, nuk konsiderohet besimtar (në Allahun e Madhërishëm).***

**ORHAN BISLIMAJ**

Imam Ebu Hanife r.h. në citatin e sipërthënë potencon tri cilësi që e karakterizojnë besimtarin nga aspekti i devotshmërisë së tij ndaj Allahut. Ato janë '*nënshtrimi*' (الطاعة), '*shpresa*' (الرجاء) dhe '*frika*' (الخوف). Njeriu që e beson Allahun, e ka obligim të natyrshëm besimor që t'u nënshtrohet urdhëresave dhe ndalesave të Tij; të shpresojë në Të në të gjitha veprimet e tij dhe, mbi të gjitha, ta përshkojë besimin e tij me frikë të mirëfilltë ndaj të Madhërishmit. Në këtë punim do ta trajtojmë çështjen e 'frikës' (الخوف) ndaj Allahut, si një prej tipareve që bashkon në vete edhe nënshtrimin ndaj Allahut edhe shpresën ndaj Tij, po edhe devotshmërinë në përgjithësi, sepse po nuk ekzistoi frika ndaj Allahut, nuk e ke as nënshtrimin ndaj Fjalës së Tij, as shpresën për Të, as devotshmërinë.

### DOMETHËNIA ETIMOLOGJIKE DHE TERMINOLOGJIKE E "FRIKËS"

Shprehja الخوف (el-havfu) është infinitiv i llojit I të foljeve (*eth-thulathijju el-muxher-rredu*). Koha e shkuar bën خاف (hafe), koha e tashme dhe e ardhshme bën يخاف (juhafu), kurse infinitivi bën خوفا (havfen); مخافة (mehafeten) dhe خيفة (hifeten), që nënkupton shqetësimin e njeriut, për shkak se "*parashikon që t'i vijë (t'i ndodhë) ajo që është e urrejtur, apo t'i humbë ajo që është e dashur*" (توقّعَ حلولَ مكروه أو فوْتَ محبوب).

Ndërsa, në aspektin terminologjik '*frika*' (الخوف) identifikon "*frikën ndaj Allahut të Madhërishëm.*" Si term akaidik, '*frika*' (الخوف) *konsiston me ndjenjën besimore të besimtarit,*



*i cili duke e besuar sinqerisht Allahun e Madhërishëm për Krijues të Vetëm, si dhe duke qenë i vetëdijshëm për përgjegjësinë e veprimeve të tij në raport me zbatimin e urdhëresave dhe ndalesave të Allahut, i frikësohet Allahut dhe dënimit të Tij, në këtë botë dhe në botën tjetër.*

**POENTA E ÇËSHTJES**

Le të themi se frika ndaj Allahut, në realitet, është imani i mirëfilltë i njeriut. Sipas thënies që u cek të Imam Ebu Hanifes r.h., kuptohet qartë se (mos)frika ndaj Allahut është një testim real i vetëdijës besimore të besimtarit. Imani është ai që njeriun e bën të frikësohet ndaj Allahut dhe jo dikush tjetër. Si konstatim i kësaj, frika është produkt i imanit. Nëse te besimtari mungon frika ndaj Allahut, atëherë kemi të bëjmë me mungesë të efekteve aktive të imanit, respektivisht me iman të paralizuar. Mungesa e efekteve aktive të imanit ndodh për shkak të mosstabilizimit të mirëfilltë të imanit në zemrën dhe shpirtin e besimtarit. Ky mosstabilizim, e që mund të ndodh për shkaqe të ndryshme, referon shumë dyshime dhe paqartësi kundrejt qenies së imanit. Ndërsa dyshimet dhe paqartësitë janë kontradikta të imanit dhe e pengojnë besimtarin që t'i frikësohet Allahut të Madhërishëm dhe ta adhurojë Atë.

Pikërisht këtu është poenta e çështjes, ku imani i besimtarit që nuk është i pajisur me frikë ndaj Allahut, karakterizohet me shumë dyshime dhe paqartësi, të cilat nuk e lënë të japë rezultate, respektivisht e lëkundin imanin. Prandaj, Ebu Hanife në këtë thënie me mjaft mençuri ka interferuar se për të qenë adhurues i Allahut, përpos që duhet t'i nënshtrohesh Atij dhe të shpresosh për Të, duhet që edhe t'i frikësohesh Allahut, duke konkluduar se "*ai që nuk i frikësohet Allahut, nuk është edhe besimtar*."

Çka do të thotë kjo? Për ta kuptuar këtë thënie të Ebu Hanifes r.h., pra, se frika ndaj Allahut është shpirti i imanit, ndërsa mosfrika ndaj Tij konsiderohet mosbesim, nevojitet të sqarojmë:

**Njohjen me frikën ndaj Allahut;**
**(Se) besimtari është i detyruar t'i frikësohet Allahut;** dhe
**Domethënien akaidologjike të (mos)frikës ndaj Allahut.**

**I. NJOHJA ME FRIKËN NDAJ ALLAHUT**

**1.1. Çka nënkupton frika ndaj Allahut?**

Pa dyshim, frika është tipar i natyrshëm i njeriut. Këtë askush nuk e kundërshton dhe as nuk e mohon. 'Frika që e manifeston dhembjen e zemrës dhe shqetësimin e saj për shkak të parashikimit të diçkaje të papëlqyer në të ardhmen', dëfton dobësinë e njeriut. Fakti se njeriu nuk është i plotfuqishëm, është dëshmi se ai është i pafuqishëm. Janë shumë argumente logjike që e vërtetojnë këtë. Karakterizimi i tij me ndjenja, dëshira, padituri, kënaqësi, lakmi, ego, etj. tregojnë se ai është qenie e nevojshme. Njeriut i mjafton ta shikojë vetveten dhe të bindet për pafuqishmërinë e vet. Vetë qenia e tij dhe jeta që bën nuk janë meritë e njeriut. Të gjitha të mirat, të cilat i shfrytëzon njeriu e pa të cilat ai nuk mund të ekzistojë, po ashtu nuk janë meritë e tij. Nga toka merr frytet, ndërsa nga qielli e gëzon shiun. Ndërrimi i ditës dhe i natës, ndërrimi i stinëve, ajri dhe funksioni i diellit, janë mirësitë elementare, pa të cilat nuk mund të ekzistojë asgjë e gjallë. Burimi i gjallërisë së njeriut është i themeluar në këto të mira, që përsëri nuk janë meritë e tij. Prandaj, ai është i pafuqishëm dhe i nevojshëm për mirësitë e Atij i Cili i ka krijuar këto kushte të volitshme për jetesë. Nëse për një moment i mungon ajri, nuk ka ku ta kërkojë atë.

Nëse njeriu qenka i pafuqishëm,



dhe ai i tillë është (shih: En-Nisa:28), shtrohet pyetja: kush është i plotfuqishëm? Të gjithë njerëzit, pa marrë parasysh dallimet e tyre fetare rreth perceptimit të Qenies së Lartë, pa hezitim thonë se Zoti është i Plotfuqishëm. Sepse, të gjithë njerëzit kanë nevojë për mirësitë e Allahut. Kësaj i dorëzohen të gjithë, pa dallim - besimtarët dhe jobesimtarët, deshën ose s'deshën: Ky është kuptimi i ajetit **"... E Atij i është dorëzuar gjithë ç'ka në qiej e në tokë, me dashje e pa dashje"** (Ali Imran: 83). Pra, kjo është e vërteta. Allahu është i Plotfuqishëm dhe askush tjetër. Sapo ta kemi kuptuar këtë, kemi arritur ta kuptojmë edhe realitetin e frikës së njeriut dhe kahjen e orientimit të saj.

Njeriu, deshi ose s'deshi, duhet t'i frikësohet të Plotfuqishmit, e Ai është Allahu, sepse i nënshtrohet Atij. I Plotfuqishmi nuk i nënshtrohet askujt, përndryshe nuk do të ishte i tillë. Ndërsa i pafuqishmi i nënshtrohet dhe e ka ndjesinë e frikës ndaj të Plotfuqishmit. Fëmija i frikësohet prindit, sepse ndihet i pafuqishëm kundrejt tij. Njeriu i frikësohet pushtetit, sepse e beson ekzistencën e tij dhe fuqishmërinë e tij. Njeriu frikësohet nga vdekja, sepse nuk mund ta ndalë atë. Po ashtu i frikësohet sëmundjes, etj...

Ngjashëm është me besimtarin, i cili i frikësohet Allahut, sepse e beson Atë dhe plotfuqishmërinë e Tij. Prandaj i nënshtrohet Atij, duke i zbatuar të gjitha urdhëresat dhe ndalesat që i ka urdhëruar në Kur'an. Atë e shpreson, Atë e adhuron dhe ndaj Tij frikësohet. Në dallim nga të gjitha llojet tjera të frikës, frika ndaj Allahut është frika e vërtetë. Ajo ka karakter cilësor, që përligjet me dashuri dhe respekt të thellë ndaj Allahut. Nuk është frikë teknike, sikurse është frika nga kanosja e rrezikut, ose ikja nga bisha e egër, e kështu me radhë. Kjo, sepse besimtari e do Allahun më shumë se çdo gjë tjetër. Urdhrat e Tij i zbaton, për arsye se janë vlerë e pazëvendësueshme. Emannuel Kanti (1724-1804) thoshte: "*Feja përmban detyrime që obligohen nga urdhri i Zotit, por ato nuk kryhen vetëm pse janë të urdhëruara, po pse janë udhëzim i Qenies së Lartë.*"



Prandaj, themi se ekzistojnë dy lloje legjitime të frikës ndaj Allahut:

Frika për shkak të dashurisë dhe njohjes së Allahut; dhe

Frika për shkak të dënimit të rëndë të Tij.

### 1.2. Frika për shkak të dashurisë dhe njohjes së Allahut

Muslimanët janë besimtarë të Allahut, sepse e kanë perceptuar besimin në mënyrë të natyrshme, të lirë dhe pa presion. Secili besimtar i sinqertë është fanatik në jetësimin e asaj që predikon besimi i tij. Këtë nuk e bën për shkak të presionit ose frikës, në kuptimin teknik të fjalës, por për shkak të njohjes së vlerës që përmban besimi (imani). Sepse, kur njeriu nuk dëshiron të bëjë një veprim, insistimi me imponim është i pasukses. E si do të jetë kjo me besimin (imanin), kur dihet se ai është tërësisht i dëlirë nga presioni dhe interesi i momentit? Besimtari i frikësohet Allahut, në mos për diçka tjetër, nga njohja e të mirave të Tij që ia dhuron në çdo moment. Por, këtë e dinë vetëm ata që meditojnë rreth krijimit të Allahut. Në këtë aspekt të frikës është ajeti i Kur'anit: "**Po Allahut ia kanë frikën nga robërit e Tij, vetëm dijetarët**." (Fatir, 28); dhe hadithi i Pejgamberit a.s.:"*Më shumë nga ju që i frikësohet Allahut dhe që e njeh më së miri Atë, jam unë*".

Sipas këtyre dy citateve, frika e mirëfilltë ndaj Allahut themelohet në njohjen e Allahut, respektivisht në njohjen e shkaqeve që dëftojnë Madhërinë e Tij. Kjo do të thotë se, sa më shumë që e njohim Allahun, aq më shumë e kemi frikë Atë.

Besimtarët e sinqertë i frikësohen Allahut për hir të asaj që Allahu është Allah dhe meritor për ad-

hurim, dhe pastaj edhe për hir të mirësive që na dhuron në çdo çast. Njerëzit kultivojnë dashuri reciproke për shkak të interesave të përbashkëta. Ky është një realitet i pashmangshëm i shoqërisë njerëzore. Edhe nga ky aspekt, nëse njeriu duhet ta dojë dikënd më së shumti, përsëri është Allahu, sepse interesi nga Ai përshkon gjithë jetën e njeriut.

Si shembull ideal të frikëdashurisë ndaj Allahut, sa për ilustrim, e përmendim rastin e myezinit të Pejgamberit a.s., Bilal Habeshiut r.a., i cili mbetet i pashlyer në kujtesën tonë. Kur ai e përqafoi fenë islame, akoma ishte rob i një politeisti (mushriku) me emrin Umejjete bin Halef, i cili kur mori lajmin se 'robi' i tij e besonte Allahun dhe i është bashkuar në besim Muhamedit a.s., e maltretonte për çdo ditë me torturat më të rënda, në mënyrë që ky të hiqte dorë nga imani dhe të kthehej në atë që kishte qenë më parë, në politeizëm. Por, çdo përpjekje e tij ishte e kotë, sepse Bilali r.a. ishte bindur në vlerën e fesë islame. Besimin në Allah nuk e kishte thjesht për shkak të frikës si një cilësi formale, sepse askush nuk e kërcënonte për mosbesim, por për shkak të njohjes dhe respektit ndaj Atij që është Krijues dhe dhurues i të gjitha të mirave. Kjo ishte frika më e madhe për të. Prandaj nuk hiqte dorë dhe, në vlugun e maltretimeve, vazhdimisht e përsëriste shprehjen 'ehadun' 'ehadun' – 'Një' 'Një', që do të thotë Allahu është një, i vetëm. Dhe, thoshte: '*Pasha Allahun, nuk e ndyej gjuhën time, pasi që atë ma ka pastruar Allahu me iman.*' Për këtë qëndrim Bilali r.a. absolutisht nuk shihte interes të drejtpërdrejtë, kundrejt dhunës që e përjetonte në çdo moment. Këtë energji pa dyshim ia dhuronte dashuria e sinqertë ndaj Allahut dhe njohja e Madhërisë së Tij. Shembuj si Bilalli kemi shumë. Të gjithë besimtarët e parë thuajse e kishin fatin e njëjtë.

Prandaj, është konstatim i drejtë besimor se frika që është e përligjur me dashuri ndaj Allahut, respektivisht me njohjen e Tij, është ajo që kërkohet nga të gjithë besimtarët. Kjo frikë, në realitet, identifikon devotshmërinë e njeriut, ose siç njihet me emrin '*takvallëk*' (et-takva). Fjala '*et-takva*' rrjedh prej foljes '*veka*' ose '*el-vikajeh*' dhe nënkupton frikërespektin ndaj Allahut.

**1.3. Frika për shkak të dënimit të rëndë të Tij**

Frika nga dënimi i Allahut zakonisht është frika e masës së gjerë të muslimanëve. Kjo frikë është e nivelit tjetër, nga frika përmes njohjes (argumentit) dhe më lehtë përjetohet. Si e tillë, ndonjëherë mund të dobësohet për shkak të dobësimit të besueshmërisë në Allah, po edhe mund forcohet duke e përkujtuar dënimin e Allahut ndaj popujve të ndryshëm dhe mundësia që ai të vijë në çdo moment. Pastaj, kur njeriu mendon rreth dënimeve të Allahut në botën tjetër, pa dyshim që kjo e ngacmon zemrën e njeriut për frikë. Për shembull, janë akte të llahtarshme përkujtimi i vdekjes, pastaj nata e varrit, pyetjet e munkerit dhe nekirit, ringjallja dhe brenga e tubimit para Allahut, llogaridhënia dhe peshimi i veprave, kalimi i urës së siratit dhe çaste të tjera të vështira. Të gjitha këto reflektojnë frikë të vërtetë. Ky lloj i frikës perceptohet nga dy aspekte: a) duke medituar rreth dënimit të Allahut në këtë botë; dhe b) duke medituar rreth dënimit të Allahut në botën tjetër.

A) Frika nga dënimi i Allahut në këtë botë ka mbështetje të gjerë në Kur'an dhe në Hadith. Në shumë vende në Kur'an Allahu thotë: **"Udhëtoni nëpër tokë dhe shikoni se si ishte përfundimi i kundërshtarëve."** (En-Neml, 69), duke sinjalizuar për përfundimin tragjik të atyre që kundërshtuan udhëzimin e Allahut, si dënim nga Allahu.

Po kështu kemi dëshmi të shumta nga thëniet e Pejgamberit a.s. në hadithin që e transmeton Sulejman bin Jesar nga Aisheja r.a., bashkëshortja e Pejgamberit a.s., e cila ka thënë: 'Nuk e kam parë të Dërguarin e Allahut të qeshë derisa t'i duket pjesa e fytit, por vetëm buzëqeshte (në shenjë shqetësimi). Kjo vërehej në fytyrën e tij, sidomos kur shihte ndonjë re ose erë'. Aisheja r.a. i ka thënë:

*"O i Dërguar i Allahut, unë i shoh njerëzit se gëzohen kur shohin ndonjë re duke shpresuar se ajo do të lëshojë shi, ndërsa te ti vërej të kundërtën, kur e pe atë re, në fytyrën tënde u vërejt pakënaqësia. (Pejgamberi a.s.) Tha: O Aishe, kush më siguron mua se në të nuk ka dënim? Një popull është dënuar me erë dhe kur e panë dënimin thanë: Kjo re do të na sjellë shi"*.

Ky hadith i referohet popullit Ad, që jetonte në Ahkafë, një vend në Jemen i tëri me rërë të imët, i cili refuzoi mësimet e pejgamberit të vet, Hudit a.s., bile i thanë: "Na sill sa më shpejt dënimin me të cilin na kërcënohesh". Po ai, sikurse edhe të gjithë pejgamberët e tjerë, e dinte se ajo është punë e Zotit, e jo e pejgamberit. Një ditë, mbi luginat e tyre ku mbillnin bereqetin, u shfaq një re e dendur dhe ata u gëzuan kur e panë dhe menduan se do të binte shi, mirëpo ajo erë solli një frymë të stuhishme, e cila zhduku çdo gjë, edhe vetë ata.

B) Ndërsa, sa i përket frikës nga dënimi Allahut në botën tjetër, po ashtu ka shumë argumente. Në ajetin ku Allahu thotë: **"Thuaj: Unë i frikësohem dënimit të një dite të madhe, nëse e kundërshtoj Zotin tim"** (Ez-Zumer, 13), në mënyrë shumë të qartë paraqitet 'dënimi' në ditën e kiametit si premisë për frikë ndaj Allahut, i cili mund të pasojë për shkak të kundërshtimit ndaj fjalës së Tij. Në një ajet tjetër, Allahu u drejtohet besimtarëve: **"Dhe, ruajuni zjarrit që është përgatitur për pabesimtarët"** (Ali Imran, 131). Po kështu, në një vend tjetër në Kur'an Allahu xh.sh., duke vënë theksin te robërit e Tij neglizhentë ndaj fjalës së Tij, i frikëson me kërcënim të xhehenemit. **"Se ata do të kenë shtresa të zjarrit edhe sipër edhe përfundi. Me këtë Allahu i frikëson robërit e vet: O robërit e Mi, kijeni frikë** (dënimin)**!"** (Ez-Zumer, 16).



# Shembulli më i përkryer për të gjitha vetitë e mira

**“Vërtet ti je në një shkallë të lartë të moralit.” (El Kalem:4)**

REXHEP ZIBERI

Vetë emërtimi paraqet respekt dhe dashuri. Emri “Muhamed” s.a.v.s. ka domethënien e falënderimit dhe lavdërimit, është i lavdëruar tek Allahu f.p., te Melaqet e tij dhe te të gjithë besimtarët e besimit islam. Për më tepër, ai është i dërguar, mëshirë, për mbarë njerëzinë dhe është i vlerësuar në atë pozitë siç e vlerësoi vetveten duke thënë: “Ditën e gjykimit do të jem zotëria i gjithë njerëzve dhe këtë nuk e them për krenari; unë do të jem i pari që do t’i hapet varri, i pari që ndërmjetëson dhe i pari që përfiton nga ndërmjetësimi”. Ai gjithashtu tha: ”Me të vërtetë jam i dërguar për t’i plotësuar virtytet e moralit të mirë”.

Nga veçoritë më të lavdishme të Muhamedit a.s. është dhuntia morale, të cilën Kur’ani famëlartë e përshkruan në shkallën më të lartë:

**“Vërtet ti je në një shkallë të lartë të moralit.” (El Kalem:4)**

**“Ju e kishit shembullin më të lartë (mrekullueshëm) në të dërguarin e Allahut; kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin (mëshirën) e Allahut në botën tjetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shumë shpesh Allahun”. (Ahzabë:21)**

Këto janë vlera të veçanta me të cilat e ka stolisur Allahu f.p. Nëse shikojmë vlerat e tij, gjejmë se ato janë nga më të ndritshmet në mesin e gjithë asaj që ka njerëzia. Muhamedi a.s. thoshte: “Më i miri prej jush është ai që ka vlera morale; e unë për këto jam më i miri”.

Ai ishte shembulli më i përkryer për të gjitha vetitë e mira.

Ai ishte më i devotshmi, më i

miri, më i sinqerti, më besniku, më bujari, më i mëshirshmi. Shokët e tij e përshkruanin me fjalët më të mira si nga vlerat morale, ashtu edhe nga cilësitë personale të tij.

Buhariu në Sahihun e tij transmeton nga Abdullah bin Amri, i cili thotë se në lidhje me cilësitë e Pejgamberit a.s. në Teurat ka qenë e shkruar: "Muhamedi është rob dhe i dërguari im; atë e kam quajtur Mutevekkil; nuk është i rreptë dhe i vrazhdtë, e as zhurmëtar në treg; të keqen nuk e kthen me të keqe.

Ai fal dhe është zemërgjerë. Ai nuk do të vdes para se të udhëzojë popujt e devijuar, derisa të thonë *La Ilahe Il-Lallah*. Me Muhamedin do të hapen sytë e verbër, do të dëgjojnë veshët e shurdhër dhe do të shpëtojnë zemrat e ngulfatura".

Të gjitha këto ai i vërtetoi edhe në praktikë. Ai i solli njerëzisë të gjitha të mirat e kësaj bote dhe të botës tjetër. Nuk ka dyshim se ishte më i dobishmi i gjithë njerëzve. Dallohej për ato që thoshte. Kishte aftësinë e shprehjes së mendimit më të gjatë me fjalët më të shkurtra. Atë që e thoshte, e përsëriste që të kuptohej më mirë dhe nuk linte gjë pa sqaruar.

Ai tha: "Kush e beson Allahun dhe ditën e fundit, le të thotë fjalë të mira ose të heshtë".

Përsosmëria morale e Muhamedit a.s. nuk mund të përshkruhet me fjalë; më madhështore në krejt këtë është ajo se ai është kualitet i lindur, spontan dhe i frymëzuar. Ai për vetveten ka thënë: "Mua më edukoi Zoti im dhe Ai e zbukuroi edukatën time."

E pyetën Aishen r.a.: "Si ka qenë morali i Pejgamberit a.s.?" Ajo ka thënë: "Lexoni Kuranin f.l. fillim e mbarim; çfarëdo që të shihni brenda tij, ai ka qenë Muhamedi a.s."

Për nga edukata, Muhamedi a.s. ishte i butë, ishte i mëshirshëm, ishte i drejtë si në vepër, ashtu edhe në fjalë; ishte i matur në fjalë, nuk fliste pa nevojë, nuk e lakmonte këtë botë dhe atë që është në duart e njerëzve.

Mëshira për Muhamedin a.s. është thelbi i jetës së tij; drejtësia për të është ligj, ndërsa sjellja e mirë është pjesë e besimit.

Sipas tij, mëshirën që bëhet ndaj të tjerëve Allahu f.p. e llogarit si bamirësi që i drejtohet personalisht Atij. Mu për këtë Pejgamberi a.s. thotë: "Në ditën e gjykimit Allahu f.p. do të thotë: 'O njeri, isha i sëmurë e ti nuk më vizitove'. Njeriu do të pyet: 'O Zot, si të të vizitoj kur Ti je sundues i botëve?' Allahu do të përgjigjet: 'A nuk e dite se ai dhe ai ishin të sëmurë e ti nuk i vizitove? A nuk e dije se sikur t'i vizitoje, do të më gjeje Mua atje...?"

Mëshira e Muhamedit a.s. përfshinte çdo gjallesë të rruzullit. Mëshira dhe butësia te Muhamedi a.s. është esencë e jetës dhe zbukurim i saj.

Se Ai ka qenë shumë i drejtë, është pasqyruar edhe në faktin se asnjëherë nuk është tërhequr nga hulumtimi i të vërtetës. Drejtësia dhe morali i tij u ka ardhur njerëzve si një lehtësim dhe shpëtim për ta. Tek ai të gjithë kanë qenë të barabartë para ligjit për t'u gjykuar. Ka qenë më dorëdhënësi nga të gjithë njerëzit, ka qenë tolerant dhe gjithnjë ka anuar kah falja; shumë lart e ka çmuar amanetin; ka qenë modest dhe shumë i kujdesshëm. Allahu f.p. e ka edukuar me një edukatë shembullore dhe e ka udhëzuar në parime të shkëlqyeshme morale.

Nuk e lakmonte as këtë botë e as atë që është në duart e njerëzve:

Ai tha: "Mos lakmo në këtë botë, që të të dojë Allahu dhe mos lakmo atë që është në duart e njerëzve, që të të duan ata". A ka njeri në historinë njerëzore që posedon këto virtyte fenomenale?

## BESIMI DHE MORALI

Besimi, morali dhe sjellja e mirë janë ngushtë të lidhura njëra me tjetrën dhe kanë disa pika të përbashkëta njëra me tjetrën:

- I është përmendur Pejgamberit a.s. se një grua agjëron shumë, falet dhe ndan sadaka. Porse, ka një mangësi, edhe atë - i shqetëson dhe u bën dëm fqinjëve të saj.



Pejgamberi a.s. ka thënë: "Ajo do të jetë banor i xhehenemit." Gjithashtu, i është thënë se është një grua e cila nuk falet shumë, as që agjëron shumë dhe as që ndan sadaka shumë, mirëpo asnjëherë nuk i shqetëson fqinjët e saj. Pejgamberi a.s. ka thënë: "Ajo do të jetë banor i xhenetit."

Omer bin El Hatabi r.a. ka thënë: "Nëse nuk ndodhen tre cilësi te personi, atij nuk i bën dobi besimi ose nuk e ndjen shijen e tij: durimi

me të cilin përballon padituriinë e injorantëve, frika që e ruan të mos bie në gjëra të ndaluara dhe morali me të cilin sillet me njerëzit".

- Muhamedi a.s. sqaroi se punët e mira, bamirësia dhe morali, që të gjitha, bëjnë pjesë në përkufizimin e sadakasë. Ai tha: "Çdo përshëndetje në mes njerëzve është sadaka. Të pajtosh dy veta është sadaka. T'i ndihmosh ndokujt të hipë mbi kafshë ose t'ia ngarkosh valixhet është sadaka. Fjala e mirë është sadaka. Çdo hap që shkon për të falur namaz është sadaka. Të largosh një mbeturinë nga rruga është sadaka."

Ali bin Ebu Talib r.a. ka thënë: "Kush i zotëron këto katër virtyte, Allahu do t'ia kthejë punët e këqija në të mira. Ato janë: sinqeriteti, turpi, mirënjohja dhe morali i mirë".

- Përveç kësaj, Muhamedi a.s. na mësoi se edukata e keqe dhe karakteri i prishur i asgjësojnë veprat e mira. Muhamedi a.s. ka thënë: "I humbur është ai që do të vijë në ditën gjykimit me namaz, me zeqat, me agjërim, por që, ndërkohë, e ka sharë fqinjin e vet, e ka mallkuar atë, ia ka marrë pasurinë atij, ia ka uzurpuar pasurin atij, e ka rrahur atë. Si shpagim llogarish, të dëmtuarit do t'i jepet nga veprat e mira të këtij. E, nëse i mbarojnë veprat e mira, merren gjynahet e të dëmtuarve dhe i ngarkohen këtij. Mandej do të hidhet në zjarr."

Ibni Abbasi r.a. ka thënë: "Morali i mirë i shkrin mëkatet mu si dielli që shkrin akullin. Ndërsa morali i keq i prish punët sikurse uthulla që e prish mjaltin".

Hasan El Basriu ka thënë: "Kush e ka moralin e keq, e torturon vetveten. Kujt i shtohet pasuria (me moral të keq-shënimi ynë), i shtohen mëkatet. Kush flet shumë, bën shumë gabime".

### VIRTYTI DHE MORALI I MIRË

Uabisa bin Mabedi tregon: "Shkova tek i Dërguari i Allahut a.s. dhe më tha: 'Ke ardhur të më pyesësh se ç'është virtyti?' Po, i thashë unë. Atëherë Ai më tha: 'Pyete zemrën tënde! Virtyt është ajo me të cilën ndërgjegjja jote është e kënaqur. Mëkat është ajo që ta turbullon shpirtin dhe të rrotullohet (të ngacmon) në kraharor, edhe nëse njerëzit ta thonë të kundërtën'".

Bazuar në hadithet e Pejgamberit a.s., me shprehjen moral i mirë, sipas botëkuptimit islam, nënkuptohet çdo vepër e mirë – si: fytyra e qeshur, moslëndimi i të tjerëve, të jesh i drejtë në raport me njerëzit, të jesh i butë në debate e diskutime, të jesh i drejtë kur gjykon, të jesh bamirës edhe në fshehtësi, t'u japësh përparësi të tjerëve edhe kur je i varfër, të bësh shoqëri të mirë, të durosh lëndimet e të tjerëve, të kryesh të gjitha detyrimet, t'u largohesh të gjitha gjërave të ndaluara etj.

Ndërsa fjala virtyt nënkupton çdo gjë që e ka kërkuar sheriati islam në formë detyrimi ose që e ka konsideruar të pëlqyeshme, prandaj në antitezë me virtytin është vënë mëkati, i cili përbën çdo gjë të ndaluar nga ky sheriat.

Othmani r.a. thotë: "Katër gjëra nga jashtë janë virtyt, kurse nga brenda janë detyrim:

1. Shoqërimi me njerëz të urtë është virtyt, kurse qëndrimi pranë tyre është detyrim;
2. Leximi i Kur'anit është virtyt, ndërsa veprimi sipas tij është detyrim;
3. Vizita e varrezave është virtyt, ndërsa përgatitja për të është detyrim;
4. Vizita e të sëmurit është virtyt, ndërsa për ta marrë këshillën prej tij është detyrim.

Disa njerëz të mençur mbi moralin kanë thënë:

Shtatë veti janë pjesë e moralit të besimtarit:

Të ulesh me të varfrit

Të pyesësh dijetarët

Të qëndrosh me njerëzit e urtë

Të qëndrosh pranë të devotshmëve

T'u largohesh njerëzve të këqinj

Të jesh i vazhdueshëm në kryerjen e adhurimeve

Të zotërosh sjellje fisnike

### HADITHE MBI MORALIN

Morali i sinqertë para dhe pas të gjithave do të thotë bujari morale dhe sjellje shembullore me njerëzit. Në këtë kuptim, radhisim disa hadithe të Muhamedit a.s. që kanë të bëjnë me moralin e mirë:

"Allahu është bujar dhe i do sjelljet fisnike."

"Në ditën e gjykimit asgjë nuk do të rëndojë më tepër në peshoren e besimtarit se sa morali i mirë."

"Bamirësia është nga morali i mirë."

"Besimtarë më të përkryer janë ata që kanë moral të mirë."

"Më i dashur prej jush tek unë dhe më afër meje në ditën e gjykimit do të jenë ata që kanë moral të mirë."

"Besimtari me moral të mirë arrin në shkallën e atij që agjëron dhe që falet (nafile)."

"A doni t'ju lajmëroj kush nuk do të hyjë në zjarr (xhehenem)?…Çdokush që është i qetë, i butë dhe i edukuar."

"Ju asnjëherë nuk do t'i kënaqni njerëzit me pasuritë tuaja, por do t'i kënaqni me fytyrë të gëzuar dhe me moral të bukur."

"Morali i bukur i përfiton të mirat e kësaj dhe të asaj bote."

Sa flet vetëm ky hadith i fundit?! Fjala e bukur dhe sjellja bujare e vënë njeriun në pozita më të mëdha tek Allahu f.p. dhe te njerëzit.

Kjo është madhështia e moralit te Muhamedi a.s.: Të bëhesh zotëri i sjelljeve tua. Emri yt në veshët e njerëzve të tingëllojë si thirrje për ndihmë. Muhamedi a.s. realizoi përsosmëri të atillë morale, pas së cilës nuk kemi se ç'të dëshirojmë!

Mirëpo, krahas kësaj, ai gjithmonë i drejtohej Allahut f.p. me këtë lutje:

"O Zot, zbukuroje moralin tim edhe më tepër!"

Kush dëshiron ta përsos moralin e vet, le të marrë shembull nga morali i Muhamedit a.s., i cili para pesëmbëdhjetë shekujsh e pasuroi njerëzimin me cilësitë më të larta të moralit.

# Pse duhet ta mbrojmë traditën tonë islamo-shqiptare?!

**Propagandimi kundër (ose inferioriteti i disa të tjerëve) ndaj traditës sonë, se gjoja nuk paskëshim qenë në rrugën e drejtë, se kemi gabime në besim e mendim; se praktika jonë fetare bie "ndesh" me traditën pejgamberike, etj., tregon për tendencën e tyre për një zëvendësim të opusit dhe trashëgimisë sonë fetare, me një tjetër, e krijuar në rrethana dhe momente krejt të veçanta nga ai i fatit tonë.**

**MEHAS ALIJA**

Në fillim shoqëritë i krijuan traditat e tyre, e që më pas, me pak përjashtime, do të mbetej si ligj që ato të vareshin prej tyre. Shoqëritë me traditë janë të afta që ta ruajnë stabilitetin e brendshëm nga njëra anë, dhe t'iu përballojnë ndërhyrjeve dhe ndikimeve të traditave të shoqërive të tjera, nga ana tjetër.

Nisur nga kjo e mësipërmes, kuptojmë përgjigjen e pyetjes, të shënuar si titull të këtij shkrimi. Pse, vallë, duhet të shqetësohemi për zhdukjen e traditës? Pse është kaq e rëndësishme ruajta e saj? Dhe a ka gjasa mbijetese, një shoqëri e cila papërfillshëm ndërron traditën dhe trashëgimin e saj?!

Thënë të drejtën, sot trashëgimia e përgjithshme shqiptare kanoset nga tëhuajsimet dhe ndikimet e jashtme të shoqërive të tjera. Kriza e mendimit, e teologjisë, e moralit, etj., është çdo ditë e më e ndjeshme. Më e ndjeshme është kanosja e përzierjes së traditës sonë fetaro-kombëtare, me disa adete e zakone të huaja, të cilat janë më shumë të karakterit lokal, nacional dhe ideologjik sesa pastër fetar. Në fakt, kjo është tema e diskutimi tonë. **A jemi duke e ndërruar traditën tonë islamo-shqiptare?** Ç'ligjërim teologjik sot zhvillohet në mesin e intelektualëve dhe hoxhallarëve tanë? Ç'gjuhë fetare, shkollare dhe praktike përdoret sot në vendet e ligjërimit edukativo-fetar? Kemi apo nuk kemi rrezik të zhdukjes apo të ndërrimit të traditës sonë fetare? Këto dhe pyetje të tjera na detyrojnë të mendojmë, mbase si të shqetësuar, për fatin e trashëgimisë dhe traditës sonë shumë shekullore të kultivuar dhe zhvilluar, brez pas brezi, me sakrifica të mëdha, nga njerëz që dëshmuan për vlerat e tyre të besimit, atdhedashurisë, iluminizmit dhe veprimtarisë.

### Dezorientimi i shoqërisë

Kohëve të fundit, në trevat tona janë paraqitur individë dhe organizata të ndryshme kulturore, edukative e fetare, me tendenca të qarta, e që nga ligjërimi i tyre kuptohet se flasin për një "ripërtëritje" dhe kuptim të ri të mendimit dhe interpretimit të fesë, apo fare nuk tregojnë interes ndaj gjendjes dhe realitetit islam të shqiptarëve, porse më shumë interesohen që të realizojnë misionin për të cilin dikush, nga jashtë, i ka përgatitur.

Ideja nuk është për një reformim dhe tejzhvillim të asaj që kemi trashëguar deri më tani si potencial kulturor e fetar, por për një ndërrim të shkollës, mendimit dhe praktikumit të fesë. Ky diskurs dhe ligjërim mëton në atë që një traditë e vjetër të shpallet e pavlefshme, madje-madje edhe e lajthitur, për të mbjellë një tjetër, të re, e krijuar dhe kultivuar në një tjetër ambient, brenda një shoqërie, komplet, me histori, doke, kulturë dhe traditë tjetër. Kjo nuk ka se si të kuptohet ndryshe, por vetëm si një sulm dhe degradim i trashëgimisë sonë fetare e kombëtare. Ç'është më e rëndësishmja, kjo i shkon për shtati propagandës antiislame dhe antishqiptare, e cila nuk e dëshiron shoqërinë tonë të fuqishme përpara synimeve të tyre djallëzore për ta zhveshur atë nga petku fetar dhe nga vlerat e saja të pastra moralo-etike.

"Interpretuesit" e rinj të Islamit në mesin e shqiptarëve, shumica e tyre e shkulluar dhe përgatitur jashtë vatrës arsimore të këtij populli, tregohen të pamëshirshëm, dhe herë-herë të vrazhdë, ndaj popullit të tyre kur kritikojnë besimin, shkollën, praktikën fetare, dhe traditën e tij në përgjithësi.

Nga ana tjetër, shoqëria jonë shqiptare, e gjetur e dobët në këto kohë, qoftë si shoqëri me organizmi dhe autoritet të dobët politik, qofte edhe në fushën e shkencës, mendimit dhe arsimimit fetar, po përjeton kohën e shoqërisë islame të shekujve V-VI të hixhretit.



Bota islame, atëherë, ishte e rraskapitur nga destabilizimi i shtetit Abasid; sulmet e ushtrisë së kryqëzatave nga Perëndimi nga njëra anë, kurse sulmet e ushtrisë gjakpirëse mongole nga Lindja, nga ana tjetër. Në këtë periudhë, popullata muslimane nuk gjeti strehim tjetër pos të strehohet tek ata njerëz, thirrës, të cilët më shumë interesoheshin për botën shpirtërore, ideologjike e sektare, sesa për rikthimin e stabilitetit politik, shoqëror e territorial të Shtetit islam.

Një gjë e këtillë më duke se po ndodh edhe me ne sot. Mesihët janë paraqitur dhe kërkojnë që popullata t'ju kthehet atyre, e cila e shastisur, në mungesë të shkollarëve të denjë dhe të institucioneve të fuqishme të cilat do ta mbronin traditën e saj, po kahëzohet drejtë polarizimeve dhe vetëmohimit!

#### TOLERANCA NDËRSHOQËRORE

Tani, le t'iu kthehemi pak disa arsyeve se **pse duhet ta mbrojmë traditën tonë islamo-shqiptare.**

**E para,** Feja islame u bë pjesë e kulturës dhe jetesës shqiptare prej më tepër se pesëqind vjetësh. Kjo ka bërë që ne sot të kemi një bagazh të pasur me kulturë dhe traditë, të cilën, falë Islamit, e ruajtëm dhe u identifikuam me të. Normat tona të kodit moral, social, familjarë, të cilat janë zhvilluar përgjatë shekujve si rrjedhojë e faktorëve të ndryshëm, siç janë trashëgimia, ligjet, klima, industria, shijet kombëtare, gërshetimi i kulturave, të përshtatura dhe të vlerësuar me parametrin e *teksteve* islame, përbëjnë një vlerë dhe specifikë të veçantë në diversitetin kulturor, qytetërues në fushën e gjërë të Qytetërimit islam. Së këndejmi, shkollën të cilën e ndoqi populli ynë, është shkolla e cila ka përfshirje më të gjërë në botën islame: **shkolla sunnite hanefito-maturidite**, shkollë të cilën e kanë përvetësuar edhe perandori të mëdha islame (Abbasitët dhe Osmanët). Pasur për bazë themelet, parimet, mësimet dhe urtësitë e kësaj shkolle, tradita jonë është shumë më e aftë për të vazhduar më tutje për t'u futur në "planetin" fetar të cilin e përbëjnë besimet e të gjithë popujve. Për këtë ka shumë arsye, por unë do të theksoja vetëm këtë: sepse është **e hapur dhe e fuqishme**. Thirrja për ndërrimin e traditës apo ligjërimi i ri ideologjik, doktrinar, do ta ndryshonte në mënyrë rrënjësore botëkuptimin e shqiptarëve për tolerancë mes veti dhe ndaj marrëdhënieve të mira me fetë dhe besimet e tjera.

**E dyta,** ndërrimi i traditës do të sillte rreziqe shumë të mëdha për një pjesë të madhe të shoqërisë. Regresi fetar do të ishte kërcënuesi më i fuqishëm i saj dhe për një kohë shumë të shkurtër do të përjetonim një kolaps kulturor e shpirtëror. Propagandimi kundër (ose inferioriteti i disa të tjerëve) ndaj traditës sonë, se gjoja nuk paskëshim qenë në rrugën e drejtë, se kemi gabime në besim e mendim; se praktika jonë fetare bie "ndesh" me traditën pejgamberike, etj., tregon për tendencën e tyre për një zëvendësim të opusit dhe trashëgimisë sonë fetare, me një tjetër, e krijuar në rrethana dhe momente krejt të veçanta nga ai i fatit tonë. Është absurde t'ia veshësh një popullit një traditë, të cilën ai nuk e ka krijuar dhe zhvilluar vetë.

**E treta,** nëse ne do ta ndërronim



traditën e të menduarit tonë islamik, respektivisht shkollën e mendimit tonë, atëherë cila do të ishte ajo traditë apo shkollë e cila do të ishte si zëvendësuese dhe sa do të ishte ajo e aftë për ta ruajtur shoqërinë nga asimilimi prej traditave jomuslimane dhe njëkohësisht edhe për t'u përballë me to?! Nga ligjërimet e "interpretuesve" të rinj, te një pjesë dërmuese e këtyre, kuptojmë që bëhet fjalë për një traditë që i përket **lëvizjes selefijje**, e cila është një lëvizje me protagonistë dhe kolorite të ndryshme, porse një gjë e kanë të përbashkët: thirrjen për të kuptuar Islamin nga e para. Por, vallë, sa kjo lëvizje ishte e aftë dhe pati sukses në ato shoqëri tek të cilat u paraqit dhe u zhvillua, për të pasur sukses tek ne? Cilat janë sukseset e saj, e që ne të admirohemi nga to? Nëse e marrim si shembull **selefijjen saudite**, pasi që në trojet tona ballafaqohemi më së shumti me idetë e kësaj shkollë, e prej të cilave tradita jonë sulmohet më së shumti, atëherë shqetësimi do të rritet edhe më shumë, sepse kjo degë e selefijjes konsiderohet, nga një pjesë e madhe e shkencëtarëve të matur, si puritane, e mbyllur dhe nuk lejon kurrfarë bashkëpunimi me kundërshtarët në mendim. Zëvendësimi i traditës sonë, e cila u gatua në atë mënyrë për të qenë e aftë për të bashkëjetuar dhe bashkëvepruar me të tjerët, me të cilët dallojmë në besim, gjuhë, kulturë, etj., me një tjetër traditë, në këtë rast me traditën dhe **mendimin selefist**, do të implikonte paragjykime dhe ngërçe shoqërore, ideologjike dhe politike.

**E katërta**, lejimi i atakimit të traditës sonë fetare do të ishte gabimi më i madh që do ta bënim; mbase kjo do t'u shkonte për dëshire mohuesve të identitetit tonë oriental (lexo: islam), sepse kjo për to do të ishte shumë më lehtësuese që ta superiorizionin elementin kristian në krahasim me elementin islam te shqiptarët.

**E pesta**, kthimi nga e para, që po kërkohet, nuk synon lidhjen me kohën e artë të Islamit, porse me këtë të mundësohet ndikimi dhe influenca e atyre shteteve nga të cilat burojnë këto ide dhe mësime, etj..

Pra, pa dashur që të zgjatem edhe më shumë, pasi që natyra opinioneske e këtij kontributi nuk lejon një gjë të tillë, besojë se do të ishte e mjaftueshme theksimi i katër a pesë arsyeve të përmendura, e me të cilat dëshiroj ta ngre çështjen në një nivel shqetësimi, në mënyrë që të mos luajmë me zjarrin e besimit, sepse mund të na djeg të gjithëve. Tradita jonë fetare, ndërkohë, ka pësuar shtresime dhe ndryshime nga ajo që do të duhej të ishte, por assesi të lejojmë që për këto devijime dytësore, në vija sipërfaqësore, të rrënohet e gjithë ajo trashëgimi dhe shkollë të cilën e zhvilluam dhe e ruajtëm, me shumë vështirësi e peripeci. Jam pro një reformizmi brenda opusit tonë tradicional, duke shmangur disa praktika të cilat, për kohën tonë, nuk do ta luanin rolin e dikurshëm që patën apo t'ju japim një dimension tjetër, me efekt modernizues dhe më praktik, por assesi të pajtohem për ndërrime rrënjësore brenda mendimit, shkollës dhe thelbit të traditës sonë islame.

# PERSONALITETI i jetimit në Islam

**”Ata që e hanë pa të drejtë pasurinë e jetimëve, në të vërtetë ata hanë atë që mbush barkun e tyre zjarr dhe ata do të futen në zjarrin e xhehenemit.”( En-Nisa:10)**

**ZELIJE ZIBERI**

Në terminologjinë islame “jetim” te gjinia njerëzore konsiderohet ai fëmijë të cilit i vdes babai dhe që është nën moshën e pjekurisë.

Legjislacioni islam i kushton kujdes të veçantë dhe vëmendje të jashtëzakonshme fëmijës së mbetur jetim dhe shumë qartë ka përcaktuar të drejtat e tij në sheriatin e pastër të Allahut fuqiplotë.

Në kohën e zbritjes së Kur’anit famëlartë kjo shtresë e njerëzve ishte e përbuzur dhe e nënçmuar nga shumica e njerëzve të asaj kohe. Kësaj kategorie njerëzish Islami i kushtoi kujdes të veçantë.

Pas besimit në Allahun fuqiplotë, çrrënjosja e kësaj dukurie negative ishte një ndër prioritetet primare të Islamit.

Nëse i analizojmë gjërat nga këndvështrimi human, do të pyesim se ç’faj kishte jetimi i shkretë që të përbuzej e të nënçmohej nga idhujtarët paganë të asaj kohe? Ç’faj kishte një fëmijë i shkretë që nuk e ndjeu ngrohtësinë e gjirit familjar e që nuk u rrit me përkëdhelje prindërore?!

Islami erdhi që këto zemra kaq të ashpra, që nuk ndjejnë aspak dhembshuri ndaj jetimit, t’i zbut ndaj kësaj krijese të dëlirë e të pafajshme, për të cilën vetë Allahu fuqiplotë e urdhëron të Dërguarin e tij, e nëpërmjet tij edhe tërë ummetin kur thotë:

**“E mos e përçmo (poshtëro) jetimin!”** (Ed-Duha:9)

Kur’ani famëlartë në shumë vende thërret për përkujdesje të vazhdueshme ndaj jetimit, për edukimin e tij dhe furnizimin e tij derisa të arrijë moshën e pjekurisë dhe të jetë i gatshëm të ballafaqohet me jetën dhe vështirësitë e saj.

Ndërsa, duke folur për jetimët, Muhamedi a.s. tregohet akoma më i kujdesshëm. Kjo për vetë rëndësinë që Allahu fuqiplotë u jep vend të



posaçëm jetimëve në Kur'an. Fjala jetim përmendet në 12 kaptina të Kur'anit dhe në 23 ajete.

**MUHAMEDI A.S. JETIM**

Duhet përmendur këtu se edhe vetë Pejgamberi a.s. ka qenë jetim. Ndoshta është vështirë të paramendohet se njeriu i cili me lejen e Allahut e ndryshoi botën, ka lindur jetim, pasi babai i tij, Abdullahu, ndërroi jetë para lindjes së të birit. Pejgamberi a.s. jo vetëm që lindi jetim, por edhe u rrit jetim, edhe atë me plot kuptimin e fjalës, pasi që në moshën gjashtëvjeçare i vdiq edhe e ëma, Eminja. Ky është jetimi i cili u rrit nën mbikëqyrjen e kujdesin e Allahut fuqiplotë. Pas vdekjes së gjyshit të tij, Abdul Mutalibit, Allahu i Madhërishëm ia mundësoi strehimin dhe kujdesin nga xhaxhai i tij Ebu Talibi. Allahu i Madhërishëm thotë në Kur'an për Pejgamberin a.s.: **"A nuk të gjeti** (Allahu) **ty** (o Muhamed) **jetim dhe të dhuroi strehim e kujdesje?" (Ed-Duha:6)** Me ketë ajet kuptojmë se jetimit duhet t'i japim përkrahje dhe të kujdesemi për rritjen dhe strehimin e tij.

Nëse hyjmë në kopshtin e fjalëve të Pejgamberit a.s., do të gjejmë shumë hadithe të cilat thërrasin që të sillemi butë e me mëshirë ndaj jetimit, të mos jemi zemërgurë e të vrazhdtë ndaj tij. Ja se ç'thotë Mësuesi i njerëzisë për jetimin:

"Kur qan jetimi (nga ndonjë padrejtësi që i është bërë), nga vaji i tij i përmallshëm dridhet Arshi i Mëshiruesit dhe në atë moment Allahu i madhërishëm i pyet melaqet: 'Kush është ai që e ka bërë të qajë këtë jetim, babanë e të cilit e ka mbuluar dheu?' Melaqet thonë: 'O Zoti ynë, vetëm Ti e di këtë gjë!' Atëherë Allahu f.p. u drejtohet përsëri melaqeve: 'Dëshmoni, o ju melaqet e Mia, se ai që e ndal dhe qetëson vajin e këtij jetimi dhe e bën të gëzueshëm, Unë atë njeri do ta kënaq në ditën e Kiametit (Llogarisë)'.

Për këtë vepër madhështore na motivon i Dërguari a.s. kur thotë:



"Unë dhe kujdestari i jetimit në xhenet jemi kështu: - dhe bashkoi gishtin tregues dhe gishtin e mesëm."

Pejgamberi a.s. ka thënë: "Shtëpia më e mirë ndër muslimanët është ajo shtëpi në të cilën ndodhet një jetim dhe që mirë trajtohet, ndërsa shtëpia më e keqe ndër muslimanët është ajo shtëpi në të cilën ndodhet një jetim e që keqtrajtohet."

Ai gjithashtu thotë: "Ai që afron pranë një jetim dhe përkujdeset për furnizimin e tij, kjo do të jetë perde shpëtimtare nga zjarri në ditën e gjykimit. Dhe, atij që i lëmon flokët jetimit nga dhembshuria për të, për çdo fije flokut të prekur prej tij do t'i shënohet nga një mirësi."

**PASURIA E JETIMIT**

Pasuria e jetimëve duhet ruajtur me besnikërinë dhe kujdesin më të madh dhe të mos u dorëzohet derisa të arrijnë moshën e pjekurisë. Allahu i madhërishëm thotë: **"Nëse vëreni se janë pjekur** (jetimët)**, atëherë jepjuani pasurinë e tyre!"** (En-Nisa:6)

Ngrënien e pasurisë së jetimit Pejgamberi a.s. e ka konsideruar si një prej gjynaheve të mëdha dhe sa i përket atij që e keqpërdor pasurinë e jetimit, atë Allahu fuqiplotë e ka kërcënuar me ndëshkim të rreptë në zjarr të xhehenemit kur ka thënë:

**"Ata që e hanë pa të drejtë pasurinë e jetimëve, në të vërtetë ata hanë atë që mbush barkun e tyre zjarr dhe ata do të futen në zjarrin e xhehenemit."** (En-Nisa:10)

Është e njohur shprehja se ai që nuk e ka diçka, nuk mund ta japë atë. Nëse fëmija jetim nuk mëshirohet në vegjëli, ai nuk ka për të mëshiruar të tjerët kur të rritet. Nëse shtrohet pyetja se përse Allahu dhe i dërguari i tij i dhanë kaq rëndësi çështjes së jetimit, përgjigjja është se përkujdesi dhe dhembshuria ndaj jetimit në zemrat e njerëzve do të duhej të zgjonte ndjenjën e mëshirës dhe të butësisë, virtyte këto që duhet ta stolisin çdo besimtar të devotshëm.

Në anën tjetër, ishte urtësia e madhe e Allahut fuqiplotë, i Cili përcaktoi që shpalljen e fundit t'ia besonte një jetimi, i cili nuk e takoi fare babanë, emrin dhe namin e të cilit e ngriti mbi tërë njerëzimin.

Qëllimi final i këtyre porosive tradicionale islame ndaj jetimit është çrrënjosja e veseve nga një shoqëri dhe edukimi i shpirtit me vlera të larta humane dhe morale. Ata që i përgjigjen kësaj thirrjeje, janë të shpëtuar; ata që refuzojnë, do të jenë të mjerë dhe të larguar nga mëshira e Allahut të madhërishëm.

Duke u nisur nga këto premisa, mund të konkludojmë se Islami ishte dhe mbeti sistem i përkryer i jetës praktike të njeriut në të gjitha aspektet, sistem i cili ofron bindshëm koncept të pazëvendësueshëm mbarënjerëzor.

# Muzika e teqesë dhe format e saj



**Simbolika e semasë (valles rituale) është manifestim i lëvizjes së trupave qiellorë, ku udhëheqësi i semasë (mentori) simbolizon diellin ose aksin e sistemit dinamik të galaktikës, ndërsa të tjerët simbolizojnë planetët, pra bëhet fjalë për një valle kozmike për unifikim me kozmosin**

**MR. ABAS JAHJA**

Format e muzikës që u shfaqën dhe u interpretuan nëpër teqet e tarikateve të ndryshme me qëllim të pastrimit dhe të ngritjes shpirtërore, quhet muzikë mistike ose, me fjalë të tjera, muzika e tesavufit. Sipas mendimit të mistikëve muslimanë, muzika luan rol të rëndësishëm në jetën e njeriut dhe shërben si urë lidhëse midis njeriut dhe Krijuesit.

Muzikën fetare mund ta klasifikojmë në:

Muzikë fetare
Muzikë e teqesë

Edhe pse këto dy lloje të muzikës kanë shumë specifika të përbashkëta, përsëri hasim në disa veçori karakteristike që dallojnë njëra nga tjetra, si nga ana e stilit ashtu edhe nga ana e interpretimit. Një ndër veçoritë elementare dhe me karakter të veçantë është ajo se muzika e xhamisë është muzikë vokale, ndërsa ajo e xhamisë përpos asaj që është vokale, është edhe instrumentale.

Lloji i muzikës që shfaqet nëpër teqe me qëllim të ngritjes shpirtërore, quhet "muzikë mistike"ose "muzikë e tesavufit". Sipas mistikëve (sufive), muzika luan rol të rëndësishëm në jetën e njeriut si në aspektin personal, po ashtu edhe në atë racional dhe shërben si mjet që e afron njeriun te Zoti i vet.



Çdo tarikat ka dhikret e veta, të cilat praktikohen në ditët dhe netët e veçanta. Këto dhikre që bëhen në ditët dhe netët e veçanta në kuptim të përgjithshëm emërtohen si "rite" ose me fjalë të tjera "ajin".Këto rite përbëhen nga dy komponentë: me ndihmën e poezisë dhe të muzikës, ku në të shumtën e rasteve fillojnë me "Evradet" e tarikateve.

Evradet janë vepra që këndohen nga ana e dervishëve dhe kryesisht janë vepra të kompozuara. Pasi që mbaron Evradi, kalohet në dhikër, ku një grup vazhdon me dhikrin ndërsa grupi tjetër vazhdon të këndojë ilahi të ndryshme, që kanë të bëjnë me ditën ose me natën përkatëse. Këta ilahi udhëhiqen nga "Zakirbashi" udhëheqësi kryesorë ose me fjalorin profesional muzikorë nga solisti. Zakrbashi është një profesion shumë i rëndë , sepse për të arritur deri në këtë shkallë duhet që të dijë më së paku 2000 ilahi përmendsh, gjë që për kohën e sotme është e parealizueshme. Përveç kësaj, të ketë zërin e bukur dhe njohje profesionale muzikore, që të njohë kapërcimet në mes mekameve për të bërë kapërcime adekuate gjatë ndërrimit të mekameve, sepse nëse nuk pasohet kjo rregull prishet harmonia muzikale që mbretëron gjatë dhikrit.

Një ndër detyrat tjera të rëndësishme të Zakirbashit është edhe përgatitja e repertuarit, zgjedhja e ilahive sipas javës dhe muajit përkatës p.sh. nëse është muaji rebiul evvel ose rebiul ahir, merren parasysh ilahitë për lavdërimin e cilësive të personalitetit të Muhamedit a.s.

Dhikret e tarikateve bëhen në format e ndryshme, mirëpo këto forma mund t'i analizojmë në dy grupe:

Dhikri Kuudi (duke qenë ulur), dhikri i këtillë fillon me një tempo të ngadaltë , tempi mbahet me anë të kokës duke nisur nga ana e djathtë dhe duke vazhduar në anën e majtë. Tempi me këtë fillon të përshpejtohet dhe kështu mbaron dhikri.

Dhikri kijami (duke qenë në këmbë), ky lloj dhikri ka dy forma:

Rrotullimi në të djathtë dhe në të majtë

Të kapurit për dore njëri me tjetrin duke formuar një hallkë dhe këmba e parë hedhet para ndërsa e majta prapa dhe vazhdon me një tempo permanente. Kjo formë është quajtur edhe devram (rrotullim).

Në këtë formë të ritmeve ekziston një gjallëri e madhe ritmike.

Muzikën mistike në mënyrë më artistike e kanë interpretuar mevlevitë. Format e kompozimeve muzikore që i interpretojnë me qëllim të ngritjes shpirtërore emërohen "Ritet e Mevlevive". Njëherit këto forma muzikore janë edhe format më madhështore të muzikës mistike.

Tekstet e këtyre kompozimeve janë të nxjerra nga tekstet e mistikut të madh Mevlana Xhelaludin Rumiu, që emërohen si Mesnevi dhe Divani Kebiri e që janë të shkruara në gjuhën persishte.

Rituali (vallëzimi) i mevlevive përbëhet prej katër pjesëve dhe secila pjesë merr emrin Selam. Gjatë selameve përdoren ritme dhe mekame të ndryshme.

Këto rituale emërtohen edhe me emra të tjerë si: Sema, Mukabele dhe Ajini Sherif (rrotullimi i mevlevive gjatë shfaqjes së ritualit).

Sema është fjalë arabe, që e ka kuptimin e dëgjimit dhe lirisht mund të themi se është një meditim dhe vendosje e lidhjes aktive me Krijuesin absolut.

Simbolika e semasë (valles rituale) është manifestim i lëvizjes së trupave qiellorë, ku udhëheqësi i semasë (mentori) simbolizon diellin ose aksin e sistemit dinamik të galaktikës, ndërsa të tjerët simbolizojnë planetët, pra bëhet fjalë për një valle kozmike për unifikim me kozmosin.

Po ashtu, edhe teshat që i veshin semazenët kanë domethënien e tyre simbolike. Veshja e bardhë simbolizon qefinin e kufomave, po ashtu mbi veshjen e bardhë dervishët janë të mbuluar me një kaftan (xhube) të zezë dhe të gjerë, që paraqet tokën ose varrin, kurse në kokë mbajnë kapela (sikke) të larta nga leshi i përpunuar, që simbolizojnë gurin e varrit.

Semaja bëhet në këtë mënyrë:

Në fillim lexohet Na'ti Sherifi, që do të thotë lavdërimi i cilësive të Pejgamberit a.s. nga një solist i veçantë, i cili qëndron në këmbë;

Bëhet një improvizim (taksim) me Naj nga ana e Kryenejzenit dhe atë në mekamin adekuat në të cilin do të lexohet Ajini Sherifi (rituali) atë ditë;

Pastaj interpretohet Peshrevi, hyrja instrumentale nga ana e tërë orkestrit;

Fillimi i këndimit të ritualit është i kompozuar nga ana e kompozitorëve të mirënjohur të muzikës mistike;

Peshrevi i fundit;

Në fund, përsëri taksimi i fundit nga ana e një Nejzeni dhe me këtë mbaron rituali i semasë.

Nga kjo mund të konkludojmë se qëllimi i semasë është arritja e unifikimit me Zotin (Vusul) nëpërmjet përkushtimit dhe meditimit të thellë.

Zëri i FSHI
SHTOJCË INFORMATIVE DHE KULTURORE E STUDENTËVE TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE ISLAME

*" Zoti ynë bëne të sotmen tone më të mire se të djeshmen, ndërsa të nesërmen tone më të mire se të sotmen ".*

*Hadith kudsijë:*

*Allahu xh.sh thotë: "Unë jam në mendimin e robit tim kur ai më kujton Mua, Unë jam me të kur ai më përmendën Mua, nëse më përmendën Mua në veten e tij, e përmendi Unë atë në Veten Time, nëse me permendën në një masë, e përmendi Unë atë në një masë më të mirë se ajo, nëse afrohet nga Unë një shpull, afrohem kah ai një krahë"(transmeton muslimi)*

# RESPEKTIMI i Liderit

**"O ju që keni besuar, bindjuni Allahut, respektoni të dërguarin dhe përgjegjësit nga ju". (Nisa:59)**

**SHABAN TAHIRI, VITI IV**

Muslimani e ka për obligim ta thotë të vërtetën kur kërkohet ajo prej tij. Po ashtu, e ka obligim që ta pranojë atë kur t`ia paraqesin, pasi që në shumë raste hasim në persona të cilët për një hadith lënë anash me dhjetëra, vetëm e vetëm për shkak se nuk i përgjigjet ideologjisë së tij të cilën e përkrah. Kemi hasur në njerëz të cilët thirren në hadithin e mosrespektimit të krijesës kur hidhërohet Krijuesi. Me këtë hadith ata duan të kundërshtojnë shumë hadithe ku urdhërohet ndjekja e udhëheqësit, pasi dikush i ka marrë si jo serioze vërejtjet që ka bërë Pejgamberi a.s. ndaj atyre të cilët nuk e respektojnë udhëheqësin, kur ky fenomen në vendet tona është përhapur shumë, por jo vetëm te ne, por edhe në Kosovë, Shqipëri, Bosnjë, ku disa



lëvizje ekstreme mundohen të uzurpojnë Bashkësitë e muslimanëve. Këto grupe mendojnë se sqarimi i të vërtetës është obligim, por edhe përçarja është obligim. Këtë e kemi hasur. Ata janë të gatshëm të përçahen me vëllanë e tyre për shkak të çështjes së rënies në sexhde me këmbë së pari apo me duar. Janë të gatshëm të kalojnë orë të tëra duke debatuar një çështje nga fikhu dhe në fund të ndahen duke e urrejtur njëri-tjetrin. Kjo nuk është në pajtim me moralin e as'habëve, të cilët kishin mendime të ndryshme, por nuk përçaheshin, si rasti kur Ibën Mes'udi tha në lidhje me namazin e kalifit Uthman: "Namazi i Uthmanit nuk është korrekt." Ai nuk ka heshtur, siç mendojnë disa muslimanë se duhet heshtur para gabimit. Përkundrazi, ai nuk ngurroi t'i thoshte kalifit Uthman se namazi i tij ishte gabim dhe në kundërshtim me sunnetin e Pejgamberit dhe, me gjithë këtë, ai u fal pas tij në namaz. Pasi që e pyetën Ibën Mes'udin se përse veproi kështu, u përgjigj: "Përçarja është sherr."

## ÇKA THOTË KUR`ANI NË LIDHJE ME KËTË?

Për këtë do të cekim ajetin në të cilin Allahu xh.sh. u drejtohet njerëzve duke u thënë: **"O ju që keni besuar, bindjuni Allahut, respektoni të dërguarin dhe përgjegjësit nga ju". (Nisa:59).** Pra, këtu vihet theksi, se pas respektit të Zotit dhe të Pejgamberit a.s. kërkohet po ashtu të respektohen ata të cilët janë zgjedhur nga ne për udhëheqës. Pra, nëse themi se jemi ndjekës të fjalës së Zotit, atëherë duhet të pranojmë të tërën e jo vetëm ato pjesë që na konvenojnë neve.

## ÇKA THOTË HADITHI NË LIDHJE ME KËTË?

Po ashtu, do të cekim disa hadithe të Pejgamberit a.s., në të cilat ai ka tërhequr vërejtjen në lidhje me këtë çështje:



-Pejgamberi a.s. ka thënë: *"Nëse dikush prej jush paraqitet gjersa mbi ju mbretëron një sundimtar dhe ky tjetri dëshiron t`ju përçajë e t`ua shkatërrojë komunitetin, vrajeni!"*

Ose, versioni tjetër: *Goditeni me shpatë në kokë, pa marrë parasysh kush është ai*! (Muslimi, 1852)

-Pejgamberi a.s. në një hadith thotë: *"Kushdo që të vijë e t`ju përçajë, duke qenë ju të bashkuar, vrajeni atë, kushdo qoftë ai". (Muslimi, vëll.3, f.1470).*

Si dhe: *"Kur t'u pranohet pushteti dy kalifëve, mbytini të fundit prej atyre dyve"* (Ahmedi dhe Muslimi nga Ebu Seidi, sikur në Sahih el-Xhamius-Sagir 421).

*"...Kush i besatohet imamit (kryetarit) dhe ia jep dorën dhe frytin e zemrës, le ta respektojë sa mundet. E, nëse vjen ndonjë tjetër dhe i konkurron (prijësit), atëherë mëshojini qafës (prejani kokën d.m.th. konkurruesit)"* (Muslimi, 3/1472-1478, nr. 1851).

-Nga Ebu Umame r.a. transmetohet se e ka dëgjuar Pejgamberin a.s. në haxhin e lamtumirës se ka thënë: *"O njerëz! Kini frikë Allahun, falni pesë namazet ditore, agjëroni ramazanin, jepni zeqatin, binduni prijësve tuaj dhe do të hyni në xhenetin e Zotit tuaj!" (Tirmidhiu, 616)*

-Në sahihun e Muslimit nga Ebu Dherri transmetohet të ketë deklaruar: "Miku im i afërt (a.s.) më ka këshilluar të jem i dëgjueshëm dhe i bindur, madje edhe nëse prijës është një rob i gjymtuar zezak. (Muslimi, 648).

Pejgamberi a.s. ka thënë: *"Dëgjoni dhe nënshtrohuni, po edhe nëse ai që ju urdhëron është një rob abisinas, që e ka kokën si rrushi i thatë"* (Fet`hul Bari –Buhariut vëll. XIII, fq. 130).

Transmetohet prej Umu Husejnit se ka dëgjuar Pejgamberin a.s. në haxhin e lamtumirës duke thënë: *"Bile, edhe nëse ju caktohet për udhëheqës një rob, i cili ju udhëheq me librin e Zotit, dëgjojeni dhe nënshtrojuni"* (Muslimi nr. 1838).

-Po ashtu thotë: *"Ai që më bindet mua, i është bindur Allahut xh.sh. e ai që i bindet emirit tim, më është bindur mua; e kush e kundërshton atë,*



*më ka kundërshtuar mua". Mutefekun alejhi (*Fet`hul Bari vëll. VI f.135 si dhe vëll. XIII f.119, nr.7137; Muslimi vëll. III f. 1466 nr. 1466 dhe 1835; dhe Ahmedi vëll.1, f. 252).

-Po ashtu, në një hadith thotë: *"Ai që vdes dhe mbi supet e veta asnjëherë s'ka bërë blatim (për besnikëri dhe nënshtrim) ndaj prijësit, ka vdekur me vdekje të injorancës.* (Muslimi, 3/1478, nr.1851; Sahih).

-Buhariu dhe Muslimi transmetojnë nga Ubade b. Samit se ka thënë: "Na thirri i Dërguari a.s. për t'u betuar dhe ne u betuam. Mes gjërave që u betuam ishte që të dëgjojmë, të respektojmë kur dëshirojmë dhe kur urrejmë, kur është rëndë e kur është lehtë dhe mos të ngriheni kundër prijësve, në përjashtim nëse bëjnë kufër të qartë, të cilin mund ta përdorni si argument para Allahut xh.sh."

-Pejgamberi a.s. thotë: *"Dëgjimi dhe bindja ndaj udhëheqësit janë obligim për çdo musliman; qoftë sipas dëshirës së tij ose jo, pos nëse urdhërohet për keq; nëse urdhëron për të keq, nuk dëgjohet dhe as nuk i bindet".*

-Transmeton Abdullah b. Umeri r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë: *"Muslimani obligohet të jetë i dëgjueshëm dhe të nënshtrohet në çdo gjë, pa marrë parasysh e do ose urren, por me kusht që të mos jetë mëkat. Nëse urdhërohet për mëkat, nuk ka nënshtrim dhe dëgjueshmëri"* (Buhariu nr. 7144; Muslimi nr. 1839; Ebu Davudi nr. 2626).

Pejgamberi a.s. ndaloi rebelimin ndaj Kryetarit, përpos nëse tek ai vërehet mosbesimi i hapur, për të cilën keni argument tek Allahu" (Fet`hul Bari i Buhariut vëll. XIII f.204 dhe Muslimi vëll.III f.470).

-Nga Ebu Hurejre transmetohet se Pejgamberi a.s. ka thënë: *"Kush nuk i bindet udhëheqësit e ndahet nga kolektivi dhe vdes, vdekja e tij është vdekje injorance".* Pra, për udhëheqësin që kanë zgjedhur njerëzit e një vendi, e dikush ndahet nga shumica e besimtarëve, vdes sikur ai që vdes në mosbesim ose ata që kanë vdekur në kohën para Islamit. (Muslimi)

Nga Rafiu transmetohet se ka thënë Pejgamberi a.s.: *"Respektoje çdo kryetar, falu pas çdo imami dhe mos i shaj shokët e mi."*

*"Kush urren diçka prej emirit (kryetarit), le të bëjë sabër. Se, kush del nga sulltani një pëllëmbë, vdes si injorant – xhahil" (mutefekun alejhi – Buhariu, Muslimi 3/1477 nr. 1849).*

*"Kush del nga xhemati sa një pëllëmbë, vetëm se e ka zgjidhur lidhjen e Islamit nga qafa e vet" (Sahih li gajrihi; Ahmedi në musned 5/180, Hakimi në mustedrek 4/117, Ebu Davudi 4/241 nr. 4758, ibn ebi Asim në Sunne 3/433-434, dhe 502 nr.892,1053-1054, telhisul habir 4/41).*

Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë: *"3 personave Allahu xh.sh. nuk do t`u flet në ditën e Gjykimit, nuk do t`i shikojë, nuk do t`i pastrojë dhe ata do të kenë dënim të dhembshëm:...ai që tregon lojalitet ndaj udhëheqësit ashtu që nëse i jep, i qëndron besnik, e nëse ai nuk i jep, nuk i përmbush obligimet ndaj kryetarit"* (Ahmedi, vëll. 2, f. 480, Ebu Davudi vëll.3, f.749 dhe Tuhfetul Ahfedhij vëll. 5, f.218).

Cili krim është më i madh se sa ti besatohesh një njeriu e pastaj të heqësh dorë nga respekti ndaj tij e ta shkelësh besën pasi ia ke zgjatur dorën e ta luftosh me shpatë? Thotë Pejgamberi a.s.: *"Kush e ngre shpatën kundër nesh, ai nuk është prej nesh"* (Sahih, Buhariu 13/24, nr.7070, Muslimi 1/98 nr.100, Tirmidhiu nr.1459). (Marrë nga libri *Mëkatet e mëdha, imam Dhehebiu*, fq. 160-161)

-Në sahihun e Muslimit transmetohet nga Ibn Umeri r.a. se ka thënë: E kam dëgjuar Muhamedin a.s. duke thënë: *"Kush heq dorë nga dëgjueshmëria, në Ditën e Kiametit*

*do ta takojë Allahun i paarsyeshëm dhe pa argumente. Kush vdes pa e pranuar imamin (kryetarin), do të vdesë si injorant."*

-Në sahihun e Muslimit, Auf bin Malik r.a. transmeton se e ka dëgjuar Muhamedin a.s. duke thënë: *"Më të mirët prej udhëheqësve tuaj janë ata të cilët i doni dhe ju duan, ju luteni për ta dhe ata luten për ju,*

*ndërsa më të këqijtë janë ata udhëheqës që i urreni dhe ju urrejnë, i mallkoni dhe ju mallkojnë." I thamë: O i dërguari i Allahut, a t'i shkarkojmë prej detyre? Muhamedi a.s. ka thënë: "Jo, derisa e falin namazin. Jo, derisa e falin namazin."*

**DISA THËNIE NGA GJENERATA E ARTË NË LIDHJE ME RESPEKTIN NDAJ KRYETARIT**

Aliu r.a. thotë: "Njerëzit patjetër të posedojnë udhëheqës dhe qeverisje, qoftë e mirë ose e keqe".

Aisha r.a.h. u pendua pse doli në luftë kundër kryetarit, edhe pse kërkonte të vërtetën.

Hasan Basriu lidhur me sundimtarët thekson: "5 janë obligimet të cilat nga ne i kanë marrë sundimtarët: namazi i xhumasë, namazi me xhematë, namazi i bajramit, kufijtë dhe të aplikohet dënimi i caktuar. S`ka besim pa ta, madje edhe nëse bëjnë padrejtësi dhe tirani. Për Allahun, Allahu përmes tyre sjell më shumë të mira seç është e keqja që bën ai. Refuzimi i dëgjueshmërisë është mosbesim".

Po ashtu nga Hasan Basriu transmetohet se kur kishte dëgjuar një njeri i cili shante Jusuf el Haxhaxhin i tha: "Allahu të mëshiroftë, mos thuaj kështu, sepse unë kam frikë se sikur të shkatërrohej Haxhaxhi, do t`ju sundojnë majmunët dhe derrat".

Musa ibn Xhafer thotë: "Mos rrezikoni veten duke mos iu nënshtruar udhëheqësit tuaj. Nëse janë të drejtë, lutuni që të vazhdojnë, nëse janë të këqinj, lutuni që të përmirësohen. Të mirat tuaja varen nga të mirat e udhëheqësit. Udhëheqësi i drejtë është si prindi i mëshirshëm dhe dëshironi për të atë që dëshironi për vete dhe urreni për të atë që urreni për vete".

Imam Sadiku r.a. thotë: "Ai që beson Allahun dhe ditën e Gjykimit, mos ulet në ato vende ku shahet kryetari (prijësi) dhe ku fyhen besimtarët" (Biharul Envar, vëll.74; kreu 14; nr.48).

# Unioni i Studentëve të FSHI me kryesi të re

Në amfiteatrin e Fakultetit të Shkencave Islame (FSHI) më 19 maj 2010 u mbajt mbledhja e radhës e Unionit të Studentëve. Kryetar i studentëve me shumicë votash u zgjodh Mumin Sulejmani nga Shkupi, ndërsa sekretar Fejzulla Sadiku nga Tetova. Në votim morën pjesë studentët e rregullt dhe me korrespodencë. Drejtuesit e rinj zëvendësojnë Mixhit Osmanin (kryetar) dhe Semi Ajetin (sekretar), puna e të cilëve u vlerësua si mjaft e suksesshme.

Fillimisht tubimin e hapi dekani i Fakultetit, Mr. Fahrudin Ebibi, me disa këshilla tepër të dobishme për një organizim të tillë, duke potencuar se marrja në supe e ndonjë posti përmban shumë përgjegjësi. Gjithashtu, theksoi se udhëheqjen e këtij unioni studentor duhet besuar personave të cilët në jetën studentore janë të dalluar si nga aspekti arsimor, moral, ashtu edhe nga pikëvështrimi i aftësisë për të udhëhequr këtë post dhe për të mbrojtur denjësisht interesat e të gjithë studentëve.

Pastaj fjalën e mori kryetari i sapozgjedhur, Mumin Sulejmani, i cili pos tjerash tha: "Më ra përgjegjësia që të jem kryetar i Unionit të Studentëve, që është privilegj për mua, mirëpo, mbi të gjitha, ky post për mua është përgjegjësi dhe amanet. Allahu xh.sh. thotë: '*Allahu ju urdhëron që t'u jepni amanetin të zotëve të tyre dhe kur të gjykoni, ju urdhëron të gjykoni me të drejtë mes njerëzve. Sa e mirë është kjo që ju këshillon. Allahu dëgjon dhe sheh si veproni.*' Kryesinë e mëparshme e falënderojmë për mundin dhe kontributin që ka dhënë në këtë fushë për të mirën e studentëve të këtij fakulteti, ndërkaq neve, kryesinë e re, e pret një përgjegjësi e madhe pune dhe angazhimi."



# Jeta bashkëshortore e mbron dinjitetin e femrës

**"Ditën e martesës o të çilet o të mbyllet dera" - thotë një fjalë e urtë. Kjo do të thotë se martesa është një çështje tepër serioze, së cilës për të qenë e lumtur dhe e suksesshme duhet t'i paraprijë parapërgatitja serioze, pjekuria fizike e mendore, pjekuria e ndjenjave ose pjekuria e emocioneve**

NGA SHABAN AZIRI



Faktet dhe studimet në fushën e moralit kanë provuar se martesa është një institucion themelor me karakter fetar e social. Ajo është një detyrë që duhet të plotësohet si të gjitha detyrat tjera të Fesë islame. Martesa ka rëndësi të madhe shoqërore, sepse krijon përgjithësisht marrëdhënie afërsie e bashkëpunimi jo vetëm ndërmjet personave që martohen, por edhe ndërmjet anëtarëve të fiseve dhe të miqve të tyre.

Martesa do të thotë lidhje e bashkim ndërmjet dy njerëzish nën hijen e një jete të përbashkët, ku do të sundojë dashuria dhe miqësia e pastër. Ajo nënkupton integrim për bashkëshortët dhe zhdukje të ndjenjës së boshllëkut që ekziston njëlloj si te burri, ashtu edhe te gruaja. Ajo është një lloj miqësie, dashurie dhe afiniteti, saqë është e vështirë të dallohen anët e saj materiale nga ato shpirtërore e morale; ajo është një nga format e integrimit e të bashkëpunimit, që i plotëson

të gjitha nevojat shpirtërore e trupore.

Feja islame rreptësisht e ndalon prostitucionin, jetën imorale dhe lidhjet intime jashtëmartesore. Mirëpo, nga ana tjetër, zgjidhjen e problemit të jetës seksuale të njeriut e ka gjetur në institucionin islam "martesë". Domethënë, vetëm në mënyrë ligjore, përmes jetës bashkëshortore, muslimani dhe muslimanja, i riu dhe e reja, mund ta rregullojnë jetën e tyre. Pa martesë të rregullt, askush nuk guxon të ketë marrëdhënie intime. Prandaj, ishte në interes të individit dhe të shoqërisë që marrëdhëniet seksuale të sanksionohen dhe të rregullohen, por jo edhe të dënohen dhe të injorohen.

### MBROJTJA E LLOJIT NJERËZOR

Pra, Islami e favorizon martesën dhe e përkrah, kurse fuqishëm e dekurajon beqarinë, madje qoftë edhe për arsye asketike. Muslimani dhe muslimania, i riu dhe e reja, porositen që të themelojnë familje bashkëshortore. Kjo është praktikë e përbashkët e njerëzve të zakonshëm, e udhëheqësve shpirtërorë, e madje edhe e pejgamberëve. Vetëm me anë të martesës njerëzit mund të ruhen nga seksualiteti i paligjshëm, shfrenimi, mund të mbrohet morali, nderi dhe dinjiteti i femrës.

Nëse ky qëndrim si pjesë përbërëse e natyrës së njeriut është i kahershëm, atëherë shtrohet pyetja: Çka është kjo që po ndodh sot me njerëzimin? Përse njerëzimi lejoi që të përhapet amoraliteti? Përse i la hapësirë shfrenimit epshor? Përse lejoi që të përbuzet institucioni i familjes dhe i martesës? Feja islame, meqë dinjitetin e gruas e ngriti në shkallën më të lartë, ia siguroi të drejtat, atëherë përse duam ta kthejmë femrën prapë në kohën paraislame, përse ajo pranon të jetë e poshtëruar, përse pranon që të tregtohet me nderin dhe të jetojë nga feminiteti i saj...?

Feja islame e kultivon dhe e mbron institucionin e martesës. Krejt çka prej nesh kërkon, është që të mos i kalojmë kufijtë, që kënaqësitë tona të jenë të pastra, kurse kur është fjala për gjininë femërore, atyre t'u afrohemi si burra të ndershëm e jo si njerëz të pamoralshëm. Për këtë shkak, Islami urdhëron për bashkësi bashkëshortore e cila femrave dhe meshkujve iu ofron mundësi që nevojat e tyre natyrore t'i kënaqin në të gjitha aspektet e jetës, gjë e cila atyre u ofron lumturi dhe kënaqësi, por edhe përgjegjësi. Marrëdhëniet intime përmes bashkësisë bashkëshortore janë e vetmja formë e cila siguron mekanizëm kontrollues për pasionet seksuale. Ai është, gjithashtu, një lloj ventili sigurimi për edukimin seksual. Vetëm nëpërmjet martesës sendërtohet drejtpeshimi në marrëdhëniet ndërnjerëzore. Kur'ani madhështor martesën e quan **"HISN"** - kështjellë mbrojtjeje kundër jetës amorale dhe thotë:

*"... Pra, martohuni me ato (robëresha) e me lejen e zotërve të tyre dhe jepnu kurorën në mënyrë të drejtë, (zgjidhni) të ndershme e jo prostituta të hapta ose të fshehta..."* (En-Nisaë: 25).

Në versetin e pestë të kaptinës El Maide njeriut i jepen këto udhëzime:

*"... Për ta (u janë lejuar) gratë e ndershme besimtare, dhe (gra) të ndershme nga ata të cilëve u është dhënë libri para jush, kur atyre u jepni pjesën e caktuar të kurorës, por duke pasur për qëllim martesën, e jo imoralitetin dhe jo si dashnore ilegale"...*

### SI DUHET KUPTUAR MARTESËN?

Nuk guxojmë të harrojmë se martesa nuk është vetëm për dobi ekonomike ose për shak të dëfrimit shpirtëror të cilin ajo me vete e sjell, por, parimisht për shkak të të kënaqurit normal dhe të arsyeshëm të nevojave seksuale, që të mbërrihet miqësi shpirtërore midis femrës dhe mashkullit, por jo si relacion i cili është i orientuar vetëm për interes. Marrëdhëniet midis burrit dhe gruas duhet të jenë marrëdhënie shpirtërore, relacion i cili krijon dashuri, dashamirësi, mëshirë, miqësi, sakrifikim dhe ndihmë reciproke. Me fjalë të tjera, vlera dhe rëndësia e martesës qëndron në këto pika:

**Në ruajtjen dhe vazhdimësinë e gjinisë njerëzore**; Allahu Mëshirëmadh thotë:

*"Allahu krijoi për ju bashkëshorte nga vetë lloji juaj, e prej bashkëshorteve tuaja - fëmijë e nipa..."* (En-Nahël: 72);

**Në ruajtjen e shoqërisë nga amoraliteti**; I dërguari i Zotit, Muhamedi alejhiselam, thotë: *"O djalë i ri, ata ndër ju që mund të mbajnë bashkëshorte, duhet të martohen, sepse martesa ua ruan shikimet nga e keqja dhe u largon nga amoraliteti"* (Muslimi).

**Në ndihmën e bashkëshortëve, përgjegjësinë familjare dhe formimin e saj;**

**Në shpëtimin e shoqërisë nga sëmundjet ngjitëse dhe perversitetet e ndryshme;**

**Në qetësimin shpirtëror të të dyja palëve**. Allahu Fuqiplotë thotë:

*"Dhe, nga faktet e Tij është që për të mirën tuaj Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën, ashtu që të gjeni prehje tek ato, dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë"* (Er- Rum: 21).

**Në ruajtjen e familjes, edukimin dhe mirëmbajtjen e fëmijëve.**

Falë martesës, fëmijët mburren me atë se u takojnë prindërve të caktuar, sepse vetëm në familje ndiejnë përkatësinë e tyre, respektin njerëzor dhe harmoninë shpirtërore.

Kur'ani Madhështor kur i përshkruan marrëdhëniet midis burrit dhe gruas, ato i përshkruan si relacion afërsie midis "trupit dhe petkut" dhe thotë:

*"Ato janë prehje për ju dhe ju jeni prehje për ato"* (El Bekare: 187).

Këto fjalë kur'anore nënvizojnë afërsinë dhe barazinë e dy gjinive të kundërta. Sikurse petku që e mbron njeriun nga të ftohtit, nxehtësia dhe të dëmtuarit, gjithashtu edhe jeta bashkëshortore e mbron njeriun nga rreziqet dhe ia lehtëson vështirësitë dhe telashet e jetës. Jeta bashkëshortore, gjithashtu, e mbron dinjitetin e femrës prej

shikimeve lakmuese, pastaj, martesa është virtyt i mashkullit dhe mbrojtje për femrën.

Petku është diçka që e mbulon trupin dhe e mbron. Ashtu edhe bashkëshortët janë mbrojtës dhe mbikëqyrës të njëri-tjetrit. Sjellja e këtillë e ruan moralin. Pa moral, njeriu u nënshtrohet rreziqeve dhe sensualiteteve të paligjshme - prostitucionit.

Në thelb, martesa mund të përkufizohet si bashkësi e dy gjinive të kundërta, e pranuar fetarisht, ligjërisht dhe publikisht. Në martesë synohet jo vetëm krijimi i familjes dhe lumturia bashkëshortore, por edhe marrja përsipër e përgjegjësisë për përkujdesjet, mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve.

Në fund të fundit, martesa është një truall për një jetë me gëzime, harmoni dhe lumturi për burrin, gruan dhe fëmijët, pra plotësisht janë në rrugë të drejtë ata të cilët e synojnë dhe e preferojnë martesën. Shumë pak dinë për këtë kënaqësi dhe lumturi ata të cilët mendojnë vetëm për bukurinë trupore të femrës dhe vetëm për kënaqjen e pasionit seksual.

Duhet të na dhimbsen ata të cilët femrën e shohin vetëm për gjah, mbi të cilën e ushtrojnë fortësinë dhe dinakërinë e tyre. Të tillëve vetëm kjo u pëlqen! Ata nuk parandjejnë se prej nderimit, besnikërisë, pastërtisë dhe sinqeritetit midis mashkullit dhe femrës lind shoqëria dhe miqësia interne, përmes së cilës kënaqin edhe trupin edhe shpirtin dhe tregojnë ndjenja të larta dhe konstante, e jo vetëm në atë moment gjumëndjellës nga akti seksual.

“Ditën e martesës o të çilet o të mbyllet dera” - thotë një fjalë e urtë. Kjo do të thotë se martesa është një çështje tepër serioze, së cilës për të qenë e lumtur dhe e suksesshme, duhet t’i paraprijë parapërgatitja serioze për të, pjekuria fizike e mendore, pjekuria e ndjenjave ose pjekuria e emocioneve.

Që martesa të jetë e lumtur dhe e qëndrueshme, nga të rinjtë kërkohet që para se të vendosin për t’u futur në martesë, të jenë të vendosur për të ruajtur bashkëshortësinë, pavarësisht se gjatë jetës mund t’u dalin edhe pengesa ose kërkesa të cilat mund të përpiqen për t’i shmangur nga ky parim. Kjo kërkon që të rinjtë të edukohen me këtë parim sa më herët, gjë që lidhet edhe me edukimin e frenuesve të brendshëm psikikë e sidomos të ndjenjave të tilla të larta si besnikëria, ndershmëria, humanizmi, sinqeriteti, respekti, durimi etj. Vetëm me këso veti të larta morale, jeta bashkëshortore mund të funksionojë si duhet dhe të jetë e lumtur. Është lehtë të krijosh martesë të lumtur, por akoma më vështirë është ta mbash atë të lumtur.



# Koncepti i Kur’anit për da’ven gjatë periudhës parakur’anore (2)



**“ O populli im, a është më i çmuar te ju farefisi im se Allahu, që e keni hedhur Atë pas shpine? Nuk ka dyshim, Zoti i di të gjitha ato që veproni. O populli im, veproni sa të mundeni; edhe unë do të veproj; e më vonë do të kuptoni se kush do ta pësojë atë dënimin që do ta poshtërojë dhe kush është ai rrenacak. Pritni, se edhe unë bashkë me ju jam duke pritur.” Hud: 92-93**

**SKENDER BUZAKU**

Për këtë periudhë në shqyrtim do të marrim Nuhin a.s. dhe Shuajbin a.s.

Për çështjen e da’vetit këta pejgamberë për bazë kishin sjelljen e mirë. Kjo ishte metoda dhe virtyti i tyre kur ka qenë në pyetje shqetësimi, ofendimi dhe sulmi personal. Ndërkaq, kur ato kalonin në vetë fenë, ata dinin ta ndërronin metodën.

### DA’VEJA E NUHIT A.S. DHE REFUZIMI I POPULLIT TË TIJ

*a) Da’veja e Nuhit a.s.*

Allahu xh.sh. i përcjell Muhamedit a.s. sesi Nuhi a.s. i ka folur popullit të vet:

*“… Unë ju tërheq vërejtjen haptazi. Që të mos adhuroni tjetërkë pos Allahut, sepse unë kam frikë për dënimin tuaj në ditën e pikëllueshme.”*[1]

Për ajetin në fjalë, tek Ibn Kethiri kemi këtë koment: Allahu i Madhërishëm lajmëron për Nuhin a.s., të cilin Ai ua ka dërguar banorëve të tokës, që kanë qenë idhujtarë. Kështu që ai haptazi tërheq vërejtjen për dënimin e Allahut, nëse populli i tij, pos Allahut, adhuron diç tjetër dhe nëse ngulmojnë në mosbesimin e tyre.[2]

*b) Dyshimi i popullit të tij*

Në ajetin në vijim të sures Hud shohim dyshimet e popullit të Nuhit a.s. ndaj tij, akuzat që iu bënë këtij Pejgamberi dhe mirësjelljen e Nuhit a.s. ndaj tyre.

Andaj, në Kur’anin Fisnik thuhet:

*“… Ne nuk të shohim ndryshe vetëm si njeri, sikurse edhe ne,...”*[3]

Kështu që, nga ky ajet kuptojmë dhe shohim dyshimin e shprehur të popullit të Nuhit a.s. ndaj tij.

Po ashtu, në Kur’anin famëlartë thuhet:

*“…ne nuk shohim se ju keni ndonjë vlerë mbi ne…”*[4]

Për këtë ajet, komenti i Ibn Abbasit është: Paria e popullit të Nuhit a.s. atij i thanë: Ti je krijesë njerëzore, ndërkaq, shohim se ty të besojnë ata që janë të dobët në mesin tone; qartë shihet se ata e kanë të menduarit e dobët, kështu që thuhet: se të kuptuarit e dobët i tyre është shkas për të të pasuar ty. Gjithashtu, i kanë thënë: Nuk je më i mirë prej nesh, meqë ha dhe pi ashtu si hamë dhe pimë edhe ne. [5]

Andaj, fjala është se ata jo vetëm që dyshojnë, por edhe polemizojnë, megjithatë Nuhi a.s. vazhdon me mirësjellje, është i vendosur, i durueshëm dhe i palodhshëm.

Kështu që, dyshimin e shprehin dhe thonë se Nuhi a.s. nuk ka ndonjë vlerë mbi ta. Ata da’vetin e Pejgamberit e konsideronin bezdisje dhe mendonin se po të ishte i drejtë da’veti i tij, edhe ata do ta kishin njohur atë. Populli i tij të mirën e matte me pasuri, mençurinë me pozitë dhe shkollimin me pushtet. Kështu, pra, sipas kriterit të tyre pasaniku është më i mirë; ai me pozitë është më i mençur; e ai që ka pushtet, është më i arsimuar.[6]

Prandaj, nga kjo që u tha, shihet se ky popull ishte i dhënë pas pasurisë, pozitës dhe pushtetit, nga njëra anë, e nga ana tjetër, ishte mendjemadh, kokëfortë dhe arrogant. Kështu që, të gjitha këto vese i vinin në veprim vetëm e vetëm për mos ta pranuar pejgamberllukun e Nuhit a.s. dhe da’vetin e tij. Megjithatë, Pejgamberi i Allahut vazhdon me mirësjellje ndaj tyre.

*Akuzat e popullit të tij*

Prandaj, kur populli i Nuhit a.s. mbaroi me dyshimet e tij, ai vazhdoi me akuza ndaj pejgamberit në fjalë.

Këtë çështje Kur’ani na e prezanton, ku thuhet:

*“…ne nuk po shohim se të pasoi kush, përveç atyre që janë më të poshtrit dhe më mendjelehtit nga mesi ynë…”*[7]

Ajetin në fjalë Ibën Kethiri e komentoi: Të pasojnë ata që i takojnë shtresës së ulët, siç janë tregtarët e ngjashëm, e nuk të pasojnë të shquarit dhe të respektuarit tanë. Pastaj, ata që të



pasojnë atë e bëjnë fare pa logjikuar; respektivisht, të pasojnë vetëm e vetëm pse i ke thirrur.[8]

Nehasi thotë:"'Më të poshtrit' janë të varfrit, të cilët nuk kanë mendim të vet e që janë me profesione të thjeshta"[9]

Pra, ata i radhisin akuzat dhe vazhdojnë me to.

Këtë na e parashtron Kur'ani, ku thuhet:

*"… pa menduar!..."*[10]

Për mendimin e populli të Nuhit a.s. ata që e ndoqën Pejgamberin e Allahut, nuk kanë qenë të mençur dhe e ndoqën pa menduar dhe pa shikuar veten, meqë menjëherë i janë përgjigjur da'vetit të tij.[11]

Në vazhdim, në fjalët e Allahut thuhet:

*" …përkundrazi, ne ju konsiderojmë gënjeshtarë! "*[12]

Mirëpo, përkundër dyshimeve, akuzave, ironisë, urrejtjes, përndjekjeve e sjelljeve mendjemëdha, Nuhi a.s. është i durueshëm, tolerant dhe i bindur në të vërtetën me të cilën është dërguar nga ana e Allahut xh.sh. Momenti tjetër i rëndësishëm është se Pejgamberi në fjalë nuk poshtëron, nuk përgjigjet në të njëjtën masë e nivel të nënçmimit dhe të përgjigjeve të popullit të tij. Andaj, e gjithë kjo sjellje e mirë e Pejgamberit të Allahut ka të bëjë me atë se dyshimet dhe akuzat e popullit të tij lidheshin për shqetësimin personal të tij.[13]

*c) Nuhi a.s. përgjigjet*

Përgjigjen e Nuhit a.s. Kur'ani Fisnik e paraqet:

*" O populli im, më thuani nëse unë jam mbështetur në argument të qartë nga Zoti im dhe Ai më dha mëshirë nga ana e Tij, e juve u janë fshehur ato ( argumente, ngase jeni dhënë pas kësaj jete ), mos do t'ju detyrojmë për to (pranimin e tyre ), kur ju jeni urrejtës të tyre! O populli im, unë për këtë nuk kërkoj prej jush ndonjë pasuri; shpërblimi im është vetëm tek Allahu. Dhe, unë kurrsesi nuk i largoj ata që besuan; ata janë afër Zotit të tyre; por, unë ju shoh si popull që nuk dini e nuk kuptoni. O populli im, a nuk po mendoni se nëse unë i përzë ata, kush do të mund të më mbrojë mua nga Allahu ( nga dënimi i Tij)? Unë nuk ju them juve se tek unë janë depotë e Allahut, as nuk ju them se unë di të fshehtën, as nuk ju them se unë jam engjëll, as nuk u them atyre që sytë tuaj i nënçmojnë se Allahu nuk u dhuroi atyre të mira. Allahu e di më së miri se çka ka në shpirtrat e tyre; pse atëherë unë konsiderohem zullumqar?"*[14]

**2. DA'VEJA E SHUAJBIT A.S. DHE REFUZIMI I POPULLIT TË TIJ**

*a)Peshoni drejt*

Edhe te Shuajbi a.s. gjatë procesit të da'vetit shohim mirësjelljen, nga njëra anë, dhe ironinë, arrogancën e mendjemadhësinë e popullit të tij, nga ana tjetër.

Meqë Shuajbi a.s. kishte ardhur në përfundim për llojin e gabimit të popullit të tij, e ai gabim ishte matja e padrejtë dhe vjedhja në kandar, nuk i kishte mbetur gjë, vetëmse të përdorte mirësjelljen për të ndaluar këtë gabim. Për këtë çështje, Allahu xh.sh. thotë se Shuajbi popullit të vet i ka folur kështu:

*" Edhe Medjenit ( i dërguam ) vëllain e tyre, Shuajbin, i cili u tha: O populli im, adhurojeni Allahun; ju nuk keni Zot tjetër, pos Tij; mos matni, as mos peshoni mangut; unë po shoh se jeni në gjendje të mirë jetësore; pra, unë po frikësohem për ju nga dënimi që do t'ju përfshijë një ditë! O populli im, veproni drejt gjatë matjes dhe peshimit, e mos dëmtoni njerëzit me asgjë dhe mos*

*shkaktoni rrëmujë në tokë! Atë pjesë që ju lejoi Allahu është shumë më e mirë për ju, nëse jeni besimtarë; e unë nuk jam roja juaj."* [15]

Në kuadër të ajeteve të sipërshënuara, Kurtubiu thotë: "Ata, përveç asaj që kanë qenë mosbesimtarë, kanë qenë edhe mashtrues dhe koprracë.Kur u vinte shitësi me ushqim për të blerë, ata merrnin më shumë se sa ka treguar kandari dhe për imtësira shtyheshin, ndërsa kur u vinte ndonjë blerës, i matnin më pak dhe ishin koprracë ndaj tij." [16]

Ndërkaq, komenti i Ibn Kethirit është: Allahu ua kishte dërguar Shuajbin a.s. në mesin e tyre, i cili ishte me prejardhje fisnike, për t'i urdhëruar që ta adhurojnë Allahun, të Vetmin, i Cili nuk ka shok dhe t'ua ndalë mashtrimin gjatë peshimit, meqë populli i tij kishte jetë të mirë, e unë vërtet frikësohem të mos mbeteni pa këtë begati duke i shkelur ndalesat e Allahut…" [17]

*b) Arroganca e popullit të tij*

Përkundër mirësjelljes dhe urtësisë së Pejgamberit të Allahut gjatë da'vetit, ky popull përgjigjen ndaj Shuajbit a.s. e ka ironike dhe arrogante. Të shohim si na e parashtron Kur'ani Qerim përgjigjen e tyre, ku thuhet:

*" Ata thanë: O Shuajb, a namazi yt po të thotë të na urdhërosh që ta braktisim atë që e adhuruan prindërit tanë, ose (po të urdhëron ) për të punuar në pasurinë tonë ashtu si të duam? Vërtet, ti qenke i butë e i mençur. ( Kjo ishte tallje e tyre )."* [18]

Përkundër përqeshjes dhe nënçmimit të popullit të tij, Shuajbi a.s. shprehet me mirësjellje, siç i ka hije një daiu, i cili ka siguri në thirrjen që bën. Për të nuk çojnë peshë përqeshjet e tyre, i vetëdijshëm për lëshimet dhe paditurinë e tyre. Po ashtu është i sigurt në atë se i është dhënë dituria që nuk u është dhënë atyre.

Ja, fjala e Kur'anit për atë që Shuajbi a.s. i tha populli të tij:

*" O populli im, më thuani, pra, nëse unë kam argument të sigurt nga Zoti im dhe nga ana e Tij, Ai më furnizoi mua me të mira ( si mund të mos ju udhëzoj në rrugë të drejtë ?). Unë nuk dua t'ju kundërshtoj (duke punuar ) për atë nga e cila po ju ndaloj; unë nuk dua tjetër, vetëm të përmirësoj aq sa mundem; por, këtë mund ta arrij vetëm me ndihmën e Allahut, vetëm Atij iu kam mbështetur dhe vetëm tek Ai jam drejtuar! O populli im, kundërshtimi ndaj meje të mos u shpie ( në mosbesim ), që t'ju gjejë ajo që e gjeti popullin e Nuhit, popullin e Hudit ose popullin e Salihut. E populli i Lutit nuk është larg jush. Kërkoni falje Zotit tuaj dhe sinqerisht pendohuni ndaj Tij. Vërtet, Zoti im është mëshirues, shumë i dashur."* [19]

Tek Ibn Kethiri qëndron ky koment: Shuajbi a.s. atyre u thotë: Plotësisht më është e qartë dhe kam argumente për atë që ju bëj thirrje. Disa kanë komentuar se për qëllim kam pasur pejgamberllëkun, e komenti i disa të tjerëve është se për qëllim kam pasur furnizimin hallall. Gjithashtu, Shuajbi a.s. u ka thënë: Nuk u ndaloj për diçka, e pastaj vetë ta bëj fshehurazi. Le të mos u provokojë armiqësia ndaj meje e të vazhdoni në mosbesim (kufër ), e të dënoheni ashtu siç u dënuan populli i Nuhit, i Hudit, i Salihut dhe i Lutit.[20]

*c) Kërcënimi i popullit të tij*

Megjithatë, edhe pse Shuajbi a.s. vazhdon me mirësjellje, butësi e urtësi në da'vet, respektivisht ai nuk i revanshohet ironisë dhe arrogancës së tyre, ata kësaj radhe përpos ironisë dhe arrogancës i përgjigjen me kërcënime.

Ja fjalët e Allahut xh.sh. lidhur me rastin:

*" Ata thanë: O Shuajb, ne nuk po e kuptojmë shumicën nga ajo që thua dhe ne të konsiderojmë ty të dobët në mesin tonë, dhe sikur të mos ishte ai grupi yt, ne do të gurëzonim ty, ngase ti nuk je i çmuar ndër ne."* [21]

Ebu Refki thotë: E konsiderojnë një dhe të poshtëruar, meqë fisi i tij nuk e ka pranuar fenë e tij, respektivisht, po të mos ishte fisi dhe autoriteti i tij, do ta gurëzonin.[22]

*d) Kërcënimi i Shuajbit a.s. me llogarinë përfundimtare*

Kur përgjigjet e popullit të tij ndryshuan nga ofendimet personale dhe morën karakter të ofendimit të fesë drejtëpërdrejt, por jo vetëm kaq, por ofenduan edhe Zotin, me atë rast edhe mirësjellja e Pejgamberit ndryshoi, kështu që i kundërshtoi dhe kërcënoi me llogarinë përfundimtare.[23]

Kur'ani na e prezanton atë që Shuajbi a.s. i tha popullit të tij:

*" O populli im, a është më i çmuar te ju farefisi im se Allahu, që e keni hedhur Atë pas shpine? Nuk ka dyshim, Zoti i di të gjitha ato që vepron. O populli im, veproni sa të mundeni; edhe unë do të veproj; e më vonë do të kuptoni se kush do ta pësojë atë dënimin që do ta poshtërojë dhe kush është ai rrenacak. Pritni, se edhe unë bashkë me ju jam duke pritur."* [2] / vazhdon /

[1]) Hud, 25-26.
[2]) Tefsir Ibn Kesir, skraćena verzija, Sarajevo, 200/ 1420, fq.,618-619.
[3]) Hud, 27.
[4]) Hud, 27.
[5]) Ibn A'bas, TEFSIR, Sarajevo, 2007/1428, fq., 3, fq. 22.
[6]) Edh- Dhilal, 4/1872; sipas: Abdul-Hamid el- Bilali, Metodat e da'vetit, Shkup, 2003, fq. 121.
[7]) Hud,27.
[8]) TEFSIR Ibn-Kesir, skraćena verzija, Sarajevo, 2000/1420, fq., 619.
[9]) Tefsirul- Kurtubi, 5/3251; sipas: Abdul- Hamid el- Bilali, Metodat e da'vetit, Shkup, 2003, fq. 122,
[10]) Hud, 27.
[11]) Tefsiri i Ibn Kethirit, 2/442; sipas: Abdul- Hamid el-Bilal, Metodat e da'vetit, Shkup, 2003,fq. 122,
[12]) Hud, 27.
[13]) Edh-Dhilal,4/1873; sipas: Abdul-Hamid el- Bilali Metodat e da'vetit, Shkup, 2003, fq. 123,
[14]) Hud, 28-31.
[15]) Hud, 84-86,
[16]) Tefsirul-Kurtubi,5/3313; sipas: Abdul-Hamid el-Bilali, Metodat e da'vetit, Shkup, 2003, fq.124,
[17]) Tefsiri i Ibn Kethirit, kandil ndriçues, në versionin e shkurtuar, Zürich, 2009,IV, fq. 166-167.
[18]) Hud, 87,
[19]) Hud, 88-90.
[20]) Tefsiri i Ibn Kethirit, kandil ndriçues, në versionin e shkurtuar, Zürich, IV, fq.170-171.
[21]) Hud, 91.
[22]) Edh-Dhilal, 4/1922; sipas: Abdul-Hamid el-Bilali, Metodat e da'vetit, Shkup, 2003, fq. 126.
[23]) Po aty, fq.126.
[24]) Hud, 92-93.

# Disa dallime ndërmjet Biblës dhe Kur'anit

**"Ai ta zbriti ty (Muhamed) librin me argument, që është vër¬tetues i librave të më-parshëm. Ai e zbriti më parë Tevratin dhe Inx-hilin". (Kur'an: Ali Imran, 3)**

**SENAD MAKU - ULQIN**



Librat e shenjtë të Hebraizmit janë përmbledhur bashkë me librat e shenjtë të Krishterimit dhe tok përbëjnë një përmbledhje të quajtur Bibël. Ky emër vjen nga greqishtja "He biblos" (apo *biblion*), që do të thotë "Libër", kurse në trajtën diminutive "ta biblia" (apo *bibla*), d.m.th. libërtha, përmbledhje librash.[1] Përbëhet nga dy pjesë kryesore: Dhiata e Vjetër dhe Dhiata e Re. Dhiata e Vjetër, libri i shenjtë i hebrenjve dhe Dhiata e Re, libri i shenjtë i të krishterëve.

Ndërsa libri i shenjtë i fundit, i zbritur prej Zotit të Madhëruar, është Kur'ani, i shpallur për tërë njerëzimin. Kur'an do të thotë "i lexueshëm", që në kuptimin etimologjik rrjedh nga fjala *Kare'e*, që domethënë *me lexue, lexim*.

Kur'an është Fjalë pa konkurrencë e Allahut xh. sh. Ai, nëpërmjet të besueshmit Xhibril i është shpallur vulës së pejgamberëve, Muhamedit (s.a.v.s.), është shkruar në Mus-hafe dhe është transmetuar në mënyrën më të besueshme (tevaturen) deri te ne; leximi i tij është ibadet, fillon me suren "El-Fatiha" dhe përfundon me suren "En-Nas".[2]

Bibla nuk është një libër, po një përmbledhje librash. Bibla – sipas versionit protestant, përmban 66 libra, kurse Bibla - sipas versionit romano-katolik, përmban 73 libra.[3]

Bibla është një përzierje e thënieve hyjnore dhe e komenteve njerëzore të atyre që erdhën më pastaj, duke falsifikuar e ndryshuar shkrimin e shenjtë dhe duke vendosur mendimet dhe fjalët e veta. (Shih p.sh., Jeremia 8:8, Luka 1:1-4, 1 Korintasve, 7:25) Origjinalet e këtyre librave, si të Dhiatës së Vjetër, ashtu dhe të Ungjijve, kanë humbur. Kur'ani nuk përmban komente dhe ndërhyrje njerëzore siç ka ndodhur me vetë Biblën, madje as fjalët e Muhamedit a.s. nuk janë pjesë të

Kur'anit dhe ato quhen Hadithe.

Në Bibël gjenden disa libra që janë shkruar shumë vjet pasi pejgamberët përkatës kishin vdekur dhe jo në gjuhën e atyre pejgamberëve, duke krijuar kështu një numër vështirësish në analizimin e tyre, duke hasur në të gabime, kontradikta, mospërputhje faktesh etj., sa kohë që i tërë Kur'ani u shkrua gjatë jetës së pejgamberit Muhamed s.a.v.s. dhe u mësua përmendsh nga qindra njerëz në gjuhën origjinale.

Të katër Ungjijtë kanonikë nuk ishin ungjijtë e vetëm. Vendimi se çfarë duhet të jetë në *Bibël* dhe çfarë jo, u mor sipas gjykimit të njerëzve. Në Islam nuk u mbajt asnjë konferencë në të cilën do të përcaktohej se cila sure duhet të jetë e cila të mos jetë në Kur'an. Në Dhiatën e Re të katër Ungjijtë japin jetën dhe misionin e Isait, Jezusit a.s., kurse Kur'ani nuk është një biografi e Muhamedit a.s., shkruar nga pasuesit e tij. Ky është një dallim shumë i madh ndërmjet Biblës dhe Kur'anit.

Po t'i analizojmë disa dallime esenciale në të dy librat, do të vërejmë ekzistencën e dallimeve themelore në besim, që i gjejmë në të dy tekstet. Këto dallime janë: Në konceptin e Zotit, Bibla Zotin e tregon si një Zot që lodhet (Ekzodi, 31:17- Zanafilla 2:2); një Zot që harron (Psalmi, 13:1- Vajtimet, 5:20); të pafuqishëm (Zanafilla, 32:28); një Zot që fle (Psalmi, 44:23- 78:65); të pamëshirshëm (Psalmi, 77:7-9); një Zot me dituri të mangët (Zanafilla, 3:8); një Zot që përshkruhet në formën e njeriut (Zanafilla, 1:26- 9:6); një Zot që ka familje (Ekzodi, 4:22- Ligji i përtërirë, 32:19- Ezekieli, 16:3-32- Hebrenjve, 5:5-Psalm,i 2:7); një Zot që ka nevojë për udhëheqjen e njeriut (Ekzodi, 12:13); padrejtësia e Zotit (Jobi, 19:6-7); një Zot që prish premtimin (Levetiku, 26:44); një Zot që pendohet për atë që bën (Zanaflilla, 6:6-7), dhe shumë "argumente" të tjera, që janë në kundërshtim me Qenien e Zotit xh.sh., kurse Kur'ani i hedh poshtë këto trillime. Shih ajetet që u kundërvihen këtyre citateve biblike: Kaf, 38, Ta-Ha 52, Haxh 74, Bekare 255, Zumer 53, Bekare 115, Shuara 11, Nahl 74, Ihlas 1-4, Maide 18, Furkan 6, En-Am 59, Junus 44, Nisa 40, Ibrahim 42, Rrum 6 e shumë ajete të tjera.

Cilësitë e Allahut xh.sh., që tregohen në Kur'anin Famëlartë, janë absolutisht të përkryera, të përhershme. Fjalët që flasin për vetitë e Allahut të Madhëruar tërësisht dallohen nga kuptimi i fjalëve që i përdorim për ndonjë veti të qenieve të gjalla. Ndërkaq, në Bibël në disa citate gjejmë të kundërtat e kësaj, ato cilësi janë mbërthyer nga teprimet, tejkalimet, përdhosja e deri te degjenerimet e asaj që është thelbi i tyre, d.m.th. fjalët i janë shmangur thelbësores dhe kuptimit të së vërtetës. Vetitë e Zotit në Bibël, në të vërtetë, janë pasqyrim i ëndjeve, cilësive dhe dëshirave të pikëpamjeve e qëndrimeve njerëzore; Zoti cilësohet për të gjitha vetitë që cilësohen dhe njerëzit. Pra, koncepti biblik i Zotit është krejt i ndryshëm nga ai i Kur'anit. E Allahu i Madhërishëm në Kur'anin Famëlartë thotë: ***"I Lartësuar është Zoti yt, Zot i fuqisë nga ajo që i përshkruajnë".*** *(Saffat, 180)*

Po ashtu, edhe në konceptimin e pejgamberëve ka



dallime. Bibla i quan profetët mëkatarë, gënjeshtarë, tradhtarë dhe u jep shumë epitete të tjera, kryerje të veprave të shëmtuara e të ndyra, etj.. Tërheq vëmendje qëndrimi i Biblës ndaj Pejgamberëve, ngase, kur flet për ta, pothuajse të gjithë Pejgamberët dalin si mëkatarët më të dalluar. I quan si gënjeshtarë, tradhtarë, të padijshëm, autorë (bërës) gabimesh e mëkatesh dhe me epitete të tjera që u mvishen Pejgamberëve. Në Bibël hasim tregime trishtuese në lidhje me Pejgamberët, sepse këta paraqiten si personazhe kryesore në kryerjen e veprave më të shëmtuara dhe të ndyra. Këto veti nuk përkojnë me njeriun e rëndomtë e jo më t'i ketë Pejgamberi, njeriu i zgjedhur nga Allahu xh.sh.

P.sh. Luti a.s. bëri zina me dy të bijat e veta (Zanafilla, 19:30-38); Haruni a.s. si njeriu që konstruktoi viçin për ta



adhuruar izraelitët (Ekzodi, 32:1-20); Sulejmani u martua me 700 gra dhe 300 konkubina e u bë idhujtar (1 Mbretërve, 11:3-7); Zoti e urdhëron profetin Osea që të martohet me prostitutë e të ketë fëmijë të kurvërisë (Osea, 1:2); Jakobin e quan si dinak dhe mjeshtër intrigash të shumta (Zanafilla, 27:16, 19-36/32:24-30); Juda bëri zina me nusen e të birit Tamarën dhe ajo mbeti shtatzënë me të e lindi dy binjakë, Faresin dhe Zaran, ku prej Faresit, e, si rezultat i kësaj zinaje, nderohen si stërgjyshërit e Jezusit-Isait a.s., Davudi a.s., Sulejmani a.s. (Zanafilla, 38:12-30, Mateu, 1:3-16) etj..

Kurse Kur'ani Pejgamberët i ngre në shkallën më të lartë dhe i bën shëmbëlltyrë për ne. Zoti xh.sh. i nderoi Pejgamberët e Tij të zgjedhur që të ishin ndërmjetësues ndërmjet Allahut xh.sh. dhe robërve të Tij. I veçoi për ta bartur amanetin e Zotit xh.sh. (amanetin e Shpalljes) për thirrje të vazhdueshme për të besuar në një Zot. Zgjodhi njerëz të pajisur me moral të lartë, njerëz fisnikë dhe që rrjedhin nga familjet me prejardhje të pastër, njerëz besnikë dhe të kujdesshëm në punën e tyre. Kur e lexojmë Kur'anin, shohim se Zoti xh.sh. i pajisi ata me disa cilësi që duhet t'i ketë Pejgamberi. Ato janë: I drejtë, I vërtetë; Besnik, I sinqertë; Transmetues i shpalljes së Zotit; I zgjuar, I mençur; I mbrojtur nga gabimet; Pa të meta fizike etj.

Domosdoshmëria që çdo Pejgamber t'i posedojë këto veçori a cilësi dalluese është çështje që përputhet me logjikën e shëndoshë, ngase nuk ka mundësi që një Pejgamber të posedojë cilësi negative, të cilat e zbehin moralin e tij si pejgamber. Morali i tyre është shumë më i lartë se i njerëzve të tjerë. Po ata, në të njëjtën kohë, nuk arrijnë gradën e hyjnisë, ngase mekanizmat kur'anorë e ndalojnë një gjë të tillë, sepse shkalla më e lartë është "robëria më e lartë" ndaj Allahut xh.sh. Përshkrimet, shpifjet e tilla ndaj Pejgamberëve jo vetëm që nuk gjenden në Kur'an, por konsiderohen mëkatarë ata që u mveshin këso epitetesh të dërguarve të Zotit xh.sh.. Po të kemi parasysh Fjalët e Allahut të Madhërishëm xh.sh., i cili në Kur'anin famëlartë thotë: ***"Pasha Allahun, patjetër do të merreni në përgjegjësi për atë që trillonit".*** *(En-Nahl, 56)* ***"Pa dyshim, ai që shpif ka dështuar keq".*** *(Ta Ha, 61)* ***"Po a nuk është Xhehenemi vend për jobesimtarët?"*** *(Ankebut, 68).*

Gjithashtu, dallime thelbësore gjejmë edhe për sa i përket besimit në jetën e tanishme dhe të përtejme, në konceptin e shpëtimit dhe drejtimit në jetë. Po ashtu, dallime kemi edhe në histori - ku Kur'ani dhe Bibla nuk përputhen: p.sh. tek Ademi dhe Hava, tek Ibrahimi a.s., Ismaili, Is'haku, Luti, Musai, Isai a.s. etj.

Duke e parë devijimin e popujve nga rruga e vërtetë dhe ndryshimin e librave të shpallur prej të Madhit Zot, Allahu xh. sh. para 14 shekujsh dërgoi Pejgamberin e Tij, të dërguarin e Tij të fundit, Muhamedin s.a.v.s., me Fjalën e Tij finale, dërguar njerëzimit. Librat e mëhershëm nuk u ruajtën ashtu siç u shpallën. Bibla e sotme është një përzierje e gjurmëve të mbetura të Fjalëve të Zotit, me fjalët e profetëve, të historianëve, të autorëve dhe të njerëzve të tjerë, kështu që as autorët e librave nuk dihen saktësisht.

Këtë e vërteton studiuesi dhe eksperti i Krishterimit të hershëm, Bart D. Ehrman[4], i cili thotë: "Skribët profesionistë janë shfaqur në Krishterim në një periudhë shumë të vonshme, aty nga shekulli i katërt. Për këtë arsye, është e natyrshme që në kopjet e hershme të jenë bërë gabime të shumta gjatë kopjimit. Mirëpo, më me rëndësi është fakti se këta skribë kanë qenë të përfshirë personalisht në debatet teologjike, që kanë marrë plot jetë njerëzish në Krishterimin e hershëm... Duke pasur parasysh polemikat, konfliktet e ndryshme, mosmarrëveshjet teologjike dhe veçanërisht debatet mbi kriptologjinë[5], skribët e krishterë u nxitën t'i ndryshonin fjalët e shkrimit të shenjtë, në mënyrë që t'i bënin ato më të dobishme për debatin. Skribët e ndryshuan tekstin në

dorëshkrimet e tyre, për t'i bërë tekstet më qartësisht "ortodokse" dhe më pak të "keqpërdorshme" nga kundërshtarët e tyre.[6] Kjo ka ndodhur saherë që skribët përgjegjës, për kopjimin e tekstit, kishin dashur të siguroheshin që teksti të thoshte pikërisht atë që ata dëshironin që të thoshte.[7]

Feja islame, Kur'ani është ai që ringjalli dhe e përtëriu fenë e të gjithë të dërguarve të tjerë. Çështje/vlera kryesore me të cilën Islami, Kur'ani ka ardhur, është sqarimi i konceptit të Zotit, që është edhe esenca e vërtetë e fesë. Koncepti i Zotit në Krishterim ka arritur deri në atë shkallë sa Zoti të krahasohet me vetitë dhe cilësitë e njeriut, duke i bërë shok Zotit, duke i bërë ortak, duke e adhuruar dikë tjetër në vend të Tij etj.

Kur'ani është një udhëzues që ndan dritën nga errësirat dhe na tregon në mënyrë perfekte se ç' mund të besohet e ç'nuk mund të besohet nga Bibla.[8]

Po ashtu nuk duhet harruar se Kur'ani flet për shumë ngjarje që përmenden edhe në Bibël. Pra, pikësëpari, ngjashmëria nuk do të thotë medoemos kopjim i një libri prej një tjetri, siç mendojnë disa - se Kur'ani na qenkësh kopje e Biblës. Allahu e bën të qartë në Kur'an se mesazhi që Ai po shpallte nëpërmjet Muhamedit a.s. nuk ishte diçka e re, veçse ishte një vazhdim i zinxhirit të mëhershëm të porosive dhënë nga Zoti, nëpërmjet Pejgamberëve.

**"Ne të frymëzuam ty me shpallje, sikurse patëm frymëzuar Nuhun dhe pejgamberët pas tij; patëm frymëzuar Ibrahimin, Ismajlin, Is'hakun, Jakubin dhe pasardhësit e tij, Isain, Ejubin, Junusin, Harunin, Sulejmanin, e Davudit i patëm dhënë Zeburin".** (Nisa, 163)

**"E, sa pejgamberë kemi dërguar te popujt e lashtë?!** (Zuhruf, 6)

**"Secili popull kishte të dërguarin e vet, e kur u vinte i dërguari i tyre, bëhej gjykimi i drejtë në mes tyre, atyre nuk u bëhet padrejtësi".** (Junus, 47)

Është e natyrshme që mesazhi i atyre Pejgamberëve ishte i njëjtë, duke qenë se ata vinin nga Zoti i njëjtë dhe tash, meqë në Bibël kanë mbetur gjurmë të mesazhit të vërtetë të përcjellë nga Pejgamberët, nuk është aspak e çuditshme nëse edhe në Kur'an gjejmë paralelizma me ngjarje të caktuara. Nëse mendojmë se Kur'ani është kopje e burimeve hebraiko-krishtere (e Biblës) vetëm sepse të dy librat flasin për disa ngjarje të njëjta, ky është një mendim shumë naiv.

Ndërsa për ndryshimin dhe falsifikimin e Biblës, Zoti u drejtohet njerëzve nëpërmjet Kur'anit famëlartë: **"Mjerë ata që me duart e tyre shkruajnë Librin, e pastaj thonë: 'Kjo është prej Allahut', që për këtë të kenë ndonjë dobi të vogël** (materiale). **Mjerë ata për çfarë kanë shkruar me duart e tyre dhe mjerë ata për çfarë kanë fituar!"** *(Bekare, 79)*

Por, njëkohësisht, meqë Kur'ani na tregon për shtrembërimin e Biblës dhe falsifikimin e saj, shtrohet pyetja a thua na tregon edhe vetë Bibla për ndryshimin e saj? Këtë më së miri na e tregojnë disa nga citatet e Biblës, si p.sh.:

a) Tek Jeremia 8:8, thuhet: *"Si mund të thoni: "Ne (Hebrenjtë) jemi të urtë dhe ligji i Zotit është me ne"? Por, ja, pena e rreme e shkruesve e ka bërë një falsitet".*

b) *"Kur Moisiu mbaroi së shkruari në një libër tërë fjalët e këtij ligji, u dha këtë urdhër Levitëve që mbanin arkën e besëlidhjes së Zotit, duke thënë: "Merreni këtë libër të ligjit dhe vendoseni në arkën e besëlidhjes së Zotit, Perëndisë suaj, me qëllim që të mbetet si një dëshmi kundër teje; sepse, unë e njoh frymën tënde rebele dhe fortësinë e qafës tënde. Ja, sot kur akoma jam i gjallë midis jush, ju u bëtë rebelë kundër Zotit; aq më tepër, do të bëheni mbas vdekjes sime!* (Ligji i Përtërirë, 31:24-27)

*Mblidhni pranë meje të gjithë pleqtë e fiseve tuaja dhe zyrtarët tuaj, me qëllim që të dëgjojnë këto fjalë dhe unë të thërras të dëshmojnë kundër tyre qiellin dhe Tokën. Sepse, unë e di që, mbas vdekjes sime, do të korruptoheni plotësisht dhe do të largoheni nga rruga që ju kam urdhëruar dhe ditët e fundit do të goditeni nga fatkeqësia, sepse keni për të bërë atë që është e keqe për sytë e Zotit, duke provokuar indinjatën e Tij me veprën e duarve tuaja".* (Ligji i Përtërirë, 31:28-29)

Nga kjo vërehet se Moisiu/Musai a.s. paralajmëroi dhe e dinte se Tevrati (pesëlibërshi i tij) do të shtrembërohej dhe do ta ndryshonin mbas vdekjes së tij, dhe ashtu ndodhi.

c) Po ta analizojmë mirë edhe Dhiatën e Re, do të vërejmë se edhe aty kemi të bëjmë jo me Fjalën e Perëndisë, po me shkrime të njerëzve të ndryshëm dhe pa inspirimin e Perëndisë, si p.sh.:

Tek Ungjilli sipas Llukës shkruan: *"Mbasi shumë vetë ndërmorën të renditin tregimin e ngjarjeve që ndodhën në mesin tonë, ashtu si na i përcollën ata që ishin bërë nga fillimi dëshmitarë okularë dhe shërbyes të fjalës, M`u duk e mirë edhe mua, pasi i hetova të gjitha gjërat me kujdes që nga fillimi, të t`i shkruaj sipas radhës, fort i nderuari Teofil, që ti të njohësh vërtetësinë e gjërave që të kanë mësuar."* (Lluka, 1:1-4).

Nga vargu i lartshënuar tregohet qartë se:

- Së pari, Ungjilli sipas Llukës ishte vetëm një ndër shumë narracionet e shkruara në dekadat e para pas Jezusit nga njerëz të ndryshëm (*Mbasi shumë vetë ndërmorën të renditin tregimin e ngjarjeve që ndodhën në mesin tonë*);
- Së dyti, ky shkrim i drejtohej Teofilit personalisht nga Lluka dhe jo njerëzimit nga Perëndia (*fort i nderuari Teofil, që ti të njohësh vërtetësinë e gjërave që të kanë mësuar*); dhe
- Së treti, më e rëndësishmja është se ky Ungjill nuk ishte shkruar nën frymëzimin e Zotit, por ishte shkruar pasi Lluka kishte konsultuar burime të ndryshme (*pasi i hetova të gjitha gjërat me kujdes që nga fillimi*); qoftë të shkruara, qoftë gojore, origjinën e të cilave as nuk e dimë e as që mund ta verifikojmë. E njëjta gjë vlen edhe për shumë nga shkrimet e tjera të Dhiatës së Re dhe të Vjetër.

d) Një rast tjetër ka të bëjë me Palin, me Letrat e tij, të cilat në fakt përbëjnë pjesën më të madhe të Dhiatës së Re, ku shihet mjaft qartë

se nuk ka kurrfarë dëshmie se ai ishte i frymëzuar nga Zoti derisa i shkruante ato letra. Në një mori rastesh ai e bën të qartë se në letra po e shprehte mendimin e tij dhe jo të Perëndisë:

*"... s'kam urdhër nga Zoti, por po jap një mendim si njeri ..."* ( 1 Korintasve, 7:25)

*"…sipas gjykimit tim…."* (1 Korintasve, 7:40)

*"…dhe mendoj se edhe unë kam Frymën e Perëndisë…."* (1 Korintasve, 7:40)

*"…Ja, unë, Pali, po ju them …"* (Letra e Palit Galatasve, 5:2)

Si shihet, tek *1 Korintasve* 7:40 vihet në dyshim edhe frymëzimi i mësimeve të Palit në tërësi. Aty tregohet se ai nuk ishte i sigurt as nëse e kishte Frymën e Perëndisë ose jo. Përse duhet të besohen për fjalë të Zotit letrat e Palit, nëse ai vetë e bën të njohur aty se pohimi që ai e kishte frymën e Zotit ishte mendim i tij personal dhe nuk ishte i konfirmuar nga Perëndia?

Duke pasur parasysh se në një artikull nuk mund të elaborohet gjithçka për sa u përket dallimeve mes dy librave - Biblës dhe Kur'anit, jam përpjekur të shtjelloj disa nga gjërat më elementare, për të dëshmuar dallimet dhe vërtetësinë e tyre në lidhje me të dy tekstet.

Dua ta përfundoj këtë artikull me Fjalët e Allahut Fuqiplotë, Që në librin e Tij të fundit, në Kur'anin famëlartë, thotë:

**"Ky Kur'an nuk është i tillë që të mund të bëhej prej dikujt tjetër, përveçse prej Allahut. Përkundrazi, ai është vërtetues i shpalljeve të mëparshme dhe shpjegues i Ligjit** (për njerëzit) **dhe, pa dyshim, është zbritur nga Zoti i botëve!"** (Junus, 37)

**"Ai ta zbriti ty** (Muhammed) **Librin, me argument që është vërtetues i librave të mëparshëm. Ai e zbriti më parë Tevratin dhe Inxhilin. Udhërrëfim për njerëz, e zbriti edhe Furkanin** (dalluesin e së vërtetës nga gënjeshtra). **S'ka dyshim se ata që mohojnë argumentet e Allahut, i pret ndëshkimi i rreptë. Allahu është ngadhënjyes, shpagimtar".** (Ali Imran, 3-4)

**Thuaj: "O ithtarët e Librit, ejani të biemi në një fjalë të përbashkët midis neve dhe juve: se do ta adhurojmë vetëm Allahun, se nuk do t'i shoqërojmë Atij asgjë** (në adhurim) **dhe se nuk do ta mbajmë për zot njëri-tjetrin, në vend të Allahut!"** (Ali Imran, 64)

**"Nuk ka detyrim në fe, rruga e drejtë është dalluar shumë qartë nga ajo e padrejta"** (Bekare, 256).

[1] *Bibla*, përktheu dhe shtjelloi Dom Simon Filipaj, Ferizaj, 1994, fq. 11; dhe Ekrem Murtezai, *"Fjalori i feve"*, fq. 62.

[2] *"Kur'ani- Përkthim dhe komentim"* nga H. Sherif Ahmeti, fq. 10.

[3] Duhet theksuar se dallimi kryesor mes Biblës katolike dhe Biblës protestante ka të bëjë me çështjen e librave që gjenden në të. Në Biblën katolike (Bibla – përktheu dhe shtjelloi Dom Simon Filipaj, Ferizaj, 1994) dhe në atë protestante (Bibla- Diodati i ri, përkthim 1991-94) dallimi qëndron në faktin se Bibla katolike ka 7 libra më tepër se Bibla protestante, kurse të dy sektet librin e tyre e quajnë të shenjtë. Atëherë, shtrohet pyetja - pse ky dallim ndërmjet biblave? Cila është, në të vërtetë, Fjalë e Perëndisë?

[4] Bart Ehrman është një studiues i njohur i Dhiatës së Re si dhe një ekspert i Krishterimit të hershëm. Masterin dhe doktoratën i ka kryer në Seminarin Teologjik të Princentonit. Aktualisht është shef i departamentit të studimeve fetare në Universitetin "Chaper Hill" të Karolinës së Veriut. (Biografi nga libri i tij: *"Të keqcitosh Jezusin...."*, në fund të librit.)

[5] Kriptologji-a: shkenca që merret me shifrimin dhe me deshifrimin e shkrimeve të fshehta. (Mikel Ndrecaj, *"Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja"*, Prishtinë, 2000, fq. 415.)

[6] Bart D. Ehrman, "Të keqcitosh Jezusin-Si dhe përse u ndryshua Bibla", fq. 10.

[7] Po aty, fq. 78. Gjatë shekujve II dhe III, po ashtu gjatë kohës së Konstantinit, Bart Ehrman tregon se "këta dy shekuj kanë qenë veçanërisht të pasur me ndryshime teologjike ndërmjet të krishterëve të hershëm. Në të vërtetë, dallimet teologjike ishin kaq shumë të shtrira, saqë grupet që e quanin veten e tyre të krishtera ndiqnin besime dhe praktika që shumë të krishterë sot do të këmbëngulnin se nuk kanë të bëjnë aspak me krishterimin". (Po aty, fq. 78) Po ashtu, Bart D. Ehrman thotë: "Ç'dobi ka të thuash se tekstet origjinale të Biblës janë të frymëzuara? Ne nuk i zotërojmë tekstet origjinale, por kemi vetëm një kopje të mbushur me gabime dhe shumica e këtyre dorëshkrimeve janë prodhuar shekuj më vonë se origjinalët". (Po aty, fq. 27.) "Ishte e qartë se kishte një problem në pohimin se Bibla ishte verbalisht e frymëzuar në çdo fjalë të saj. Siç mësuam në një nga kurset e para të ndjekura në institut, ne nuk i zotërojmë dorëshkrimet origjinale të Dhiatës së Re. Ajo që ne kemi, përbëhet nga kopje të këtyre shkrimeve, të bëra vite më vonë. Mbi të gjitha, asnjëra prej këtyre kopjeve nuk është krejtësisht e saktë, duke qenë se skribët që i kanë prodhuar ato, pa dashje ose qëllimisht, i kanë ndryshuar në vende të ndryshme. Të gjithë skribët e kanë bërë këtë. Kështu, në vend që të kemi fjalët e frymëzuara të autorëve (d.m.th. origjinalet) të Biblës, ajo çka kemi janë vetëm kopje të shkruara në gabime të shumëfishimeve".( Po aty, fq. 23.)

[8] Dallimi ndërmjet Kur'anit dhe Biblës qëndron në faktin se Kur'ani vazhdimisht pohon burimin e tij hyjnor nga Zoti i botës. (Shih këto ajete: Ali Imran, 164; Nisa, 82; Nisa, 105; Junus, 57; Nahl, 64; Fussilet, 53; Ali Imran, 3; Ibrahim, 1) Feja islame është një fe që është e argumentuar me Kur'an, ashtu siç u argumentua që Kur'ani është burim hyjnor, nga Zoti i Plotfuqishëm, sakohë që në Bibël nuk gjejmë ndonjë citat që të argumentojë Krishterimin. Askund në Bibël nuk keni për të gjetur se Zoti i drejtohet popullit të Musait, ose pasardhësve të këtij populli, duke u thënë se feja e tyre quhet judaizëm, ose - se u shpall pasuesve të Krishtit, që feja e tyre quhet krishterim. Me fjalë të tjera, emrat judaizëm dhe krishterim nuk kanë pasur origjinë dhe miratim hyjnor. Vetëm shumë kohë pas largimit të Jezusit nga kjo botë, fesë së tij iu vu emri Krishterim. E, sa për Islamin, Kur'ani thotë: ***"Feja e pranueshme tek Allahu është Islami, e atyre që u është dhënë libri, pasi mësuam për të vërtetën, ata vetëm nga zilia në mes tyre, kundërshtuan. E kush i mohon argumentet e Allahut, le ta dijë se Allahu shpejt do t'ia japë llogarinë".*** *(Ali Imran, 19)* ***"E, kush kërkon fe tjetër, përveç fesë islame, atij kurrsesi nuk do t'i pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dëshpëruarit".*** *(Ali Imran, 85)*. Me rastin e Haxhit lamtumirës, në të cilin Pejgamberi s.a.v.s. mbajti fjalimin e fundit, dhe mbasi e mbajti fjalimin e tij para masës, po atë ditë, Zoti xh.sh. shpalli ajetin e Kur'anit: ***"Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time dhe zgjodha për ju Islamin fe".*** *(El Maide, 3)* Këto citate të lartpërmendura tregojnë se Kur'ani përmban pohimin për vulën e autorësisë së Allahut xh.sh., dhe se feja islame është feja me të cilën duhet të bashkohemi. Po ashtu, Zoti jo vetëm që e shpalli Kur'anin, po edhe, duke qenë se ai duhej të mbetej si mesazh për njerëzimin deri në fundin e botës, duhej të ruhej ashtu siç është shpallur, edhe premtimi i Zotit për ruajtjen e Kur'anit është i mrekullueshëm, përsa thotë: ***"Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij".*** *(El Hixhr, 9)*

# Përpjekjet për përmirësimin e gjendjes shoqërore, synim i kahmotshëm



**Shtylla kryesore e parimit të sistemit të hidajetit integrues deklaron se në kohën e sodit fytyra e Islamit duhet të paraqitet drejt para gjeneratave të reja. Çiltërsia e fesë islame domosdoshmërisht të përhapet në të gjitha drejtimet kulturore dhe disiplina shkencore-historike, etj**

**TAXHUDIN HAMIDI**

Në të kaluarën shoqëritë kanë qenë komponime të vogla-minore. Kanë jetuar në distanca të largëta njëra prej tjetrës. Këto shoqeri të organizimit minor kanë pasur deformime, ostracizëm dhe janë zhdukur pa ditur gjë njëri grup për tjetrin. Nga ky shkak, Allahu xh. sh. në mënyrë sukcesive dërgonte të dërguarit e tij një pas një, më shumë në numër për një kohë të caktuar.

Kjo situatë dhe gjendje morbide gjithnjë alarmonte ardhjen e shpalljes së fundit (akiden) dhe praktikën e Muhamedit s.a.v.s. në tokë (sheriatin). Atë kohë anomalitë dhe sëmundjet shoqërore ishin të ndara shkaku i inkluzivitetit dhe disperzivitetit të shoqërive me komponime minore. Në atë kohë veprimi për vendosjen e rendit dhe transparenca informative ishte inkomparabile. Kurse me kalimin e kohës informimi filloi të merrte dimensione publike, gjithëpërfshirëse. Kurse tani të gjitha sëmundjet shoqërore, si ato morale, fizike e ekonomike, identifikohen dhe shoshiten të integruara. Kjo ishte esenca e të gjitha thirrjeve pejgamberike deri në fund, që veprimtaria ferrëfyese të jetë me efektive dhe me më shumë rezultate. Tani mjafton vetëm një shpallje qiellore, një i dërguar i fundit dhe një sistem i hidajetit integrues sheriatik. Sistemi i hidajetit integrues të kujton “gjeniun e anijes“, që hepohet , anohet..., por kurrsesi nuk rrëzohet. Pikërisht kjo qëndron në zemrat e ithtarëve të fesë islame, me një pamje të drejtë rreth Islamit.

### PREZENTIMI I MENDIMIT TË PASTËR

Feja islame si kurdoherë nuk duhet të mbajë qëndrim të huaj. Sepse, sistemi i saj i hidajtetit integrues e detyron që ajo të mbajë dhe duhet të shfaq qëndrimin e saj. Kjo do t’i ndihmojë për avancimin e fesë islame në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Shtylla kryesore e parimit të sistemit të hidajetit integrues deklaron se në kohën e sodit fytyra e Islamit duhet të paraqitet drejt para gjeneratave të reja. Çiltërsia e fesë islame domosdoshmërisht të përhapet në të gjitha drejtimet kulturore dhe disiplina shkencore-historike etj... Synimi i çdo ithtari të besimit islam duhet të jetë që ai të ekspozojë të mirat e Islamit, me qëllim instalimin e sistemit të hidajetit integrues. Këtë dua të përkujtoj, pasi bota është lënduar rëndë nga mëkatet... Ne nuk duhet të presim dhe nuk duhet t’u drejtohemi vetëm atyre që na duan dhe që na dëgjojnë, por të gjithëve - edhe atyre që pajtohen, edhe atyre që na kundërshtojnë. Allahu xh. sh. në Kur’an thotë: “Ne nuk duam gjë tjetër përveç përmirësimit të gjendjes



shoqërore." Muhamedi s.a.v.s gjatë jetës së Tij shkonte nëpër vende të ndryshme, si kongrese, tubime, panaire dhe pazare. Me plot fuqinë e shpirtit udhëzonte njerëzit dhe me bindshmëri i motivonte ata të përqafojnë fenë islame. Ai asnjëherë nuk zgjidhte se kush do ta dëgjonte e kush jo. Muhamedi s.a.v.s. gjatë jetës së Tij si pejgamber i thirrte të gjithë. Kurse ne tani i thirrim vetëm ata që kërkojnë prej nesh. Muhamedi s.a.v.s. është i pari në rruzullin tokësor i cili vendosi në xhami dialogun mes të tjerëve. Kjo gjë shumë bukur është ruajtur nëpër analet e historisë së fesë islame. Në një proverb arab thuhet: "Muhamedi priti t'i afrohet lumit, lumi nuk iu afrua; atëherë, ai iu afrua lumit." Nëse ne dëshirojmë që të tjerët të na njohin, ne duhet që fillimisht t'u tregojmë se kush jemi. Mos presim në asnjë moment që të tjerët para nesh të komentojnë fenë islame. Por, nga ne pritet të japim gjithçka që mund të japim. Dija dhe angazhimi për të përhapur vlerat e fesë islame janë të dobishme për të gjitha shoqëritë dhe kulturat. Dobitë nga vlerat e fesë islame bota duhet t'i shijojë nga lapsi dhe fjala e dijetarëve të devotshëm islam, e jo ne sot, për fat të keq, dobitë e fesë islame t'i shohim nga autorët e proviniencës *islamistike, muhamedane, orientalistike*. Dijetarët më eminentë të botës islame kanë konfirmuar mendimin e tyre unik se hapja e kapitullit (ilm-dituri) është gjithnjë para fjalës dhe veprimit. Në një konferencë, mbreti Abdullah i Arabisë Saudite ka thënë: "Dituria dhe Islami nuk duhet të jenë të kundërshtuara; ato, si të tilla, mund të ndodhin vetëm në mendjet patologjike." Sigurisht, përpjekjet për vendosjen e sistemit të hidajetit integrues, në asnjë moment nuk do të vazhdojnë të jenë inkompetente. Angazhimi i proviniencës islame nuk dëshiroj të mbetet një termometër në ndodhitë kruciale botërore. Sepse, mjeti termometër bën vetëm matjen e temperaturës dhe nuk ndikon në uljen e saj. Ndërsa, angazhimi i opusit islam dëshirojmë të mbetet një termostat, një mjet që e rregullon nivelin e temperaturës së dëshiruar. Feja islame kërkon që njerëzit të jenë më aktivë kur është liria e tyre në pyetje dhe assesi, përvetësimi i vlerave të tyre të mbetet si tabirname. Përpjekjet kulmore të sistemit të hidajetit nuk mbeten të distancuara nga përgjegjësitë e tyre. Të gjitha institucionet duhet të marrin rolin e tyre në përmirësimin e anomalive shoqërore dhe të jetës publike. Duhet bërë dallim nga shërbimi me të mirat e pusit dhe të shiut: pusi pret njerëzit të pijnë ujë, ndërsa shiu vjen e shkon në të gjitha vendet - ai vjen në male, në kodra, në fusha, etj... Edukatori i fesë islame nuk duhet të jetë si pusi, t'i pret njerëzit, por duhet të shndërrohet në shi, të vizitojë e të shkojë kahmos, që të kontribuojë në edukimin e gjeneratave të reja, ku do të asgjësojë të gjitha intrigat skeptike para syve të gjeneratave të reja, të cilave u është vështirësuar të kuptojnë dhe të shijojnë vlerat e fesë islame. Për fat të keq, bota islame në vend që të trasojë rrugën që mësimet dhe vlerat islame të kalojnë te kulturat tjera, sot bota islame kalon dhe përjeton një episod konfliktuoz. Besimi i sinqertë në mësimet e fesë islame është dhe mbetet çelësi i vetëm për zgjidhjen e të gjitha problemeve. Në asnjë moment nuk duhet harruar ajeti i cili bën që të bjerë zilja në çdo kokë. Allahu xh. sh. në Kur'an thotë: "E thotë: 'Ah, i gjori unë, sikur të isha parapërgatitur për jetën time!'" (Fexher,24) Është shumë e vërtetë, që të përgatitet besimtari për jetën e tij, apriori duhet që të fillojë t'i kthehet fesë islame dhe të lexojë Kur'anin me një lexim më të sofistikuar, larg çdo nyjash, kurthesh, intrigash dhe konspiracionesh të agjenturave antiislame. Andaj, detyrimisht obligohen të gjithë hulumtuesit e kohës së sodit që të zbulojnë Islamin e gjallë, eksplodimin e aftësive krijuese dhe integrimin me jetën aktuale, ashtu që besimtari islam të mos ndjehet i huaj në shekullin njëzet e një.

**JETA DHE VEPRA**

Sepse, liria e njeriut është substanca e ekzistimit të tij. Nuk ka vlerë ekzistenca e njeriut nëse nuk shfaqet liria e individualitetit të tij nga burgu shoqëror dhe prangat e tij. Arma e njeriut ekzistues në këto kundërshtime është liria e tij, e cila e përforcon çdo gjë përreth tij. Në literaturën islame shihet qartë se angazhimi dhe përpjekjet e pakufizueshme kanë luftuar kundër gafletit (pakujdessh-

mërisë flegmatike). Njerëzit e shquar dhe figurat eklatante kanë investuar dhe sakrifikuar shumë nga jeta e tyre për të dëshmuar se ai që jeton vetëm për vete, jeton i qetë, mirëpo jeton i vogël e si mikrolog dhe vdes si i tillë. Kurse njerëzit me përgjegjësi shoqërore mbi supet e tyre mbajnë përgjegjësi të mëdha dhe vdesin si të mëdhenj e të shquar-notabil. Përpjekjet e larta ndaj shoqërisë në Kur'an përshkruhen me një fjalë të njohur kum/ngrihu (Muzemil, 2). Muhamedit s.a.v.s. iu tha ngrihu (kum) dhe Muhamedi s.a.v.s. u ngrit dhe pas kësaj fjale qëndroi i përgatitur, në këmbë, në shërbim të shoqërisë e cila fundosej nga paganizmi me shumë se njëzet vjet! Pas këtij urdhri Muhamedi s.a.v.s. nuk pushoi, nuk banoi, nuk jetoi për vete, as për familjen e Tij – u ngrit dhe mbeti duke qëndruar në këmbë, në shërbim të misionit islam. Nga ky urdhër, konstrukti konsonant i të cilit formohet vetëm nga dy shkronja: kum / ngrihu, Muhamedi s.a.v.s. kuptoi të vërtetën e çështjes, kur iu drejtua zonjës Hatixhe me fjalët: "Mbaroi periudha e gjumit, oj Hatixhe.

Zoti e mëshiroftë dijetarin dhe liderin e shquar Hasan el Bena, i cili sakrifikoi jetën dhe familjen duke u kushtuar rëndësi të jashtëzakonshme përpjekjeve për përmirësimin e shoqërisë islame. Ai nuk kthehej në shtëpinë e tij, por këtë e bënte vetëm atëherë kur duhej të ndërronte valixhet për një udhëtim të ri, në shërbim të misionit islam. Rrëfehet se Hasan el Bena e kishte djalin të sëmurë. E shoqja e tij e priste me padurim që të kthehej. Dhe, e informoi Hasan el Benanë se gjendja e djalit është vështirësuar tejmase dhe kërkoi prej të shoqit të qëndronte në shtëpi, sepse ajo i frikësohej vdekjes së djalit nga sëmundja e fortë që e kishte përfshirë. Hasan el Bena refuzoi të qëndronte në shtëpi, nuk pranoi të shtynte udhëtimin dhe takimet. Në lidhje me brengat shoqërore, në këtë gjendje ai i drejtohet së shoqes me këto fjalë: "Gjyshi i djalit e di mirë rrugën e varrezave.

Sigurisht se për të shëruar plagët e shoqërisë islame nevojitet mund, lodhje, angazhim. Vetëm kështu mund t'i gremisim të gjitha ato sfida e tendenca që na paraqiten gjatë përpjekjeve dhe angazhimeve tona.

**ANALIZË**

# Thirrja islame (da'veja) kërkon angazhim dhe sakrificë

**Kur është në pyetje Thirrja islame (da'veja), sot shumë muslimanë arsyetohen se nuk kanë njohuri të mëdha për ta kryer këtë obligim të Zotit, duke e lënë këtë vetëm në duart e imamëve dhe prijësve fetarë, shumica prej të cilëve, për fat të keq, nuk bëjnë asgjë jashtë asaj me ç'janë të obliguar brenda xhamisë.**

**ARSIM DAUTI**

Islami është një sistem jetësor që njeriun e obligon me disa detyra të cilat duhet t'i përmbush me maturi dhe me sukses. Një nga obligimet që njeriu duhet ta kryejë është edhe da'veja ose angazhimi i tij në shpjegimin dhe afrimin e së Vërtetës te njerëzit e tjerë. Thirrja në rrugën e Zotit, pikësëpari, është detyrë e profetëve të Allahut, të cilët janë njerëzit më të vyeshëm dhe robërit më të mirë që janë krijuar nga i Gjithëmëshirshmi. Gjithashtu, kjo është detyrë edhe e pasardhësve të profetëve ose e dijetarëve islamë, por, përveç kësaj, angazhimi në rrugën e davetit është detyrë e çdo pjesëtari të Fesë islame. Këtë më së miri e ilustron rrëfimi kur'anor, të cilin do ta përmendim në këtë artikull, ku Allahu i Madhërishëm përmend një njeri që thërret popullin e tij të pranojë mesazhin e tre profetëve të cilët kishin ardhur për të ftuar në besim. Ky obligim pas imanit është vepra më e mirë, ngase frytet e saj janë udhëzim i njerëzve në rrugën e drejtë dhe nxjerrja e tyre nga errësira në dritë.

Këtë e përmend Allahu i Madhërishëm në Kur'anin Famëlartë:

**"E kush flet më bukur se ai që i fton njerëzit drejt Allahut, bën vepra të mira dhe thotë: "Unë, në të vërtetë jam musliman"** (Fussilet, 33)

Duhet cekur se kjo detyrë nuk është edhe aq e lehtë. Obligimet e tjera, siç është namazi ose agjërimi, janë obligime që kanë të bëjnë me vetveten, kurse thirrja islame është obligim ku bartësi i saj ballafaqohet me sfida të ndryshme. Thirrësi në rrugën e Zotit ballafaqohet me lloj-lloj sprovash; ai shihet me dyshim; ai ballafaqohet me mendje të prapambetura, me zemra të sëmura nga zilia, mburrja,

kryelartësia dhe kokëfortësia. Thirrësi, në këtë rrugë, ka raste kur sulmohet edhe fizikisht. Në këto kohë, shumë shpejt bëhet objekt i keqkuptimit mediatik dhe sulmit nga shoqëria politike dhe civile, të cilët janë anti-da've.

Për të pasur sukses në këtë rrugë, duhet të jemi të përgatitur me cilësi shumë të larta. Kjo rrugë kërkon angazhim, sakrificë, moral të lartë, mençuri dhe urtësi të madhe. Si të mos kërkohen këto cilësi, kur dihet mirë se njerëzit janë të paparashikueshëm, kurse thirrësi në rrugën e Zotit duhet të jetë i gatshëm për çdo situatë.

Faqet e Kur'anit janë të mbushura me rrëfime ku tregohet angazhimi dhe sakrifica e njerëzve që kanë thirrur në rrugën e Zotit. Për të treguar vlerën dhe rëndësinë e këtij obligimi, këtë do ta ilustrojmë me një rrëfim nga Kur'ani famëlartë.

**Një shembull i angazhimit dhe sakrificës në këtë rrugë**

Allahu i Madhërishëm në zemrën e Kur'anit përmend një njeri, i cili mund të jetë simbol i sakrificës në rrugën e Zotit.

**"Dhe, nga skajet e qytetit erdhi një njeri, duke nxituar dhe tha: 'O populli im, ndiqni të dërguarit! Ndiqni ata, që nuk kërkojnë prej jush kurrfarë shpërblimi e që janë në rrugë të drejtë!'"** (Jasin: 20-21)

Allahu i Madhërishëm në një qytet prej qyteteve dërgoi tre profetë, që t'i thërrasin njerëzit në rrugën e Tij. Kur arritën në qytet, ata e takuan këtë njeri të moshuar, të cilit ia prezantuan mesazhin e Zotit të tyre. Ai së pari i shikoi me dyshim, por kur ata treguan argumentet për thëniet e tyre, ai besoi menjëherë. Të tre profetët, pas takimit me të, vazhduan rrugën drejt vendit ku ishin dërguar. Ata filluan t'i thërrisnin njerëzit e atij qytetit për të besuar në një Zot, mirëpo mendjemadhësia dhe kokëfortësia e tyre ua kishte mbuluar zemrën saqë ata, jo që nuk pranuan mesazhin e tyre, por i sulmuan që të tre profetët.

Atëherë në skenë del njeriu, i cili sipas komentuesve të Kur'anit quhet *Habib En- Nexhar*. Kur dëgjoi se bashkëkombësit e tij kanë sulmuar profetët e Zotit, nuk qëndroi duarkryq, ashtu siç bëjnë shumë muslimanë në kohën tonë, të cilët nuk reagojnë aspak dhe qëndrojnë si të hutuar kur dëgjojnë se sulmohen Islami a thirrësit në rrugën e Zotit. Ky njeri me zgjuarsinë e tij e kuptoi menjëherë se thirrja në rrugën e Zotit është obligim edhe i tij e jo vetëm i atyre tre profetëve. Në këto kohë të vështira, kur është në pyetje thirrja në rrugën e Zotit, pjesëtarët e Islamit presin se, vallë, çfarë do të bëjnë imamët dhe teologët, sikur Islami të jetë i shpallur vetëm për ta!

Sot shumë muslimanë kur është në pyetje Thirrja islame (da'veja) arsyetohen se nuk kanë njohuri të mëdha për ta kryer këtë obligim të Zotit, duke e lënë këtë vetëm në duart e imamëve dhe prijësve fetarë, shumica prej të cilëve, për fat të keq, nuk bëjnë asgjë jashtë asaj me ç'janë të obliguar brenda xhamisë.

Le të shohim se si e thërret ky njeri popullin e vet. Edhe pse në mesin e atyre banorëve Allahu xh. sh. kishte dërguar tre profetë, pra, ky njeri i moshuar, i cili jetonte në një shpellë dhe që kishte qëndruar një kohë shumë të shkurtër me ata profetë, kur dëgjoi se populli nuk e kishte pritur mirë mesazhin e tyre, ai nuk tha: le të bëjnë çfarë të duan, ata janë të dërguar të Zotit, unë nuk kam njohuri të mëdha për t'u dalë në ndihmë, por me vrap u nis drejt qytetit dhe me një zgjuarsi të rrallë u tha banorëve: **"O populli im, ndiqni të dërguarit! Ndiqni ata, që nuk kërkojnë prej jush kurrfarë shpërblimi e që janë në rrugë të drejtë!"** (Jasin, 21). Pra, nuk nevojitet ndonjë njohuri e madhe që dikujt t'ia ofrosh ëmbëlsinë e Islamit, të cilën ti vetë e ke shijuar. Mjafton që atë që di, t'ia tregosh dikujt tjetër. Ndoshta kjo do të ndikojë që ai i cili nuk ka aspak njohur për fenë e Zotit të fillojë të interesohet për të njëjtën.

Shikoni se me çfarë urtësie debatoi me popullin e tij ky njeri, i



cili sapo kishte pranuar besimin në Krijuesin e vetëm: **“Përse të mos e adhuroj Atë, i Cili më ka krijuar e tek i Cili do të kthehemi të gjithë? Vallë, përse duhet të adhuroj zota tjerë përveç Tij? Nëse i Gjithmëshirshmi do të dëshironte të më godiste me ndonjë të keqe, ndërmjetësimi i atyre (zotave) nuk do të më sillte kurrfarë dobie e as që do të mund të më shpëtonin. Atëherë, unë do të isha me siguri në humbje të dukshme.”** (Jasin 22-24). Pra, sapo e kishte kuptuar se zotat që i adhuronte më parë nuk i sjellin as dëm e as dobi, këtë menjëherë ua tregon edhe bashkëkombësve të tij. Nuk ka nevojë të thellohemi në çështjet fetare dhe njeriun që nuk ka aspak njohuri rreth fesë ta lodhim me argumente dhe tema të rënda, mjafton që t’ia tregojmë gjërat elementare të fesë së Zotit.

Mendjemadhësia dhe kokëfortësia janë cilësi që njeriun e dërgojnë në humnerë; këto cilësi nuk e lejuan këtë popull, sikur edhe shumë të tjerë, të shijojnë ëmbëlsinë e besimit në një Zot. Prandaj, zemërimi i tyre filloi të shtohej; këtë e pati vërejtur edhe njeriu që erdhi nga skaji i qytetit. Madje, ai e kuptoi shumë mirë se për t’i shpëtuar profetët që të vazhdojnë misionin e tyre, duhet ndonjë sakrificë e madhe. Në momentin kur banorët filluan t’i sulmonin profetët, ai pa pasur aspak frikë, kthehet nga ata dhe u thotë: “**Unë i kam besuar Zotit tuaj, andaj më dëgjoni!”** (Jasin,25). Sapo i dëgjuan këto fjalë, bashkëkombësit u kthyen kah ai, e rrëzuan në tokë dhe me këmbë e shkelën, derisa nuk i doli shpirti. Në këtë rrëmujë, falë sakrificës së një njeriu i cili shumë mirë e kishte kuptuar rolin e tij në këtë botë, profetët e Zotit patën mundësinë të shpëtonin dhe të largoheshin gjallë nga ai vend dhe nga ajo shoqëri e çoroditur.

Nëse neve na ndodh që dikush të na ofendojë, ose të tallet me punën tonë në rrugën e da’ves, sigurisht se shumica prej nesh do t’i shanin, do t’ i mallkonin ose edhe do t’i sulmonin fizikisht. Por, vallë, si reagoi ky njeri në momentin derisa ishte nën këmbët e tyre? Katade përmend se derisa bashkëqytetarët e tij e shkelnin, ai pandalur thoshte: *“’O Allahu im, udhëzoje popullin tim, sepse ata nuk dinë’ – këtë e tha derisa i doli shpirti*.” (Tefsiri i Ibn Kethirit). Ky shembull dëshmon dashurinë e madhe të këtij njeriu për të tjerët: *Derisa ata e shkelnin, ai e luste Allahun që t’i falë.*



Dashuria e këtij njeriu nuk përfundon këtu. Ibn Abbasi duke e komentuar ajetin: **(Pasi e vrau populli i vet, atij) iu tha: “Hyr në xhenet!” Ai tha: Ah sikur ta dinte populli im, se si më fali Zoti im dhe më bëri të nderuar!”** (Jasin: 26-27), thotë se, njeriu i kaptinës Jasin, pasi që e këshilloi popullin e tij duke qenë gjallë, këtë e bën edhe pas vdekjes, duke thënë: “*Ah sikur ta dinte populli im, se si më fali Zoti im dhe më bëri të nderuar!”* Pra, të kishin besuar atë çka unë besova, dhe me këtë të kishin fituar shpërblimin që mora unë. Pra, ai dëshiron që edhe ata të fitojnë faljen dhe xhenetin.

Të përmendim se raste të këtilla kemi edhe në jetën e profetit të fundit, Muhamedit a.s.

Të kujtojmë rastin e Taifit. Pasi banorët e Taifit sulmuan Muhamedin a.s. me gurë, vjen melaqja e kodrave dhe i propozon Profetit që t’i hedhë kodrat përreth mbi atë popull, por ai duke e ditur se ata janë një popull injorant, përgjigjet: “Jo, atë unë nuk e dëshiroj! Lus Allahun që nga shpina e tyre të nxjerrë pasardhës që do ta adhurojnë vetëm Allahun dhe nuk do t’i bëjnë shok atij.” (Buhariu dhe Muslimi).

Të këtillë janë profetët, evlijatë dhe thirrësit e sinqertë. Zemrat e tyre janë të pastra nga urrejtja dhe dëshira për hakmarrje. Obsesion i vetëm i tyre është ta largojnë njeriun nga humnera dhe ta çojnë drejt mëshirës së Zotit. Sakrifica për realizimin e kësaj ideje nuk është edhe aq e rëndësishme. Shkaku përse sot nuk kemi një sukses të tillë qëndron pikërisht në mosangazhimin tonë në këtë rrugë, në mospasjen e vullnetit dhe në mungesën e sakrifikimit. Neve, për fat të keq edhe një sprovë e vogël na ndal në rrugën tonë për prezantimin e të Vërtetës në mesin e njerëzve, ndërsa një provokim shumë i vogël na hidhëron dhe na çon në apati. Pikërisht për këtë nuk kemi ndonjë sukses në Thirrjen tonë.

# Një jetë kushtuar fesë

**Kacabaçi-Dauti ka qenë mësuese e mësim-besimit në shkollën fillore të Gjilanit mes dy luftërave botërore**

**Binaze Kacabaçi-Dauti, Hoxhë Hanëmja (1891-1981)**



MR. ALIRIZA SELMANI (GJILAN)

Femra shqiptare gjatë historisë edhe pse në rrethana dhe kushte të vështira, e shpeshherë edhe inferiore, në bazë të mundësive ka qenë aktive dhe arriti të inkuadrohet në rrjedhat e jetës shoqërore, politike, arsimore e fetare, duke filluar nga koha e Mbretëreshës Ilire, Teuta e më vonë, pastaj gjatë Lëvizjes Kombëtare Shqiptare e deri në ditët tona, duke dhënë kontributin e saj të çmuar për të ardhmen tonë kombëtare e fetare.

Njëra ndër intelektualet tona të kohës më të re, e cila pothuajse tërë jetën e saj ia kushtoi ngritjes arsimore islame dhe patriotike të gjeneratave të reja të Gjilanit e rrethinës, ishte zonja Binaze Islam Kacabaçi-Dauti, ose siç njihej me emrin Hoxha Hanëme (Zonja Mësuese), aktiviteti profesional i së cilës ka mbetur i pashlyer në kujtesën e gjeneratave në kohën kur jetoi e punoi. Binazja e kishte zanafillën nga një familje shqiptare-muhaxhirë e shpërngulur nga fshati Kacabaç i rrethit të Leskovcit, nga ku, siç dihet, mijëra familje shqiptare e të tjera u detyruan që gjatë luftës ruso-osmane të vitit 1877/78, të shpërngulen nga trojet e veta. Familja Kacabaçi ishte vendosur për një kohë në Prizren, ku kishte lindur Binazja më 1891. Edhe pse e lindur dhe e rritur në kohë të vështira, duke falënderuar të atit, Islam Kacabaçit, i cili ishte një intelektual me ide progresive - kishte gradën e kapitenit të ushtrisë osmane, Binazja si edhe vëllai dhe motra e saj patën fatin që të vijonin shkollimin. Kah viti 1896 Islami caktohet për të shërbyer në Edrene, ku Binazja kishte kryer shkollën fillore dhe pastaj transferohet në rrethinën e Stambollit-në Gebze, për të qëndruar një kohë më të gjatë. Gjatë asaj kohe Binazja regjistrohet dhe e kryen Shkollën Normale për femra në Stamboll, të themeluar më 1870.[1] Sipas disa të dhënave, me kërkesën e saj personale dhe me një dekret të posaçëm të Sulltan Abdyl Hamidit hapet një shkollë fillore në Gezbe, në të cilën Binazja punoi si mësuese për pesë vjet. Mirëpo, Islam Kacabaçi, të cilin e quanin arnaut jyzbashi (kapiten shqiptar), për shkak të qëndrimit të tij pro LKSH dhe solidarizimit me oficerë e ushtarë shqiptarë të ushtrisë osmane, të cilët kundërshtonin vazhdimin e operacioneve luftarake kundër kryengritësve shqiptarë në Kosovë dhe shih për këtë Islami ishte shkarkuar nga detyra. I rënë në gjendje të vështirë ekonomike vendos që të kthehet me familje në Kosovë dhe diku kah fundi i vitit 1910, vendoset te vëllai Ismajl Kacabaçi në Gjilan, i cili si shumë familje muhaxhirë edhe po merrej me një tregti të imët, sa për ekzistencë.

Më 1911 Binazja martohet në Gjilan me Ilazin e Daut agës, ku mbetet për të krijuar familje dhe për të jetuar deri në vdekje. Në martesë pati dy vajza, Fatimen dhe Nehalen.[2] Ndërkaq, i ati Islami, pas okupimit serb të këtyre trojeve shpërngulet për në Turqi, ku edhe tani gjenden pasardhësit e kësaj familje me mbiemrin Besler, disa prej të cilëve kishin vazhduar traditën e oficerëve me grada të ndryshme. Djali i Islamit, Haliti, kishte gradën e majorit dhe ishte dalluar në luftë gjatë Revolucionit turk të Qemal Ataturkut dhe për këtë kishte marrë dekorata.

Ky më vonë kishte marrë pjesë në komplotin kundër kryetarit të Turqisë, Xhelal Bajarit dhe ishte pensionuar.[3]

### SHKOLLIMI I FËMIJËVE SHQIPTARË NË RRETHANAT OKUPUESE SERBO-SLLAVE

Shteti SKS nuk kishte zbatuar obligimet e marra me marrëveshjen në Sen Zhermen (1920), me të cilat ishte obliguar që t'i përmbahej respektimit të të drejtave edhe për pakicat, për të drejtat kombëtare, ku hynin edhe të drejtat për gjuhë dhe shkollim në gjuhën amtare. Mirëpo, kjo nuk do të respektohet për shqiptarët dhe se okupatori serb synonte që përmes shkollimit shtetëror në gjuhën serbe të edukonte rininë në frymën e shtetit jugosllav. Kështu, mes dy luftërave botërore në viset e aneksuara shqiptare në Jugosllavi vepronin vetëm shkollat shtetërore në gjuhën serbe, në të cilat vijonte mësimet edhe një numër i vogël i fëmijëve shqiptarë. Si institucione kryesore edukativo-arsimore për shqiptarët e fesë islame kishin mbetur disa medrese dhe sibijan-mejtepet si shkolla private, mirëpo edhe ky arsimim i shqiptarëve i pengonte pushtetit serb, i cili përcillte me kujdes punën e këtyre shkollave dhe shpesh bëheshin kërkesa për mbylljen e tyre. Kjo shihet edhe nga shkresa e Ministrisë së Fesë dërguar Këshillit të Ministrisë së Arsimit në Beograd, më 7 shtator 1928, ku thuhej: "*Në viset jugore çështja e arsimit fetar të muslimanëve është shumë e komplikuar...Në këto vise ka 50 myftilerë dhe 600 imamë, prej të cilëve asnjëri nuk e njeh gjuhën serbe; të gjithë janë të edukuar në frymën armiqësore ndaj vendit tonë*".[4] Me konsolidimin e Mbretërisë Jugosllave pas Diktaturës së 6 janarit 1929 u ashpërsuan masat ndaj BI, e cila e humbi autonominë formale, u bë centralizimi i plotë i institucioneve arsimore dhe u ashpërsuan masat ndaj sibijan-mejtepeve. Këtë vit u nxor ligji për shkollat popullore, me të cilin ndërpriteshin të gjitha shkollat private, pra edhe ato fetare, sibijan-mejtepe pranë xhamive, me motivacion se përhapnin librin shqip te popullata shqiptare.[5] Andaj, veprimtaria e shkollave fetare islame ndër shqiptarët do të hasë në pengesë nga organet qeveritare prandaj do të ketë ndërprerje të kohëpaskohshme të tyre, mbyllje të plotë të tyre, pushim nga puna të mësuesve të fesë me kërkesën e mbikëqyrësit të shkollave shtetërore etj. Lidhur me vështërsitë e veprimtarisë së këtyre shkollave flitet edhe në një raport të Ulema-mexhlisit të Shkupit, ku ndër të tjera thuhet: "*Sapo u hapën 25 sibijan-mejtepe, pasoi vendimi nga Ministria e Arsimit për mbylljen e tyre, sepse hapjen e mejtepeve e konsideron si veprim të kundërligjshëm të Ligjit mbi shkollat popullore...*edhe pse kjo e drejtë ishte e garantuar me nenin 18 të ligjit mbi BFI të viseve të jugut. Mbyllja e këtyre shkollave nga organet qeveritare kishte karakter politik, sepse te nxënësit e këtyre institucioneve "*po zgjohej me të madhe vetëdija kombëtare, ndërsa mësuesit e tyre janë njerëz të rrezikshëm*".[6] Kjo ishte e vërtetë, sepse në këto mejtepe (shkolla) kultivohej dashuria ndaj gjuhës shqipe dhe ruajtja e saj. Në mungesë të shkollave shqipe, ato u shndërruan në shkolla popullore.

Nisur nga parimi themelor që feja gjithnjë dhe me të gjitha mënyrat duhet t'i shërbejë popullit dhe të jetë përkrah tij, lufta për ruajtjen e besimit islam u bë një faktor i rëndësishëm qëndrese dhe mjet i fuqishëm i përkatësisë kombëtare të shqiptarëve, kurse udhëheqësit fetarë atdhetarë ishin me problemet dhe hallet e popullit, pra problemet e fesë e të besimit i panë të lidhura ngushtë me fatin e popullit. Të vetëdijshëm se shpëtimin e atdheut e panë në përhapjen e diturisë, nga arsimimi i kombit, kurse shkrim-leximin e shihnin dalje nga prapambeturia, këtë ide iluministe e nxirrnin nga Kur'ani dhe hadithet, andaj ishin përqendruar në edukimin dhe arsimimin e fëmijëve mbi parimet e shëndosha islame, të vetëdijshëm se ashtu po përgatisnin të ardhmen e kombit të tyre. Këtij parimi do t'i qëndroj besnik edhe mësuesja Hoxha Hanëmi deri në fund të jetës së saj. Kjo bënte që politika e dhunës dhe e gjenocidit serbosllav mbi popullin shqiptar, politika e shkombëtarizimit të trojeve shqiptare, shfarosjes, të viktimizonte edhe shumë ulema fetarë islam.

Siç mësojmë nga të dhënat memoriale, për një kohë pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, Hoxhë Hanëmja me qëllim që të ushtronte profesionin e saj të mësueses, kishte arritur që të hapte një klasë për vajza shqiptare në shtëpinë e saj, në të cilën punonte një mësuese serbe, kurse ajo vetë jepte mësimin fetar. Ndërkaq, pas themelimit të shkollave shtetërore për fëmijët muslimanë, që nga fillimi do të inkuadrohet me trajtim zyrtar për mësimin e fesë në shkollën e qytetit.[7]

Në bazë të raportit të mbikëqyrësit të shkollave serbe në Rrethin e Gjilanit, të 14 prillit 1919, dërguar Ministrisë së Arsimit në Beograd, shihet se në këtë rreth ekzistojnë vetëm 5 shkolla fillore zyrtare për fëmijët muslimanë-shqiptarë, si shkolla shtetërore në gjuhën serbe, dhe ato ishin: një shkollë në Gjilan dhe në fshatrat Hogosht, Koretin, Rogoçicë dhe Cernicë, në të cilat pos mësuesit serb, ishte edhe nga një imam si ushtrues shtetëror i detyrës së mësuesit. Në shkollën e Gjilanit formohen 3 paralele të klasës së parë për fëmijët muslimanë, ku pos mësuesve serbë do të punojnë edhe tre mësues të fesë islame, në mesin e të cilëve ishte edhe mësuesja Binaze Dauti-Kacabaçi (Hoxhë Hanëmja). Mësim-besimi në këto shkolla, sipas plan- programit plotësues të vitit 1926, mbahej nga dy orë në ditë dhe zakonisht pas mësimit të rregullt. Mësimi në këto shkolla ka zgjatur 4 vjet, por për shkak të pengesave gjuhësore mësimi për fëmijët shqiptarë në këto shkolla ka zgjatur 5 vite.

### INTERESIMI I SHQIPTARËVE PËR SHKOLLIM E BRENGOSTE PUSHTETIN SERB

Interesimi i shqiptarëve për shkollimin e fëmijëve të tyre qoftë edhe në gjuhën serbe ishte i madh,

gjë që e brengoste mbikëqyrësin e shkollave të Rrethit të Gjilanit. Në raportin e tij të 18.08.1919 ai shpreh brengosje, duke thënë: "*Kudo që kam kaluar dhe kam rënë në kontakt me shqiptarët, shumica prej tyre kanë shprehur dëshirën që sa më parë të hapen shkollat*". Raportuesi shtron pyetjen: "*prej nga ky interesim...*". Ndërkaq inspektori i arsimit për shkollat në Kosovë, me anën e një shkrese me numër rezervat, më 15. 05. 1920, i vetëdijshëm për shkollimin e fëmijëve shqiptarë në këto shkolla, kërkonte nga Ministria e Arsimit rregullimin e kësaj çështjeje në interes të politikës së shtetit, duke thënë: ..."*duhet bërë çmos që shqiptarët në këto anë të mos i kenë shkollat e veta autonome në gjuhën e tyre, qoftë turke ose shqipe, gjë që është shumë e dëmshme edhe e rrezikshme për interesat shtetërore*". Ashtu si institucionet tjera fetare islame, edhe shkollat konsideroheshin çerdhe indoktrinimi që përgatitnin armiq të shtetit.

Të dhënat dokumentare të kohës dëshmojnë se edhe përkundër rrethanave të tilla, në shkollat fillore në gjuhën serbe në Rrethin e Gjilanit më 1922 kishte të regjistruar 673 nxënës muslimanë (shqiptarë), ndër të cilët 39 vajza në shkollën e qytetit, kurse më 1924, mësimet i vijonin 725 fëmijë muslimanë në 13 shkolla fillore të rrethit, prej tyre në shkollën serbe të Gjilanit, në 5 paralele kishte 220 nxënës musliman-shqiptarë. Në këto shkolla punonin nga një mësues serb dhe nga një mësues i fesë islame, të cilëve rrogat ua caktonte shteti. Disa nga mësuesit e fesë, përveç mësimit fetar islam dhanë kontributin e tyre edhe në mësimin ilegal të shkrim-leximit shqip dhe ngritjen e ndërgjegjes kombëtare shqiptare. Kjo bëri që më 1924 Ministria e Arsimit duke pasur të dhëna për aktivitetin e tyre, urdhëroi mbikëqyrësin e shkollave të Rrethit të Gjilanit që menjëherë të shkarkonte nga detyra mësuesit e fesë: Bajram Rashit Rexhepin, (Berishën A.S.), Binaze I. Dautin (Hoxhë Hanëmen) dhe Hysen Jakup Hajdarin nga shkolla e Gjilanit, si dhe Ruzhdi Mehmetin në Roganë, dhe Raif Halimin e Isuf Ibrahimin në Mogillë. Reduktimi i mësuesve shqiptarë të fesë do të vazhdojë edhe në vitet e mëvonshme.

Në regjistrin e mësuesve të fesë për vitin 1925/26, në shkollat e Rrethit të Gjilanit figurojnë edhe emrat e 18 mësuesve të fesë, në mesin e të cilëve ishte edhe mësuesja Binaze Islam Kacabaçi (Hoxhë Hanëmi).[8]

Siç u tha më sipër, Hoxhë Hanëmi punoi në mënyrë permanente midis dy luftërave botërore, në shkollën shtetërore në Gjilan dhe zakonisht në ndërrimin e pasditës, duke mos e ndier fare lodhjen, vetëm që të përhapte sa më tepër diturinë dhe edukatën islame te gjeneratat e reja. Si intelektuale ndër të rrallat e kohës-prijatare e arsimimit të femrës shqiptare në viset e Anamoravës, e vetëdijshme për rëndësinë e arsimit si për meshkuj, ashtu edhe për femra dhe rolin e saj në këtë aspekt, ajo jo vetëm që i shkolloi dy vajzat e veta, Fatimen dhe Nehalen, edhe përkundër rrethanave të kohës, insistonte që edhe të tjerët t'i shkollonin vajzat e tyre, por meqë pjesa më e madhe e fëmijëve kishin mbetur jashtë bankave shkollore, ajo e vetëdijshme për profesionin që kishte, pas kohës së punës vazhdonte veprimtarinë e saj edukative-fetare e kombëtare, duke i tubuar fëmijët e qytetit në shtëpinë e saj.

Pas fillimit të Luftës së Dytë Botërore, me hapjen e shkollave në gjuhën shqipe, ashtu si shumë intelektualë fetarë islam e të tjerë të Gjilanit e rrethinës, edhe mësuesja e fesë Hoxhë Hanëmja, me qëllim të aftësimit profesional dhe përsosjes së gjuhës shqipe kishte vijuar kurset verore dhe njëherit vazhdonte aktivitetin e saj profesional të edukimit fetar islam në shkollën shqipe të qytetit, kurse në ditët e para të pasluftës, në kushte të sistemit totalitar komunist, pas një vit pune, në vitin shkollor 1945/1946, të mësim-besimit në shkollën fillore të Gjilanit, ku fëmijët mësonin një herë në javë mësim-besim, me intervenimin e inspektorit të arsimit Apostol Tanefi, mësuesja Binaze qe e detyruar që të tërhiqet nga procesi edukativo-arsimor dhe të pensionohet.[9] U largua nga profesioni i mësueses së mësim-besimit, profesion të cilin e kishte ushtruar mbi 30 vjet me radhë, duke filluar në Stamboll dhe përfunduar në Gjilan.

Edhe përkundër demoralizimit të saj me vendosjen e sistemit komunist, por e vetëdijshme për rëndësinë e arsimit të femrës shqiptare, mësuesja Binaze Kacabaçi-Dauti angazhohet me autoritetin e saj për dërgimin e vajzave në shkollë dhe për këtë qëllim kishte shkuar edhe në fshatrat e Rrethit të Gjilanit.[10]

Aktiviteti i palodhshëm edukativo-arsimor i Hoxha Hanëmes nuk dallohej vetëm në objektet shkollore, por edhe në shtëpi të saj e kudo tjetër, ku jetoi e veproi, pra edhe pas Luftës së Dytë Botërore edhe pse në moshë të shtyrë (jetoi 90 vjet), e vetëdijshme për rolin që kishte, dha kontribut të çmuar në lëmin e arsimimit dhe të edukimit fetar islam dhe patriotik të shumë gjeneratave të reja, të cilët vazhduan shkollimin në medrese dhe shkolla të tjera. Andaj, kujtesa për kontributin fetar e kombëtar të kësaj intelektualeje të shquar shqiptare, mbase të parës në Anamoravë, do të mbetet përherë e pashlyer në analet e historisë së kësaj ane.

---

